ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

2015



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Blv.Bajram Curri, ish - Godina KESH, Kati IV
Tiranë,Shqipëri

E-mail:public@erru.al
Tel:00355 4 2258046
Faqja e internetit:www.erru.al

©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Shtator 2016

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme për të gjithë konsumatorët në Shqipëri

Misioni

Të sigurojë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht

Përmbajtja

Shkurtime 3

Fjala Përshëndetëse 4

Hyrje 6

1. ERRU dhe Veprimtaria gjatë Vitit 2015 8

Liçencimi 8

Rregullimi i Tarifave 9

Mbrojtja e konsumatorit dhe rritja e transparencës 11

2. Ecuria në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime gjatë vitit 2015 12

Zhvillimet kryesore 12

Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendencat 15

3. Analiza e performancës për shoqëritë ujësjellës kanalizime 22

3.1 Treguesit kryesorë të Performancës 22

Analiza e performancës në lidhje me objektivat e vendosur nga ERRU 26

Renditja e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime 27

Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave 28

3.1.1. Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes 28

3.1.2. Mbulimi i kostove totale 35

3.1.3. Norma e arkëtimit 42

3.1.4. Efiçenca e Stafit 46

3.1.5. Uji Pa të Ardhura 51

3.1.6. Niveli i Matjes 56

3.1.7. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë 61

3.1.8. Mbulimi me kanalizime 66

3.1.9. Perceptimi Rregullator 70

3.2 Renditja e shoqërive ujësjellës kanalizime sipas performancës për vitin 2015 76

4. Tema e Veçantë për Vitin 2015: Hartimi i Bilancit të Ujit 81

5. Konkluzione dhe Perspektiva për të Ardhmen 92

6. Anekse: Të dhënat kryesore të përzgjedhura 96

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
SHA	Shoqëri Aksionere
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit / Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar
IWA	International Water Association / Shoqata Ndërkombëtare e Ujit
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto operative dhe mirëmbajtje

Fjala Përshëndetëse

Raporti i Performancës së shoqërive UK hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Raporti nuk përbën thjesht një dokument statistikor krahasimi me vitet paraardhëse të performancës së sektorit ujit dhe të çdo shoqërie ujësjellës kanalizimesh në veçanti. Ky raport analizon dhe paraqet tendencën e performancës të të gjithë shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri duke nxjerrë në pah problematikën dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-financiare të tyre.

Misioni i ERRU-së është që Shoqëritë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve t'i ofrojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe të jenë financiarisht të qëndrueshme.
ERRU në përmbushje të misionit të tij në mbrojtje të konsumatorëve vazhdon perpjekjet për përmirësimin e metodave dhe praktikave që ai përdor për këtë qëllim.

Analiza e performancës për shoqëritë e UK për vitin 2015 tregon një tendencë përkeqësimi të treguesve financiarë të performancës në drejtim të mbulimit të kostove operative dhe ato totale, ndërkohë që cilësia e shërbimeve nuk tregon ndonjë tendencë përmirësimi. Akoma mbeten mjaft problematike rritja e zërit të shpenzimeve dhe e mbipopullimit me staf jo profesional të shoqërive, ndërkohë që treguesi i Ujit Pa të Ardhura mbetet në vlere të papranueshme. Nga ana tjetër ndihet mungesa e një programi të investimeve fizike me alokimin e fondeve përkatëse që t'i përgjigjet kërkesave të rritjes së përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në përgjithësi, si dhe rritjes së përqindjes së popullsisë që kanë akses në to.

Panorama e performancës së sektorit të ujit për vitin 2015 perforcon idenë e domosdoshmërisë urgjente të kryerjes së një reforme në sektor në drejtim të përmirësimit sidomos të aspekteve menaxheriale të shoqërive. Në kuader të kësaj panorame ERRU vë theksin kryesisht tek mungesa e një strukture efikase të monitorimit dhe kontrollit të shoqërive, influenca e së cilës përcillet në mosperformancën edhe të stafit ekzekutiv të tyre.

Viti 2015 është viti i Reformës Administrative Territoriale. RAT sjell sfida të reja për sektorin e ujit në drejtim të një riorganizimi të ri të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve në të gjithë territorin e ri të bashkive për të ofruar shërbime me cilësi për të gjithë konsumatorët. Në këtë kuadër ERRU po përgatitet për këtë sfidë në lidhje me rolin dhe kontributin e saj në mbështetje të reformës.

ERRU po përforcon përpjekjet e saj për rritjen e bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend për të luajtur një rol aktiv e kontribues në sfidat për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sektorit të ujit.

Nga ana tjetër ERRU mban lidhje dhe bashkëpunon ngushtësisht me të gjithë organizimet ndërkombëtare që kanë lidhje me rregullatorin dhe sektorin e ujësjellës kanalizimeve për të përfituar nga eksperiencat më të mira dhe për të ngritur në nivelin e duhur kapacitetet profesionale të saj.

Pavarësisht problematikës së performancës së sektorit të ujit për vitin 2015 në vendin tonë është tashme i mirënjohur fakti se ka mjaft shoqëri ujësjellësi kanalizimesh që janë të qëndrueshme financiarisht dhe që ofrojnë shërbime të një cilësie të lartë për konsumatorët me një vazhdimësi furnizimi me ujë 24/7, me presionin e duhur, bakteriologjikisht të pastër dhe me çmime të përballueshme. Këto shoqëri shërbejnë jo vetëm si shembull pozitiv i arritjes në sektor, por tregojnë për mundësitë reale që kanë shoqëritë me performancë të dobët për të permirësuar treguesit tekniko ekonomikë të tyre.

Në përfundim do të doja të falenderoja të gjithë punonjësit e ERRU-së, paraardhësin tim z. Avni Dervishi, Komisionerët, si dhe GIZ për kontributin e dhënë në përmirësimin dhe zbatimin e metodave rregullatore në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri.

Ndriçim SHANI
KRYETAR

HYRJE

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimi e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është një institucion i pavarur publik që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

ERRU ushtron funksione rregullatore në sektorin ujësjellës-kanalizime. Këto funksione përfshijnë liçencimin e shoqërive të shërbimeve, miratimin e tarifave të shërbimit, vendosjen e standarteve e rregullave uniforme në sektor, monitorimin e punës së shoqërive, raportimin mbi gjendjen e sektorit, etj.

Ekzistenca e një institucioni rregullator në sektor, është e domosdoshme me qëllim orientimin e këtyre shërbimeve drejt ekonomisë së shkallës, si edhe në përcaktimin e politikave tarifore të drejta, të pavarura dhe të pa anshme. Gjithashtu një rregullator i pavarur shërben për rritjen e transparencës dhe shkallës së informimit të publikut dhe qeverisjes rreth zhvillimeve të sektorit UK, duke shërbyer kështu si një burim alternativ i informacionit,i benchmarking dhe i shqyrtimit e vlerësimit të shërbimeve UK.

ERRU gjatë përmbushjes së detyrave që i përcakton ligji, udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë dhe gjetjes së ekuilibrit mes interesave të gjithë palëve në sektorin UK, konsumatorëve, shoqërive të shërbimeve, qeverisjes qendrore, qeverisjes vendore dhe investitorëve.

Aktualisht në përgjigje të sfidave të Reformës Administrative Territoriale dhe asaj të pritshme në sektorin e ujit, ligji i funksionimit të ERRU është në proces ndryshimi.

Vlerësimi i performancës së sektorit UK dhe shoqërive të licencuara që operojnë në të, i cili ka filluar që nga viti 2011, tashmë është një nga raportimet e vazhdueshme periodike që ERRU përgatit në vijim të Raportit Vjetor i cili publikohet në fund të muajit Janar.

Ky Raport ka si synim të ofrojë një tablo të pavarur dhe objektive të gjendjes në sektor, si dhe t'i mundësojë të gjithë aktorëve dhe publikut të gjerë të informohet dhe të krahasojë performancën e çdo ofruesi të këtij shërbimi.

Raporti jep një pasqyrë të qartë të performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve, analizon shkaqet e performancës së dobët, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e

treguesve tekniko ekonomike të performancës së shoqërive. Nga ana tjetër të gjithë aktorët e interesuar shohin në të progresin e arritur në sektorin e ujësjellës kanalizime dhe vlerësojnë performancën e shoqërisë së tyre lokale. Ky shërben si një element transparence i shoqerive ndaj konsumatorit, qe ky i fundit të rrisë kërkesën e llogarisë për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.

Raporti është i strukturuar në pesë pjesë ku:

- Në pjesën e parë paraqiten shkurtimisht veprimtaritë dhe arritjet kryesore të ERRU gjatë vitit 2015.
- Në pjesën e dytë paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit ujësjellës kanalizime gjatë vitit 2015.
- Në pjesën e tretë, e cila është edhe pjesa më e rëndësishme e këtij raporti, paraqitet analiza e performancës së shoqërive,për secilin nga TKP e marra në shqyrtim. Në fund jepet renditja e shoqërive në bazë të rezultateve të arritura.
- Në pjesën e katërt të raportit për këtë vit si temë e veçantë trajtohet Bilanci i Ujit, Shembull për Sh.a. UK Durrës, si elementi bazë për të analizuar gjëndjen dhe shkaqet e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.
- Në pjesën e pestë paraqitet një përmbledhje e konkluzioneve kryesore.
- Në fund të Raportit ndodhen Anekset me të dhëna të detajuara për shoqëritë UK dhe tarifat që ato zbatojnë.

1. ERRU dhe Veprimtaria gjatë Vitit 2015

Licencimi

Me miratimin e Reformës administrative-territoriale, në korrik të vitit 2014, qeverisja vendore u organizua në 61 bashki të cilat do të çojnë në rritjen e efiçencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Kjo reformë administrative-territoriale ishte parashikuar që gjatë vitit 2015, të zbatohej edhe në sektorin ujësjellës kanalizime, por ende nuk është miratuar paketa ligjore me aktet e nën aktet përkatëse dhe nuk janë bërë ende inventarizimet e aseteve të gjitha sistemeve të Ujësjellës Kanalizimeve të njësive administrative (ish komunat) për t'u paraprirë ndryshimeve që do t'i ndodhin shoqërive UK.

Pavarësisht situatës ende të papërcaktuar (ristrukturimit të sektorit UK si pasojë e reformës administrative-territoriale) të sektorit UK, Enti Rregullator i Ujit është duke vazhduar të kryejë funksionet e tij në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK.

Në sektorin ujësjellës kanalizime vazhdojnë të ofrojnë shërbimin e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik 57 shoqëri. Gjatë vitit 2015 pranë institucionit tonë, kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence, 23 (njëzetë e tre) shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar 10 (dhjetë) shoqëri, ndërsa 13 (trembëdhjetë) aplikime të tjera mbeten ende në proces.

Situata e liçencimit deri në fund të vitit 2015, duke marrë parasysh dhe problematikat e paraqitura më sipër, për 57 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime është: 43 (dyzetë e tre) shoqëri disponojnë licenca të vlefshme; 7 (shtatë) shoqëri janë në proces të rinovimit të licencës; 3 (tre) shoqërive u ka përfunduar afati dhe nuk kanë aplikuar akoma për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim; 4 (katër) shoqëri janë pa licencë.

Gjatë procesit të aplikimeve të shoqërive UK për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2015, u hasën përsëri problematika që janë të njohura për ERRU-në. Ndër to, si më kritike vazhdojnë të mbeten: Ndryshimi në masë i drejtuesve ligjorë, vështirësi në regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR; vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së liçencimit. Këto të fundit janë shkaktuar kryesisht për pajisjen me lejet e mjedisit (në rastin e kategorisë së përpunimit të ujërave të ndotura), por nuk mungojnë rastet kur dokumentacioni vonohet si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë.

ERRU ka qenë dhe do vazhdojë të jetë gjithmonë bashkëpunues dhe i gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur shoqëritë në zgjidhjen e problemeve që kanë dhe do të kenë në zbatim të Reformës Administrative Territoriale.

Rregullimi i Tarifave

Në zbatim të ligjit nr.8102 datë 28.06.1998 " Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar, ERRU është autoriteti që miraton tarifat e shërbimeve ujësjellës kanalizime.
Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU ka përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në "Metodologjinë për vendosjen e tarifave", e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë subjektet e licencuar për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
Në vitin 2015 kanë paraqitur kërkesën për ndryshimin e tarifave Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Durrës dhe Sh.a. UK Elbasan Qytet.
Procedura ka vijuar me analizën tekniko- ekonomike të aplikimit për ndryshimin e tarifave për Sh.a. UK Durrës dhe Sh.a. UK Elbasan Qytet. Për Sh.a. UK Korçë dhe Sh.a. UK Krujë procesi nuk ka vazhduar për mosplotësim të dokumentacionit të aplikimit për ndryshimin e tarifave.

ERRU ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e të gjithë shoqërive për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, për të siguruar cilësinë, efiçencën dhe vijueshmërinë e shërbimeve që ato ofrojnë për të gjithë konsumatorët. Tarifa luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, por ERRU në asnjë rast nuk e vazhdon procedurën për miratimin e tarifave, nëse aplikimi nuk është plotësuar sipas kërkesave të Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave".

Gjithashtu, gjatë vitit 2015 Komisioni Kombëtar Rregullator ka marrë në shqyrtim dhe është shprehur me vendimarrjet përkatëse për aplikimet e paraqitura gjatë vitit 2014 për 12 shoqëri ujësjellës kanalizime.
Ndryshimi i tarifave është miratuar vetëm për katër shoqëri, konkretisht për Sh.a. UK Ersekë, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. U Korçë Fshat dhe Sh.a. U Elbasan Fshat.
Për Sh.a. U Poliçan dhe Sh.a. UK Korçë Qytet nuk u miratua ndryshimi i tarifave të propozuara prej tyre për shkak se nga analiza e zhvilluar ato rezultonin të pajustifikuara.
Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi të mos marrë në shqyrtim propozimet për ndryshim tarife për vitin 2015 për shoqëritë Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Gjirokastër, Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Kukës dhe Sh.a. UK Lushnje Qytet. Këto shoqëri, nuk plotësuan dokumentacionin e aplikimit në përputhje me kërkesat e Ligjit 8102 dhe Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave". Në zbatim të metodologjisë, këtyre shoqërive ju kërkua riparaqitja e aplikimit për ndryshimin e tarifave e plotësuar me dokumentacionin e munguar dhe me të dhëna të përditësuara.

Procesi i miratimit të tarifave përfshin analizën e kostove dhe performancës, duke i caktuar shoqërive objektiva të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.
Për ERRU-në objektivi kryesor në vendimmarrjen e tij është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave, të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove me qëllim uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundësive për shlyerjen e kredive, por pa lënë mënjanë rritjen e efiçencës operacionale.

Një nga elementet bazë të politikës tarifore dhe të aprovimit të tyre që ndjek ERRU është përballueshmëria e pagesës së tarifave të shërbimeve UK nga konsumatorët familjarë. Referuar tarifave aktuale të shërbimeve dhe ato që propozohen rezulton që ka akoma shumë hapësirë deri në arritjen e kufirit të përballueshmërisë së tyre nga konsumatorët familjarë. Pavarësisht këtij fakti, ERRU është në favor dhe ndjek politikën e aprovimit të një rritje graduale (jo drastike) të tarifave edhe për rastet kur këto duken të justifikuara për arritjen e një qëndrueshmërie financiare të shpejtë të shoqërive. Eshtë i njohur fakti i efekteve negative që japin këto rritje drastike nga një reaksion i fortë i konsumatorëve për të mos i paguar ato, veçanërisht nga konsumatorët me të ardhura të ulëta dhe ata në nevojë. Përballueshmëria është një problem kompleks i cili kërkon angazhim nga të gjithë aktorët që lidhen me këtë çështje, për të bërë të mundur mbrojtjen e shtresave të veçanta të konsumatorëve dhe në veçanti të atyre me të ardhura të ulëta dhe në nevojë, si dhe shoqëritë të arrijnë sa më shpejt qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Në funksion të këtij objektivi ERRU ka përdorur instrumentet e tij rregullatorë si, struktura tarifore me subvencion të kryqëzuar ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve, rritjen e transparencës me publikun me anë të organizimit të seancave dëgjimore për pritshmërinë dhe perceptimin e tyre në lidhje me cilesinë e sherbimeve dhe gadishmërinë për të paguar për tarifa më të larta, monitorimi dhe vlerësimi i efiçencës dhe efektivitetit të ofruesve të shërbimit dhe mundësive për përmiresimin e manaxhimit etj.

Një rregullim i mirë tarifor ka nevojë për informacion të besueshëm dhe një monitorim të vazhdueshëm të treguesve të performancës së shoqërive. ERRU e konsideron të domosdoshëm përdorimin e rezultateve të monitorimit të performancës së shoqërive në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për ndryshimin e tarifave të propozuara prej tyre., Megjithëse procesi i monitorimit realizohet me procedura korrekte dhe të vazhdueshme nga Njesia e Monitorimit të Treguesve në DPUK, fatkeqësisht, vërtetësia e të dhënave që merren nga shoqëritë lë mjaft për të dëshëruar.

Saktësia e të dhënave që përcaktojnë performancën tekniko-financiare të shoqërive ka një ndikim të drejtpërdrejtë në parametrat që analizohen dhe që përcaktojnë tarifat për konsumatorët. Këto të dhëna shërbejnë gjithashtu si bazë e vlerësimit të vlerës së

subvencioneve që Qeveria Qëndrore apo Lokale duhet të alokojë për mbulimin e shpenzimeve direkte ndaj shoqërive me bilanc negativ.

ERRU e sheh si sfidë imediate disponueshmërinë e të dhënave të raportuara saktësisht dhe të besueshme nga shoqëritë. Për këtë ERRU do të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e duhura institucionale në mënyre që të ketë bazën e saj të të dhënave tekniko-ekonomike nga shoqëritë.

Mbrojtja e konsumatorit dhe rritja e transparencës

Mbrojtja e konsumatorit është një nga detyrat ligjore dhe shumë të rëndësishme të ERRU-së.

Lidhur me këtë funksion, një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit 2015, është miratimi i "Udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Ky udhëzues përcakton modalitetet e organizimit të seancave të hapura dëgjimore me konsumatorët e tyre, në procesin e ndryshimit të tarifave, duke i përfshirë ata direkt në vendimmarrje. Zhvillimi i seancës dëgjimore përmbush dy parime shumë të rëndësishme të procesit të vendimmarrjes, **transparencën**-informimi i publikut lidhur me aktivitetin e shoqërisë, si edhe **tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje**- dëgjimi i zërit të tyre në procesin e miratimit të tarifave.
Seanca dëgjimore është e hapur për publikun dhe shoqëritë duhet të marrin masa për njoftimin e konsumatorëve si nëpërmjet mediave lokale, ashtu edhe në shtypin e shkruar.

Procesverbali i Seancës dëgjimore me publikun është një dokument i domosdoshëm në procesin e aplikimit për ndryshim tarife. Mungesa e këtij dokumenti në dosjen e aplikimit bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU. Në këtë mënyrë, ERRU synon përmirësimin e nivelit të komunikimit me publikun, rritjen e transparencës dhe llogaridhënien ndaj konsumatorit në sektorin ujësjellës-kanalizime.

2.Ecuria në Sektorin e Ujësjellës Kanalizime gjatë vitit 2015

Përpara analizës së performancës individuale të secilës prej shoqërive, në këtë kapitull jepet një pamje e përgjithshme e nivelit të performancës së sektorit për vitin 2015 si dhe progresit të arritur nga të gjithë shoqëritë që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura. Arritjet e përbashkëta të shoqërive ujësjellës kanalizime janë analizuar duke pasur parasysh objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011-2017 si dhe objektivat për performancë të mirë të vendosura nga Enti Rregullator i Ujit.

Zhvillimet kryesore

ERRU, në funksion të mandatit të tij rregullator, ka përcaktuar politikat që duhen ndjekur në përmbushjen e misionit dhe vizionit të tij. Këto politika, synojnë arritjen e objektivit për rritjen e efikasitetit të një shërbimi cilësor ndaj konsumatorëve nga shoqëri të qëndrueshme financiarisht. Në këtë mënyrë sektori UK në përgjithësi do të shkojë drejt rritjes gjithnjë e më shumë të performancës së tij.

Instrumentat kryesorë në dorë të ERRU-së për arritjen e objektivit të mësipërm janë licensimi i shoqërive me kapacitete dhe mundësi që mund t'i ofrojnë konsumatorëve shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura brënda standarteve dhe me tarifa që aprovohen më parë nga rregullatori.

ERRU konstaton se shoqëritë kanë pasur vullnetin për të përmbushur dhe mbështetur përpjekjet e rregullatorit për krijimin e një mjedisi rregullator të qëndrueshëm dhe transparent në sektor. Sektori i shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet shoqërive të organizuara si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor. Aktualisht në sektor operojnë 57 shoqëri, 53

prej tyre janë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit dhe 48 operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU. Shërbimi me kanalizime nuk ofrohet nga të gjithë shoqëritë. Ky shërbim në sektor është ofruar nga 32 shoqëri, 5 prej të cilëve kryejnë edhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Shoqëritë nuk mbulojnë me shërbime të gjithë popullsinë në zonën e juridiksionit. Për popullsinë jashtë zonave të juridiksionit të shoqërive, shërbimi është ofruar nga sektorë që veprojnë brënda njësive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive që nuk janë të licencuar nga ERRU. Objektivi i ERRU ka qenë evidentimi dhe gjetja e rrugëve më të shpejta ligjore për të bërë rregullimin e tyre në mënyrë sa më objektive. Reforma në Sektorin e Ujit do të sjellë zgjidhjen institucionale brenda një intervali kohor të arsyeshëm të këtij problemi.

Në vitin 2015, sektori është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ndonëse nivelet dhe ecuria e treguesve nuk është e duhura krahasuar me objektivat strategjikë për sektorin dhe ato të performancës së mirë të ERRU. ***Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe norma e arkëtimit kanë pasur tendencë pozitive***. Edhe këtë vit të ardhurat nga aktiviteti kryesor mbulojnë mesatarisht mbi 100% të kostos operative dhe të mirëmbajtjes për sektorin. ***Por tendenca e treguesit të punës nuk ka qenë pozitive. Krahasuar me vitin 2014 ky tregues është 20 % më i ulët. Shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit.***

Shqetësimi kryesor në sektor është ***niveli i lartë i humbjeve, tregues i cili të paktën për tre vitet e fundit nuk ka ndryshuar***. ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së shoqërive.Duke patur parasysh që në totalin e humbjeve, kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve teknike kërkon kohë dhe investime, për pjesën e humbjeve komerciale mbetet detyrë parësore angazhimi më i madh dhe i programuar i shoqërive për zvogëlimin e tyre, gjë e cila kërkon kryesisht përmirësimin e aspekteve menaxheriale nga stafet e tyre në drejtim të nënfaturimeve dhe lidhjeve ilegale dhe që nuk kërkojnë investime të konsiderueshme fizike në sistem.

Analiza e humbjeve bazuar në "Bilancin e Ujit" jep të dhëna të detajuara që i shërbejnë si rregullatorit ashtu edhe shoqërive për vlerësimin e situatës dhe programimin e masave që duhet të merren. Në mjaft raste shoqëritë hartojnë Bilance Uji të pasakta, të cilat nuk arrijnë të bëjnë skanimin e gjëndjes së humbjeve të ujit, përkatësisht humbjet teknike dhe ato komerciale. Në këtë drejtim shoqëritë duhet të përmirësojnë teknikat dhe angazhimet për hartimin e këtyre bilanceve në përpjekje për të detajuar secilin element të humbjeve teknike dhe ato komerciale në përputhje me modelin e Shoqatës ndërkombëtare të Ujësjellesave (IWA).

Pavarësisht se së fundmi ERRU thekson ofrimin e shërbimeve ku në qendër të vëmendjes është konsumatori, gjatë vitit 2015 konsumatori ka ndjerë shumë pak përmirësime të dukshme***. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e ujit të pijshëm i ofruar nga shumica e shoqërive vazhdojnë të jenë në të njëjtat parametra gjatë tre viteve të fundit.***

Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit. Në vitin 2015 si edhe në vitet paraardhëse, burimet kryesore të financimit, kanë qenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët e huaj në formën e huave apo granteve në raporte përafërsisht të barabarta. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të furnizimit ujësjellës kanalizime si edhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Miratimi i masterplanit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime për Shqipërinë për periudhën 2011-2040 është një iniciativë e rëndësishme për sektorin, që mundëson orientimin e investimeve drejt fushave prioritare.

Theksohet fakti se akoma nuk vërehet përdorimi i Master Planit si reference në lidhje me prioritetin e orientimit dhe alokimit të fondeve për investime kapitale. Nga ana tjetër Master Plani Kombëtar përfshin nga ana territoriale vetem zonat e shërbimit që administrohen nga shoqëritë aktualë duke lënë jashtë tyre territoret në të cilat shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ofrohen nga vetë komunat ose komuniteti. Ky Master Plan nevojitet të përditësohet dhe të plotësohet me të dhenat për zonat në të cilat shërbimet ofrohen dhe administrohen nga vëtë komunat, si dhe për zonat ku në to nuk ekzistojnë fare sisteme fizike të furnizimit me uje dhe kanalizimeve për popullsinë.

Burimi kryesor i të ardhurave për shoqëritë janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët. Megjithatë edhe gjatë vitit 2015 qeveria ka akorduar subvencione, pasi shumë shoqëri nuk janë në gjendje të financojnë qoftë edhe veprimtarinë e tyre kryesore operacionale.
Sektori është përballuar me shumë probleme që lidhen me menaxhimin dhe funksionimin e tij. Zbatimi i reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime do të bëjë të mundur zgjidhjen e shumë problemeve të konstatuara më parë në sektor duke krijuar të gjitha kushtet për një menaxhim më të mirë, sipas parimeve të rajonalizimit dhe ekonomisë së shkallës. Reforma pritet që të përfshijë në to edhe zonat ku shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve aktualisht janë në një nivel mjaft të ulët apo për zonat e pambuluara ku këto shërbime nuk ekzistojnë fare të organizuara institucionalisht
Në të ardhmen, shërbimet UK do të ofrohen nga shoqëri të licencuara në të gjithë territorin e vendit. Reforma do të lehtësojë mjaft çështjen e rregullimit ligjor të zonave të pambuluara, pasi ato do të bëhen pjesë e bashkive. Për rrjedhojë do të gjejnë zgjidhje edhe problemet dhe parregullsitë e konstatuara në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të aseteve. Inventarizimi i aseteve, regjistrimi dhe çertifikimi i tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të përfshijë jo vetëm asetet ekzistuese të shoqërive UK, por edhe ato asete të përfituara nga investimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore, aksionarë të shoqërive UK, që aktualisht nuk janë pjesë e inventarit të këtyre shoqërive si dhe asetet e pushteteve vendore, kryesisht komuna, të cilat deri më tani janë administruar nga sektorë brënda tyre.
Gjithashtu, riorganizimi i shërbimeve UK si funksion i njësive të reja vendore, do të zgjidhë problemin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në lidhje me menaxhimin e shërbimeve UK.
Delegimi nga pronari (këshillat bashkiake) këshillave mbikqyrëse të funksioneve monitoruese e kontrolluese për shoqëritë nuk ka rezultuar efektiv, përkundrazi në mjaft raste kanë patur efekt regresiv.

Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendencat

Enti Rregullator i Ujit si institucion i pavarur në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, është ligjërisht i mandatuar të paraqesë "gjëndjen në sektor dhe rekomandimet e tij në lidhje me masat që duhet të merren për përmirësimin e këtij sektori". Për këtë arsye ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme performancën e sektorit në tërësi dhe atë të shoqërive që ofrojnë shërbime ujësjellës e kanalizime.
Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.
Në vitin 2015, nivelet TKP për sektorin si dhe tendenca e tyre në tre vitet e fundit jepet në Tabelen 1.

Tabela 1, Performanca e Sektorit të ujësjellës kanalizimeve në vitet 2013, 2014 dhe 2015

Treguesit e Performancës	2013	2014	2015	Tendenca e Performancës	Niveli bazë i Performancës së Mire të ERRU	Objektivat e Strategjisë së Sektorit për vitin 2015
Mbulimi I Furnizimit me Ujë (%)	80.8	80.8	81	=	n/a	93
Mbulimi me Kanalizime (%) *	51	51	50	↘	75	85
Cilësia e Ujit të Pijshëm	n/a	n/a		n/a	n/a	n/a
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	11.5	12.1	12.1	=	18	18
Mbulimi i Kostos Totale (%)	84.6	87	79	↘	80	78
Mbulimi i Kostove O&M (%)	113.8	122	102	↘	100	100
Norma e Arkëtimit (%)	82	91	92	↗	82	96
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje U)	9.5	8.9	8.64	↗	4/6/10	n/a
Uji pa të Ardhura (%)	67.4	67.2	67	=	30	45
Niveli i Matjes (%)	59	61.2	64	↗	85	80

Shenim: Burimi informacionit: DPUK

*Kjo nuk do të thotë që është ulur mbulueshmëria me kanalizime nga viti 2014 por kjo vjen si rezultat i rritjes së aksesit ndaj klientëve që ju ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë në zonat rurale e cila nuk është shoqëruar me shërbimin e kanalizimeve.

Në tabelën e mësipërme paraqitet performanca e përgjithshme e sektorit për vitin 2015 krahasuar me objektivat për vitin 2015 të paraqitura në strategjinë aktuale të sektorit, si dhe kundrejt niveleve sfiduese të objektivave për performancë të mirë të vendosura nga ERRU.

Në pamje të parë rezultatet e treguesve të performancës në Tabelen 1 duken kontradiktore dhe paradoksale. Nga njëra anë tregohet që është rritur efiçensa e stafit dhe norma e arkëtimit, dhe nga ana tjetër ka ulje të dukshme të treguesve të mbulimit të kostove direkte të operimit dhe ato totale. Më poshtë jepet në mënyrë të detajuar analiza e secilit tregues, ndikimi dhe ndërveprimi i secilit me treguesit e tjerë, gjë e cila shpjegon dhe paradokset që konstatohen në pamje të parë të tyre.

Në vitin 2015, mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime nuk ka arritur objektivin e strategjisë për sektorin dhe as atë të performancës së mirë të ERRU. Shoqëritë ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë për 81% të popullsisë në zonat e tyre të mbulimit, shërbimi i kanalizimeve i ofrohet vetëm pak më shumë se gjysmës së popullsisë rezidente (50%) . ***Krahasuar me vitin 2014, numri konsumatorëve familjarë që ju ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë në vitin 2015 është rritur me rreth 27600 konsumatorë dhe atyre që ju ofrohet shërbimi i kanalizimeve me rreth 31 000 klientë***. Kjo tregon nivelin e ulët të investimeve fizike për zgjerimin e sistemeve për të cilat duhet të gjenden rrugët dhe mundësitë për t'i rritur ato në nivele më të larta në përgjigje të kërkesave për akses në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Popullsia që jeton në zonat urbane ka më shumë akses në shërbimin e furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujërave të ndotura të ofruar nga shoqëritë UK, 76% e mbulueshmërisë në furnizimin me ujë dhe 98% në shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura i përket zonës urbane.

Popullsia në zonat rurale ka akses kryesisht vetëm në furnizimin me ujë, 24% e kësaj popullsie përfiton shërbimin e furnizimit me ujë dhe vetëm 2% e kësaj popullsie mbulohet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura. Në zonat rurale nivelet e arritura tregojnë se mbulimi me shërbimet UK është larg objektivave të zhvillimit të sektorit.

Niveli mesatar i mbulimit të kostove të O&M me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor në vitin 2015 është 102%. Nëntëmbëdhjetë shoqëri mbulojnë mbi 100% kostot e operimit dhe mirëmbajtjes. Rezultatet tregojnë për një ecuri jo të mirë të sektorit në drejtim të mbulimit të kostove. ***Krahasuar me një vit më parë ky tregues nuk ka pasur tendencë pozitive, niveli i mbulimit të kostove O&M është ulur me rreth 20%.***
Të njëjtën gjë mund të themi edhe për sa i përket mbulimit të kostos totale. Mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është 79%. Në vitin 2015 tre shoqëri kanë arritur të mbulojnë me të ardhurat e tyre të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara. Kryesisht janë shoqëritë e mëdha ato që kanë arritur këtë rezultat. Edhe ky tregues nuk ka pasur tendencë pozitive***. Krahasuar me vitin 2014 niveli i treguesit të mbulimit të kostos totale është ulur rreth 8% krahasuar me vitin 2015.***

Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për sektorin tregon se niveli i mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti nuk ka pasur progres, pasi shoqëritë nuk kanë treguar të njëjtin kujdes si në vitet paraardhëse në drejtim të rritjes së të ardhurave dhe mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve***. Krahasuar me vitin 2014 të ardhurat nga faturimi janë rritur rreth 4% ndërsa kostot rreth 14%***. Niveli i shpenzimeve është rritur pothuajse në të gjitha zërat e kostove. Kostot e punës janë rritur 11%, kostot energjisë elektrike 30%, kostot e riparim e mirëmbajtje 50%, kostot e shërbimeve të kontraktuara 38%. Referuar strukturës së kostos, përqindjen më të madhe në totalin e kostove e zënë kostot e personelit, të energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj rritja e tyre jep edhe ndikimin më të madh në rritjen e kostove.

Figura 1 Struktura e kostos së shërbimeve UK për vitin 2015



Në totalin e kostove pjesën më të madhe e zënë kostot e personelit. Përgjithësisht shoqëritë UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për një numër të vogël shoqërish, niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje. Por për disa të tjerë numri i punonjësve për 1000 lidhje është sa dyfishi i nivelit mesatar të sektorit, gjë e cila bën që kostot e personelit të zënë më shumë se gjysmën e shpenzimeve vjetore të shoqërisë. Këto kosto në vitin 2015 janë rritur si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve në sektor .

Treguesi staf/1000 lidhje ka një ndryshim pozitiv shumë të vogël për faktin se si numri i punonjësve dhe numri i lidhjeve janë rritur pothuajse në të njëjten masë rreth 7% .

Zëri i dytë që zë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove janë kostot e energjisë elektrike. Për shoqëritë që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, dhe veçanërisht për shoqëritë që kryejnë edhe trajtimin e ujërave të ndotura efiçenca e energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë zë të shpenzimeve. ***Në vitin 2015 rritja e shpenzimeve për energjinë elektrike ka ardhur kryesisht si rezultat i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike për*** shoqëritë ***UK në muajin shkurt të vitit 2015***. **Për *konsumin në tension të ulët çmimi është rritur rreth 16%, ndërsa për konsumin në tension të mesëm, i cili zë 3/4 e konsumit të***

***energjisë për sektorin UK, çmimi është rritur rreth* 53%.** Krahasuar me vitin 2014, shpenzimet për energjinë elektrike në sektor janë rritur rreth 558 milion lekë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për përmirësim të efiçencës operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. Ulja e kostos së energjisë elektrike për shërbimin e furnizimit me ujë është e lidhur edhe me përmirësimin e disa treguesve të tjerë si reduktimi i humbjeve, vendosja e matësave, por edhe me një menaxhim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë, të cilat sjellin uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë edhe ulje të konsumit të energjisë.

Në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në përgjithësi shoqëritë i kanë sistemet e furnizimit me ujë me ngritje mekanike. Mjaft prej tyre i kanë me ngritje mekanike edhe sistemet e kanalizimeve, përfshirë dhe ato shoqëri që kanë nën administrim edhe impiantet e pastrimit të ujrave urbane. Mjaft prej këtyre shoqërive kanë probleme të dukshme financiare për mbulimin e kostove direkte, në të cilat pjesa e energjisë elektrike zë "pjesën e luanit". ERRU është në parim kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike për shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve, në veçanti për shoqëritë që nuk janë të qëndrueshme finaciarisht. ERRU është duke bërë një analizë më të hollësishme të kësaj situate për t'i propozuar Entit Rregullator të Energjisë një ulje çmimi të energjisë elektrike për sektorin e furnizimit me uje. Ulja e çmimit të energjisë elektrike për këtë sektor jetik do të mundësojë një frymëmarrje të sektorit të ujit në përgjithësi dhe shoqërive në vështirësi financiare në veçanti.

Nga ana tjetër shoqëritë e ujesjellës kanalizimeve duhet të bëjnë më shumë përpjekje që të bëjnë të mundur zbatimin e një politike të përmirësimit të efiçensës së energjisë që në mjaft raste paraqitet mjaft evidente si për shembull zëvendësimi i një pompe me karakteristika më të mira dhe që nuk kërkon vlera të mëdha për investime fizike. GIZ me anë të financimit të projektit për Kursimin e Energjisë për njëzet e dy (22) shoqëri përcaktoi prioritetet se ku duhet të orientohen këto shoqëri që të përmirësojnë këtë tregues më peshë të konsiderueshme në kostot e operimit të tyre. Duke parë konluzionet e këtij studimi, del e domosdoshme që ky studim të shtrihet për të gjitha sistemet e furnizimit me ujë në të gjithë territorin e vendit.

Edhe shpenzimet e amortizimit zënë një pjesë të rëndësishme në total. Për shoqëritë, për të cilat burimi i financimit të investimeve janë kreditë, kosto e kredisë zë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos. Hartimi i planeve për menaxhimin e aseteve do të bënte të mundur uljen e këtyre shpenzimeve. Planet për menaxhimin e aseteve nënkuptojnë shërbim me kosto më të ulët e me risk të vogël të zotërimit e operimit të aseteve gjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së tyre.

Aktualisht asnjë nga shoqëritë ***nuk disponon plan të menaxhimit të aseteve***. Një nga arsyet e kësaj mangësie është mungesa e njohurive dhe e kapaciteteve nga stafet e shoqërive. Mbetet një sfidë e kohës hartimi dhe përdorimi i këtij instrumenti mjaft të rëndësishëm në kuadrin e manaxhimit të aktivitetit të shoqërive në përgjithësi
Në vitin 2015, ***norma mesatare e arkëtimit në sektor është 92%***. Ky tregues ka tejkaluar objektivin për performancë të mirë të ERRU,por nuk ka arritur objektin strategjik për

sektorin. Në thelb treguesi i normës së arkëtimit është drejtpërdrejt i lidhur me menaxhimin dhe niveli i arritur për këtë tregues shpreh qartësisht punën e vetë shoqërisë. Përgjithësisht shoqëritë edhe gjatë këtij viti kanë treguar vëmendje në drejtim të arkëtimit.Arkëtimi i të ardhurave nga faturimi i konsumatorëve është burimi kryesor i të ardhurave të shoqërive UK si elementi kryesor i realizimit të qëndrueshmërisë financiare të tyre. Nga ana tjetër rritja e qëndrueshmërisë financiare kërkon që shoqëritë UK të realizojnë procesin e arkëtimit në kohë. Për shumë shoqëri paraqitet problematike arkëtimi i borxheve të këqija, për të cilat ato duhet të fuqizojnë përpjekjet për arkëtimin e tyre. ERRU nxit të gjitha shoqëritë që të ndjekin shembullin e performuesve më të mirë në këtë drejtim në mënyrë që të sigurojnë në të ardhmen qëndrueshmërinë e tyre financiare.

Niveli i matjes është treguesi që merr vlerësim pozitiv. Shoqëritë UK kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive. Niveli mesatar i shërbimit të matur në vitin 2015 është 64%. Sektori nuk ka arritur objektivin për zhvillimin e sektorit si dhe atë të performancës së mirë të ERRU për këtë tregues. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi shoqërive të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë. Instalimi i matësave është një proces i cili nga viti në vit ka shënuar zhvillime pozitive, megjithatë niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Shoqëritë të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit janë të pakta në numër. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur. Për një numër të kufizuar shoqërish shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm. Të dhënat tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësave për të gjithë klientët jo familjarë, të cilët e kanë detyrim ligjor vendosjen e tyre me shpenzimet e veta, proces i cili duhet të ishte përfunduar në fund të vitit 2010. Në disa raste kjo kategori konsumatorësh paraqet arsye teknike për mos instalimin e ujëmatësit, por gjithsesi shoqëritë duhet të angazhohen seriozisht për zgjidhjen e këtyre problemeve sepse shpesh këto konsumatorë aforfe nënfaturohen dukshëm për sasitë që ato konsumojnë.

ERRU e konsideron procesin e vendosjes së matësave plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK, prandaj mbështet dhe nxit të gjithë shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësave individualë dhe në prodhim.

Plotësimi i të gjithë sistemeve të furnizimit me ujë me ujëmatësa lidhet direkt me përmirësimin e treguesit "Uji Pa të Ardhura". Rritja e nivelit të matjes në sistemet e furnizimit me ujë normalisht duhej të shoqërohej me ulje të nivelit të Ujit Pa të Ardhura, për pjesën e humbjeve administrative, por niveli i këtyre të fundit ka mbetur i pa ndryshuar. Kjo tregon se nga ana e shoqërive nuk janë bërë përpjekjet e duhura për të përmirësuar aspektet menaxheriale të stafeve të tyre.
Uji Pa të Ardhura, është një tregues i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përbën shqetësimin kryesor në sektor.Pjesa më e madhe e ujit të prodhuar, ose 67% e tij i përket ujit pa të ardhura. Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve nuk mund të arrihen menjëherë, ka vend për reduktimin e tyre, pasi një pjesë e

konsiderueshme i përket humbjeve administrative. Për këtë arsye ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së shoqërive. Eksperienca e shoqërive me performancën më të mirë të këtij treguesi tregon se programet e investimit për zëvendësimin në shkallë të gjërë të infrastrukturës së vjetruar përbën vetëm një aspekt për reduktimin i Ujit Pa të Ardhura.

Elementët bazë të Ujit Pa të Ardhura janë humbjet totale që përbëhen nga humbjet administrative dhe humbjet teknike. ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së shoqërive. Duke patur parasysh që në totalin e humbjeve, kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve teknike kërkon kohë dhe investime, për pjesën e humbjeve administrative mbetet detyrë parësore angazhimi me i madh dhe i programuar i opëratorëve për zvogëlimin e tyre, gjë e cila kërkon kryesisht përmirësimin e aspekteve menaxheriale nga stafet e tyre në drejtim të nënfaturimeve dhe lidhjeve ilegale dhe që nuk kërkojnë investime të konsiderueshme fizike në sisteme.

Analiza e humbjeve bazuar në "Bilancin e Ujit" jep të dhëna të detajuara që i shërbejnë si rregullatorit ashtu edhe shoqërive për vlerësimin e situatës dhe programimin e masave që duhet të merren. Ai shërben si instrumenti i duhur për skanimin e gjëndjes së humbjeve administrative dhe teknike të ujit në sisteme. ERRU i ka kërkuar shoqërive hartimin e Bilanceve të Ujit dhe dorëzimin e tyre ERRU-së bazuar në një model të hartuar prej saj i cili bazohet në modelin e Shoqatës ndërkombëtare të Ujesjellësave (IWA). Në mjaft raste shoqëritë i kanë hartuar Bilancet e Ujit jo sipas standartit të kërkuar dhe me mjaft mungesa në informacion dhe të pa detajuar me nënpërbërësit e secilës kategori humbjeje. Mbetet një sfidë për shoqëritë që të përmirësojnë teknikat dhe angazhimet për hartimin e tyre në përpjekje për të detajuar secilin element të humbjeve teknike dhe ato komerciale në përputhje me modelin e Shoqatës ndërkombëtare të Ujësjellësave (IWA). SHUKALB ka organizuar herë pas herë trajnime në këtë fushë, por konstatohet që këto trajnime duhet të jenë më të plota dhe angazhimi i shoqërive për të sjellë stafin e duhur për trajnim duhet të jetë më serioz.

Në vitin 2015, ***Efiçenca e Stafit është tregues i cili nuk ka pësuar ndonjë ndryshim.*** Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, por ka shoqëri ku efiçenca e stafit është në nivele bashkëkohore.
Kostoja e personelit për momentin zë një përqindje të madhe të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes të shoqërive ujësjellës kanalizime, dhe përbën një element kyç për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërive. Mbipopullimi me staf i shoqërive shkaktohet shpesh nga ndërhyrje politike për punësim të personave jo profesionistë, të cilët jo vetëm shtojnë artificialisht kostot e personelit, por këto persona me mosangazhimin dhe mungesën e profesionalizmit influencojnë edhe në dekurajimin e pjesës së shëndoshë të stafit të shoqërisë.

Reduktimi i stafit në nivelet e duhura arrihet duke optimizuar strukturën organizative me punonjës të kualifikuar e të motivuar dhe duke përcaktuar procedura të brendshme operacionale horizontale dhe vertikale të qarta. Kjo lloj analize dhe organigramat e shoqërive duhet të jenë subjekt i një studimi me ekspertizë në këtë fushë, në të cilën të përcaktohen

edhe detyrat e punës të secilit pozicion, që përgjithësisht bëjnë pjesë në procesin e hartimit të Planit të Biznesit 5 Vjeçarë të shoqërive.

Për sa i përket cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit dhe cilësisë së ujit të pijshëm, performanca e sektorit nuk është ajo e duhura. Në vitin 2015 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2014. Konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 12.1 orë në ditë. Edhe ky tregues nuk ka arritur objektivat strategjikë si dhe atë të performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit. Pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur. Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 4-24 orë ujë në ditë. Shoqëritë që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë vetëm Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh.a. UK Pogradec, Sh.a. UK Librazhd dhe Sh.a. U Bilisht.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Janë dy parametra kryesorë që vlerësojnë sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm, zbatimi i standardeve bakteriologjike (koliformi) dhe përqindja e klorit mbetës. Për ERRU çdo papajtueshmëri me standardet përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve për shërbimin e ofruar.

Ofruesit e shërbimit, megjithëse mund të jenë duke përmirësuar cilësinë e ujit në pikën e furnizimit, nuk garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët për shumë arsye të tjera si furnizimi i ujit me ndërprerje, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluara nga konsumatorët etj.

Përsa i përket cilësisë së ujërave të ndotura, situata nuk ka ndryshuar. Në të gjithë vendin funksionojnë 5 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura të cilat përpunojnë ujërat e ndotura për një numër të kufizuar konsumatorësh. Me vënien në funksionim të impianteve të tjerë situata do të vijë duke u përmirësuar. Rritja e nivelit të trajtimit të ujërave të ndotura do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e jetesës së konsumatorëve.

3.Analiza performancës për shoqëritë ujësjellës kanalizime

Në këtë pjesë të raportit analizohet dhe vlerësohet performanca individuale e shoqërive ujësjellës kanalizime për vitin 2015 si dhe ecuria e tyre që nga viti 2013. Metoda e përdorur për vlerësim bazohet në 10 treguesit kryesorë të performancës. Në vijim secili prej tyre është përshkruar shkurtimisht.

3.1.Treguesit kryesorë të performancës

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime bazohet në 10 tregues kryesorë të performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të punës së shoqërive duke na dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve. Të dhënat e treguesve të perfomacës vjetore të shoqërive ERRU i merr nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking në DPUK.
Treguesit kryesore të performancës jepen në Tabelën 2.

Tabela 2. Pasqyra e treguesve kryesorë të performancës 2015

TKP	Përshkrimi
1 – Mbulimi i Kostove O&M	Pjesa e kostove operative dhe mirëmbajtjes (përjashtuar amortizimin dhe kostot kapitale) që mbulohen nga të ardhurat.
2 – Mbulimi i Kostos Totale	Pjesa e kostove totale për shërbimet e ofruara që mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë.
3 – Norma e Arkëtimit	Raporti ndërmjet të ardhurave të arkëtuara dhe shumës së faturuar ndaj klientëve.
4 – Efiçenca e Stafit	Numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje UK
5 – Uji pa të Ardhura	Pjesa e ujit të prodhuar që nuk i faturohet klientëve.
6 – Niveli i Matjes	Pjesa e lidhjeve me matës (numri i klientëve) si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të lidhjeve (klientëve).
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	Orët mesatare të furnizimit me ujë në ditë.
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm	Pjesa e testeve për cilësinë e ujit të cilat përmbushin standardet bakteriologjike (koliforme) dhe ato të klorit mbetës.
9 – Mbulimi me Kanalizime	Pjesa e popullsisë brenda zonës së shërbimit të një shoqërie të cilës i ofrohet shërbim kanalizimi, por jo domosdoshmërisht trajtimi i ujërave të ndotura.
10 – Perceptimi Rregullator	Është vlerësimi i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kuadrin rregullator.

Nisur nga objektivi i ERRU për të pasur një sektor financiarisht të qëndrueshëm i cili ofron shërbime me cilësinë më të mirë të mundshme për konsumatorët, treguesit e performancës që vlerësojnë çdo shoqëri më vete dhe sektorin në përgjithësi janë përzgjedhur të tillë që të vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe performancën e shërbimit tek konsumatorët. Në këtë kuptim kemi analizuar fillimisht performancën individuale të çdo shoqërie e më pas janë krahasuar nivelet e arritura ndërmjet shoqërive, duke identifikuar performuesit më të mirë dhe praktikat më të mira në vend.

Niveli i treguesve të performancës nxjerr në pah ndikimin e faktorëve të brendshëm si përmirësimi i menaxhimit, por edhe efektin e faktorëve të jashtëm si investimet nga Qeverisja Qendrore, grantet e donatorëve etj. Nivelet e arritura të treguesve si niveli i matjes apo mbulimi me shërbimet e kanalizimeve nuk varen vetëm nga puna e ofruesve të shërbimit, pasi për të rritur nivelin e tyre kërkohen investime kapitale. Por, shumë tregues të tjerë si norma e arkëtimit, efiçenca e stafit, uji pa të ardhura si dhe mbulimi i kostove varen drejtpërsëdrejti nga puna e shoqërive. Përpjekjet e brëndshme të shoqërive luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e tyre.

Perceptimi rregullator është një tregues tjetër i analizës, përmes të cilit vlerësohet bashkëpunimi i shoqërive në proçesin rregullator duke mbështetur përpjekjet e ERRU për të krijuar një mjedis rregullator transparent dhe të qëndrueshëm.

Analiza e performancës: Grupet e shoqërive

Në mënyrë që vlerësimi krahasues i performancës ndërmjet shoqërive të jetë sa më real, ERRU ka vendosur që shoqëritë ujësjellës kanalizime të grupohen sipas numrit të lidhjeve të furnizimit me ujë të pijshëm, si një mënyrë e mirë për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha apo të vogla.

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës	11
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	20[2]
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës	24

Tabela 3. Grupi i shoqërive

Burimi informacionit: ERRU

[1] Pjesë e analizës nuk janë Sha UK Himarë në grupin e dytë dhe Sha U Bradashesh në grupin e tretë pasi nuk kanë raportuar të dhëna.

Në Tabelën 4 pasqyrohet ndarja e shoqërive sipas grupeve.

Tabela 4. Ndarja e shoqërive në tre grupe

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			**Grupi 3**		
UK	Tiranë	197,722	UK	Delvinë	2,832
UK	Durrës	75,507	U	Divjakë	2,798
UK	Vlorë	44,436	U	Bulqizë	2,746
UK	Elbasan (Q)	31,249	UK	Fushë-Krujë	2,535
UK	Fier	30,034	UK	Peqin	2,473
UK	Shkodër	27,708	U	Ura-Vajgurore	2,404
UK	Berat -Kuçovë	25,025	U	Novoselë	2,300
UK	Kavajë	24,220	U	Orikum	1,948
UK	Korçë	22,445	U	Çorovodë	1,883
U	Elbasan Fshat	17,585	UK	Ersekë	1,654
UK	Sarandë	15,068	U	Poliçan	1,579
Grupi 2			U	Selenicë	1,509
UK	Pogradec	14,345	U	Tropojë	1,495
UK	Lushnje	11,193	UK	Mirditë	1,359
UK	Gjirokastër	9,462	U	Has	1,351
UK	Lezhë	8,787	UK	Bashkia Pukë	1,105
U	Korçë Fshat	6,990	U	Këlcyrë	1,002
U	Lushnje Fshat	6,488	U	Vau Dejës	942
U	Kurbin	6,054	UK	Libohovë	783
U	Shkodër Fshat	5,841	UK	FushëArrëz	604
UK	Librazhd	5,191	UK	Rubik	578
UK	Kukës	5,026	UK	Pukë Fshat	523
U	Patos	4,747	UK	Krastë	420
UK	Mallakastër	4,339	U	Gjirokastër Fshat	384
UK	Burrel	4,326			
U	Gramsh	4,047			
UK	Rrogozhinë	4,015			
UK	Krujë	3,668			
UK	Tepelenë	3,550			
U	Peshkopi	3,497			
U	Përmet	3,426			
UK	Bilisht	3,243			

Burimi i informacionit ERRU

Analiza e performancës në lidhje me objektivat e vendosur nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar nivelet për vlerësimin e performacës së shoqërive, përkatësisht niveli i performancës së mire, si dhe ato që përfaqësojnë një performancë të pranueshme dhe të dobët. Grafikisht të ndara në kufij këto nivele performance jepen në Figuren 2. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit mbi të cilën performanca vlerësohet e mirë, ndërsa vija e kuqe në grafik tregon që niveli i performancës poshtë saj konsiderohet i dobët.

Figura 2 : Shembull i Grafikëve të Analizës së TKP-ve



Për përcaktimin e performancës së shoqërive ERRU ka përzgjedhur dhjetë (10) tregues performance, të cilat llogariten për çdo shoqëri me vehte. ERRU ka përcaktuar me anë të Tabelës 5 kategorizimin e vlerësimeve të performancës së shoqërive sipas kategorive mirë, pranueshëm ose dobët, duke krahasuar me vlerat e llogaritura të indikatorëve të performancës të secilës shoqëri me ato të këtyre tre kategorive. Vlerat krahasuese të kategorive mirë, pranueshëm dhe dobët jepen në Tabelën 5.

Tabela 5.Kategorizimi i vlerësimit të Treguesve kryesorë të Performancës

Treguesit kryesorë të performancës		Vlerësimi		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efiçenca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje)[3]	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤ 8 orë/ditë
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm		≥ 95%	90 - 95%	≤ 90%
9 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%
10 – Perceptimi Rregullatorit		n/a	n/a	n/a

Renditja e Shoqërive Ujësjellës Kanalizime

Në këtë pjesë është vlerësuar performanca e përgjithshme e secilës prej shoqërive bazuar në vlerësimin e 9 treguesve nga 10 në total. Për të bërë krahasimin e shoqërive ujësjellës kanalizime, renditja e tyre bazohet në shumën totale të pikëve të grumbulluara nga analiza e detajuar e secilit TKP.

Çdo treguesi i është caktuar një peshë specifike dhe pikët e dhëna pasqyrojnë performancën e shoqërisë kundrejt niveleve të objektivave të vendosura nga ERRU.

Performancës së barabartë ose mbi nivelin e objektivit të synuar të vendosur nga ERRU i jepen pikët maksimale. Për shumicën e treguesve, kur performanca është nën objektivin e synuar për performancë të mirë shoqëria vlerësohet vetëm me një pjesë të pikëve të përcaktuara. Për treguesit si efiçenca e stafit, ujit pa të ardhura, norma e arkëtimit dhe cilësia e ujit të pijshëm, performanca e dobët penalizohet rëndë duke mos i dhënë asnjë pikë. Në këtë

[3] Për TKP Eficienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me dendësi popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

rast, vlerësimi me pikë bëhet nëse performanca aktuale është brenda kufirit të performancës së pranueshme.

Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave

Treguesit kryesorë të performancës janë përllogaritur mbi bazën e të dhënave të raportuara nga shoqëritë ujësjellës kanalizime në Njësinë e Monitorimit pranë DPUK. Saktësia, besueshmëria dhe kontrolli në kohë i të dhënave luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së shoqërive. Gjatë analizës së performancës së vitit 2015, janë konstatuar mungesa në raportim si dhe raportime jo të sakta. Për ERRU, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave merr një rëndësi jo vetëm për vlerësimin e performancës së sektorit dhe shoqërive UK në këtë raport, por edhe për të pasur një vendimmarrje sa më korrekte në lidhje me liçencimin e shoqërive, vendosjen e tarifave dhe monitorimin e objektivave të vendosura për shoqëritë UK. Duke patur parasysh rëndësinë e saktësisë së të dhënave ERRU e ka konsideruar shumë të rëndësishëm aspektin e saktësisë së tyre. ERRU do të angazhohet për të patur një bazë të pavarur të dhënash të domosdoshme për llogaritjen e treguesve bazë të performancës të cilat do të jenë subjekt i verifikimit të vazhdueshëm të saktësisë së tyre. ERRU disponon ekspertizën dhe logjistikën e kërkuar për të realizuar verifikimin e saktësisë së të dhënave të shoqërive.

3.1.1 Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes

Një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie është “Mbulimi i kostove O&M”. Ky tregues tregon se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij.
Në vitin 2015, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 102% nga 122% që ishte në vitin paraardhës. Tendenca nuk është pozitive pavarësisht se treguesi e ka kaluar nivelin e objektivit të performancës së mirë. Sektori në këtë tregues ka pësuar një rënie të ndjeshme, e cila është rrjedhoje e përkeqësimit të raportit të ardhura shpenzime. Rritja e të ardhurave nga aktiviteti kryesor me 4 % nuk ka mbuluar rritjen e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes me 21%.

Grupi i parë i shoqërive

Në grupin e parë, bëjnë pjesë shoqëritë e mëdha ku treguesi "Mbulimi i kostove O&M" ka disa vite radhazi që për pjesën më të madhe të shoqërive të këtij grupi është mbi 100%.
Figura 3. jep në formë grafike grupin e parë të shoqërive në lidhje me performancën e treguesit të "Mbulimit të kostove të O&M".

Niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 7 shoqëri, Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Tiranë, Sh.a. UK Berat-Kuçovë, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Elbasan, Sh.a. UK Fier dhe Sh.a. UK Shkodër.
Për vitin 2015, në grupin e parë shoqëria me performancën më të mirë vazhdon të jetë Sh.a. UK Korçë ku mbulimi i kostove të O&M është në nivelin 194.28% nga 178% që ishte në vitin paraardhës. Vlen të theksojmë që kjo shoqëri është e vetmja në këtë grup që ka rritje të këtij treguesi me (+16.28%).

Shoqëria me performancën më të dobët vazhdon të jetë për të tretin vit radhazi Sh.a. U Elbasan Fshat, ku mbulimi i kostove O&M është 56.92%, rezultat i cili është përkeqësuar krahasuar me një vit më parë pasi niveli i mbulimit të kostove është ulur me (-4.28%). Në kufirin e performancës së dobët gjenden gjithashtu edhe Sh.a. UK Kavajë dhe Sh.a. UK Durrës respektivisht me 73.21% dhe 66.48%.

Figura 3. Mbulimi i kostove O&M për grupin 1, viti 2015



Sh.a. UK Tiranë, Sh.a. UK Berat Kuçovë, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Elbasan dhe Sh.a. UK Shkodër edhe pse kanë nivel të lartë të këtij treguesi duhet theksuar se

për vitin 2015 kanë shënuar rënie të ndjeshme në drejtim të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Ulja e nivelit të mbulimit të kostove për Sh.a. UK Vlorë me (-14.66) ka bërë që kjo shoqëri të kalojë nga shoqëri me performancë shumë të mirë në shoqëri me performancë të pranueshme, ndërsa për Sh.a. UK Durrës dhe Kavajë ulja me (-24.52) dhe (-24.79) ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga shoqëri me performancë të pranueshme në shoqëri me performancë të dobët.

Grupi i dytë i shoqërive

Në vitin 2015, në grupin e dytë janë 9 shoqëri që kanë arritur të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, pra që renditen në shoqëritë me performancë të mirë. Shoqëria me performancën më të mirë rezulton të jetë Sh.a. U Burrel e cila mbulon 240% të kostove O&M. Ky rezultat nuk është real pasi ka të bëjë me raportimin jo të saktë të të dhënave pranë Njësisë së Monitorimit, problem i konstatuar edhe në vitin 2014. Referuar të dhënave të bilancit financiar të Sh.a. U Burrel për vitin 2014 mbulimi i kostove O&M rezulton 114%. Për këtë arsye kjo shoqëri nuk mund të klasifikohet si shoqëria me performancën më të mirë në këtë grup. Sh.a. U Burrel ende nuk ka dorëzuar bilancin financiar të vitit 2015, prandaj edhe nuk kemi një rezultat të saktë të këtij treguesi.

Shoqëria me mbulimin më të mirë të kostove O&M është Sh.a. UK Pogradec me 138.55%, rezultat i cili është përmirësuar (+4.55%) në vitin 2015 krahasuar me vitin paraardhës.
Edhe për këtë vit Sh.a. U Patos është shoqëria me performancën më të dobët ku niveli i mbulimit të kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti është vetëm 17.95%. Për tre vite rresht kjo shoqëri jo vetëm ka nivelin më të ulët të këtij treguesi në grupin e dytë por edhe tendenca ka qenë negative. Në brezin e performancës së dobët renditen edhe 8 shoqëri të tjera. Për këto shoqëri niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes është larg nivelit të objektivit 80% të performancës së pranueshme. Për Sh.a. U Kurbin, Sh.a. UK Rrogozhinë, Sh.a. UK Shkodër Fshat, Sh.a. UK Korçë Fshat dhe Sh.a. UK Tepelenë, mbulimi i kostove O&M varion nga 41.28% deri në 53.1%.

Në brezin e performancës së pranueshme renditen Sh.a. UK Lushnje Qytet me 93.06% të mbulimit të kostove O&M si dhe Sh.a. UK Kukës me 82.3%.

Figura 4.Mbulimi i kostove O&M për grupin 2 në vitin 2015



Në grupin e dytë, shoqëria me ecurinë më të mirë në mbulimin e kostove të O&M është Sh.a. U Mallakastër e cila vazhdon të jetë në brezin e performancës së dobët. Krahasuar me vitin 2014 niveli i këtij treguesi është rritur me 17.61%. Progres për këtë tregues ka pasur edhe Sh.a. U Gramsh, Sh.a. UK Krujë dhe Sh.a. UK Kukës. Në grupin e shoqërive me performancë të dobët janë dhe tre shoqëri, konkretisht Sh.a. U Lushnje Fshat, Sh.a.U Korçë Fshat dhe Sh.a. UK Tepelenë që kanë bërë përpjekje për përmirësimin e këtij treguesi,
por progresi ka qenë i vogël dhe niveli i mbulimit të kostove vazhdon të jetë i ulët.
Sh.a. U Peshkopi dhe Sh.a. UK Lezhë edhe pse renditen në shoqëritë me performancë të mirë në mbulimin e kostove O&M, këtë vit tendenca e këtij treguesi për këto shoqëri ka qenë negative. Niveli i mbulimit të kostove O&M është ulur për Sh.a. U Peshkopi me (-17.24%) dhe për Sh.a. UK Lezhë me (-9.34%). Tendencë negative të ndjeshme ky tregues ka pasur për Sh.a. U Shkodër Fshat (-22.22%) Sh.a. UK Peshkopi (-17.24%), Sh.a. UK Lushnje (-12.94%) dhe Sh.a. U Përmet (-10.49%)
Ulja e nivelit të mbulimit të kostove për Sh.a. UK Lushnje ka bërë që kjo shoqëri të kalojë nga shoqëri me performancë të mirë në shoqëri me performancë të pranueshme dhe Sh.a.U Përmet nga shoqëri me performancë të pranueshme në shoqëri me performancë të dobët. E kundërta ka ndodhur me Sh.a. UK Kukës. Progresi i këtij treguesi ka bërë që shoqëria të kalojë nga shoqëri me performancë të dobët në atë të performancës së pranueshme.
Krahasuar me vitin 2014, nga 20 shoqëri të këtij grupi 10 shoqëri e kanë përmirësuar këtë tregues në vitin 2015 dhe 10 të tjera e kanë përkeqësuar atë.

Grupi i tretë i shoqërive

Në këtë grup, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për mbulimin e kostove O&M është arritur vetëm nga dy shoqëri. Sh.a. UK Ersekë dhe Sh.a. U Bulqizë respektivisht me 109.32%,dhe 102.73%. Sh.a.UK Ersekë ka vazhduar të jetë shoqëria me performancën më të mirë në grup megjithëse niveli i mbulimit të kostove për këtë shoqëri është ulur me (-30.68%) krahasuar me vitin 2014.

Në zonën e performancës së pranueshme renditen 5 shoqëri, ndër të cilat edhe Sh.a. UK Krastë, e cila në vitin 2014 bënte pjesë në grupin e shoqërive me performancë të dobët. Krahasuar me vitin 2014 shoqëria rriti nivelin e mbulimit të kostove O&M me (+25.68%). E kundërta ka ndodhur me Sh.a. U Tropojë e cila nga performuese e mirë në vitin 2014 me 130% ka kaluar në nivelin e performancës së pranueshme me 92.18% të mbulimit të kostove për vitin 2015. Shoqëri të tjera me performancë të pranueshme janë edhe Sh.a. UK Pukë me 90.97%; Sh.a. UK Rubik me 87.44% si dhe Sh.a. U Delvinë me 83.61%.

Nga 24 shoqëritë e këtij grupi, 17 prej tyre renditen nën vijën e kuqe, pra në brezin e performancës së dobët. Shoqëria me performancën më të dobët është Sh.a. U Vau Dejës, që mbulon vetëm 26.3% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Rezultatet tregojnë se 12 shoqëri nuk arrijnë të mbulojnë as 50% të kostove O&M. Konkretisht mbulimet e kostove janë për: Sh.a. UK Pukë Fshat 28.1%, Sh.a. U Gjirokastër Fshat 32.09%, Sh.a. U Poliçan 32.75%, Sh.a. U Orikum 35.07%, Sh.a. U Çorovodë 35.7%, Sh.a. U Selenice 38.8%, Sh.a. U Has 41.51%, Sh.a. UK Libohovë 41.53%, Sh.a. U Novoselë 44.06%, Sh.a. UK Fushë Arrëz 47.08% si dhe Sh.a. UK Fushë Krujë 49.43%.

Në grupin e shoqërive me performancë të dobët bëjnë pjesë edhe pesë shoqëri dhe konkretisht Sh.a. U Ura Vajgurore, Sh.a. UK Peqin, Sh.a. U Këlcyre, Sh.a. UK Mirditë si dhe Sh.a. U Divjakë ku mbulimet e kostove O&M variojnë nga 51% deri në 70%.

Figura 5.Mbulimi i kostove O&M për grupin 3 në vitin 2015



Tendenca e këtij treguesi për shoqëritë e këtij grupi nuk është pozitive. Në vitin 2015, niveli i mbulimit të kostove O&M ka tendencë pozitive vetëm për katër shoqëri. Shoqëria me ecurinë më të mirë në grup është Sh.a. UK Krastë e cila e ka rritur nivelin e mbulimit të kostove me (+25.68%) krahasuar me vitin 2014. Ndërsa për Sh.a. UK Rubik, Bashkia Pukë dhe Sh.a. U Gjirokastër Fshat rritja nuk është më shumë se 5%. Për 20 shoqëritë e tjera , pra për pjesën më të madhe, tendenca e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes është negative ose ka mbetur në të njëjtat nivele me vitin 2014.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se shoqëritë UK nuk kanë bërë përpjekje për të rritur nivelin e mbulimit të kostove O&M, për rrjedhojë niveli i mbulimit të kostove O&M për sektorin për vitin 2015 nga 122% që ishte vitin 2014 u ul në 102% në vitin 2015.

Në sektor , 18 shoqëri kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 8 renditen në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 29 shoqëri janë në nivelin nën 80%, prej të cilave 16 shoqëri nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M. Këto të fundit nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot. Vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbetet e varur nga subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit.

Në vitin 2015, në përgjithësi shoqëritë UK nuk kanë punuar mirë në drejtim të mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve dhe nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të rritur të ardhurat. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes janë rritur me rreth 21% ndërsa të ardhurat nga aktiviteti

kryesor vetëm 4%. Në vitin 2015 pothuajse të gjithë zërat e kostos së operimit dhe mirëmbajtjes janë rritur krahasuar me një vit më parë. Por ndikimi më i madh ka ardhur nga rritja e kostove të energjisë dhe kostove të punës të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Krahasuar me vitin 2014, 50% e rritjes së kostove të operimit dhe mirëmbajtjes ka ardhur si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe rreth 25% nga rritja e kostove të punës, këto të fundit janë rritur si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve, që përgjithësisht është i pajustifikuar.
ERRU e konsideron mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer gjë e cila është reflektuar edhe në Metodologjinë për vendosjen e tarifave të ERRU.
Për ERRU rritja e të ardhurave duhet të vijë jo vetëm nga rritja e tarifave, por edhe përmes përpjekjeve sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik.

Qëndrueshmëria financiare e shoqërive UK është e lidhur me shumë tregues si Uji pa të Ardhura, niveli i matjes, niveli i faturimit, efiçenca e stafit, norma e arkëtimit e tjerë. Rezultatet e performancës së këtyre treguesve ndikojnë jo vetëm tek njëri tjetri por edhe në gjëndjen ekonomiko financiare të shoqërisë. Në vitin 2015 pjesa më e madhe e shoqërive UK rezultojnë me bilanc negativ.

3.1.2 Mbulimi i kostove totale

Objektivi kryesor i çdo shoqërie është mbulimi i të gjitha kostove për shërbimet e kryera me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e saj kryesore. Bazuar në strategjinë e qeverisë për sektorin ky objektiv do të arrihet gradualisht, duke filluar së pari me mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes për të kaluar më pas në mbulimin e kostos totale.

Nisur nga analiza e mbulimit të kostove të operimit mirëmbajtjes, pritshmëritë për nivelin dhe tendencën e mbulimit të kostos totale janë të parashikueshme. Për sa kohë shoqëritë të cilat kanë nivel të ulët dhe/apo tendencë negative në treguesin e parë detyrimisht hendeku thellohet në treguesin e dytë, mbulimi i kostos totale. Kjo për faktin se me të ardhurat nga aktiviteti duhet të mbulohen më shumë kosto, pasi kostove të operim mirëmbajtjes i shtohen amortizimi dhe kostot e kredive.

Në vitin 2015, mesatarja për mbulimin e kostove totale për sektorin është 79%. Niveli i arritur është afër nivelit të objektivit të performancës së mirë të vendosur nga ERRU dhe ka arritur objektivin e strategjisë për sektorin, por tendenca nuk ka qenë pozitive. Për tre vite rresht niveli i mbulimit të kostove totale ka shënuar progres, ndërsa në vitin 2015 krahasuar me një vit më parë niveli i mbulimit të kostos totale për sektorin ulet me 8%.

Grupi i parë i shoqërive

Siç shihet edhe nga grafiku i mëposhtëm, niveli i mbulimit të kostos totale për shoqëritë e grupit të parë është i ndryshëm. Për vitin 2015 janë 5 shoqëri që renditen në nivelin e performancës së mirë me mbi 80% të mbulimit të kostove dhe konkretisht Sh.a. UK Tiranë 113%, Sh.a. UK Berat-Kuçovë 93%, Sh.a. UK Fier 92.7%,Sh.a. UK Korçë 86.7% si dhe Sh.a. UK Sarandë 84.7%.

Në brezin e performancës së pranueshme gjenden shoqëritë Sh.a. UK Shkodër 70.8.%, Sh.a. UK Elbasan me 70.9%, Sh.a. UK Vlore me 65% dhe Sh.a. UK Durrës me 52.1%. Sh.a.
UK Elbasan Fshat me 48.5% dhe Sh.a.UK Kavajë me 46.2% të mbulimit të kostos totale, vazhdojnë të qëndrojnë në brezin e shoqërive me performancë të dobët.

Figura 6. Mbulimi i kostos totale për grupin 1 në vitin 2015



Gjatë vitit 2015, shumica e shoqërive të grupit të parë janë në nivele të mira të mbulimit të kostos totale, megjithatë me përjashtim të Sh.a. UK Sarandë që e ka përmirësuar këtë tregues nga 82% në 84.7%, për shoqëritë e tjera tendenca nuk ka qenë pozitive krahasuar me vitin 2014. Sh.a. UK Tiranë edhe pse është shoqëria me performancën më të mirë, niveli i mbulimit të kostos totale ka pasur tendencë negative duke rënë me (-9.96%). Rënien më të ndjeshme të këtij treguesi në këtë grup e kanë shënuar Sh.a. UK Shkodër me (-29.15%) dhe Sh.a. UK Elbasan (-26.47). Kjo ulje ka bërë që këto shoqëri nga niveli i performancës së mirë të renditen në nivelin e performancës së pranueshme. Po kështu ulja e nivelit të mbulimit të kostos totale për Sh.a. UK Kavajë me (-12.67%) dhe Sh.a. U Elbasan Fshat (-8.46%), ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga niveli i performancës së pranueshme në nivelin e performancës së dobët.

Grupi i dytë i shoqërive

Në grupin e dytë, niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë është tejkaluar nga 5 prej 21 shoqërive të këtij grupi, Sh.a UK Gjirokastër me 101.54%, Sh.a. U Gramsh me 94.89%, Sh.a.U Peshkopi me 91.62%, Sh.a. UK Librazhd me 84.35% të mbulimit të kostove totale. Sipas të dhënave të raportuara nga Sh.a. UK Burrel rezulton se kjo shoqëri mbulon 206.29% kostot totale. Ky rezultat nuk është real pasi ka të bëjë me raportimin jo të saktë të të dhënave pranë Njësisë së Monitorimit, problem i konstatuar edhe në vitin 2014. Referuar të dhënave të bilancit financiar të Sh.a. U Burrel për vitin 2014 (shoqëria nuk e ka paraqitur bilancin financiar të vitit 2015), mbulimi i kostove totale me të ardhurat nga aktiviteti rezulton 100%. Për këtë arsye kjo shoqëri nuk mund të renditet e para.

Në nivelin e performancës së pranueshme në kufirin 50%-80% të mbulimit të kostove totale renditen 7 shoqëri, konkretisht, Sh.a. UK Pogradec me 77.76%, Sh.a. U Përmet me 67.92%, Sh.a. UK Lezhë me 70.24%, Sh.a. UK Lushnje me 63.43% ,Sh.a UK Mallakastër me 60.80%, Sh.a. UK Bilisht me 58.36% dhe Sh.a. UK Kukës me (53.99%).

Në kufirin e performancës së dobët janë 8 shoqëri, Sh.a. U Kurbin, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Tepelenë, Sh.a. UK Shkodër Fshat, Sh.a. UK Mallakastër, Sh.a. UK Rrogozhinë, Sh.a. U Korçë Fshat dhe Sh.a. U Lushnje Fshat mbulimi i kostos totale arrin deri në 48%. Sh.a. U Patos vazhdon të renditet e fundit për të tretin vit radhazi me nivelin më të ulët të këtij treguesi (17.08%).

Figura 7.Mbulimi i kostos totale për grupin 2 në vitin 2015



Gjatë vitit 2015 për 8 shoqëri ky tregues ka pasur progres krahasuar me vitin 2014. Shoqëritë që kanë pasur ecurinë më të mirë pozitive janë Sh.a. U Lushnje Fshat me (5.75%), Sh.a. U Korçë Fshat me (5.19%) si dhe Sh.a. U Tepelenë me (0.73%).

Për 9 shoqëri të këtij grupi tendenca ka qenë negative. Rënien më të madhe e ka shënuar Sh.a. UK Bilisht me (-41.64%), e cila nga një shoqëri që mbulonte 100% kostot totale në vitin 2014, në vitin 2015 ka arritur të mbulojë 58.36% të këtyre kostove. Edhe për Sh.a. UK Lezhë tendenca e këtij treguesi nuk ka qenë pozitive, niveli i mbulimit të kostos totale është ulur me (-20.76%) nga 91.00% që ishte në vitin 2014 ka arritur në 70.24% në vitin 2015. Kjo tendencë negative ka bërë që dhe shoqëritë të zhvendosen nga vendet që kishin në klasifikimin e vitit 2014 dhe konkretisht Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Përmet nga

performancë e mirë kanë kaluar në brezin e performancës së pranueshme. Gjithashtu tendencë negative në mbulimin e kostos totale kanë Sh.a. UK Lushnje Qytet me (-10.57%) dhe Sh.a. U Kurbin (-8.95%).

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë dy shoqëri renditen mbi nivelin e objektivit të vendosur nga ERRU prej 80% për performancë të mirë dhe konkretisht Sh.a. U Ersekë (83.39%), e cila ka nivelin më të mirë të këtij treguesi në këtë grup si dhe Sh.a. UK Bulqizë me (80.90%).

Në brezin e performancës së pranueshme renditen 8 shoqëri, Sh.a. U Rubik me 65.59%, UK Bashkia Pukë me 76.14% , Sh.a. UK Delvinë me 75.10%, Sh.a. U Peqin 65.45%, Sh.a. U Ura Vajgurore me 66.41%, Sh.a. UK Këlcyrë me 54.22%, Sh.a. U Tropojë me 63.33%, Sh.a. UK Mirditë me 52.35%.

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi nuk mbulojnë as 50% të kostos totale. Nivelet më të ulëta të mbulimit të kostos totale shënohen nga Sh.a. U Orikum me 29.66%, Sh.a. U Çorovodë me 29.04% dhe Ndërmarrja U Gjirokastër Fshat 27.37% .Sh.a. UK Selenicë ,Sh.a. U Vau i Dejës dhe Sh.a. UK Pukë Fshat me 20.60%.

Figura 8. Mbulimi i kostos totale për grupin 3 në vitin 2015



Performanca e shoqërive të këtij grupi jo vetëm për nivelin, por edhe për ecurinë nuk është e mirë. Ndonëse, niveli i mbulimit të kostos totale krahasuar me një vit më parë është përmirësuar nga 9 shoqëri, ndryshimet pozitive përgjithësisht kanë qenë në nivel të ulët duke mos shënuar përmirësim të dukshëm të situatës. Sh.a. UK Pukë Fshat ka ecurinë më të mirë në grup me një rritje të mbulimit të kostos totale me (7.14%).

Për trembëdhjetë shoqëri tendenca e këtij treguesi ka qenë negative. Rënie të theksuar të mbulimit të kostove kanë shënuar Sh.a. U Tropojë (-38.67%), Sh.a. UK Këlcyrë (-20.41%), Sh.a. U Ersekë (-29.11%).
Ky grup është ende shumë larg objektivit strategjik të mbulimit të kostove.

Përfundime

Niveli mesatar i mbulimit të kostove totale për sektorin UK në vitin 2015 si dhe ecuria e këtij treguesi tregojnë se disa nga shoqëritë UK janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbuluar me të ardhurat e tyre kostot e shërbimeve të ofruara. Analiza e performancës tregon se rezultatet më të mira të mbulimit të kostos totale janë arritur nga shoqëritë e mëdha ujësjellës kanalizime, ndërsa shumica e shoqërive të vogla vazhdojnë të varen nga burimet e jashtme financiare. Në vitin 2015 rritja e shpenzimeve ka qenë më e madhe se sa rritja e të ardhurave në sektor. Kjo gjë ka bërë që nivelet e mbulimit të kostove të ulen.

Në tabelën **6** mëposhtë është paraqitur ecuria e zërave kryesorë të shpenzimeve dhe të ardhurave për periudhën 2013 - 2015.

Tabela 6.Ecuria e zërave kryesorë të shpenzimeve dhe të ardhurave 2013-2015

			000/lek
Emërtimi	2013	2014	2015
Kostot e punës	2,529,386	2,558,318	2,840,900
Energjia	1,831,898	1,861,948	2,419,476
Riparim dhe mirëmbajtje	705,783	406,313	607,931
Materiale e kimikate	233,970	250,210	214,895
Të tjera	225,567	154,574	227,631
Shërbimet e kontraktuara	208,217	248,064	337,162
Totali i kostove O&M	5,734,821	5,479,426	6,647,993
Amortizimet	1,410,319	1,518,904	1,496,879
Shpenzime financiare	576,149	468,014	450,109
Provigjonet	438,704	236,792	223,917
Kostot TOTALE	8,159,993	7,703,136	8,818,898
Të ardhura nga aktiviteti UK	6,049,689	6,344,062	6,616,196
Të ardhura të tjera që lidhen me aktivitetin	474,542	366,696	169,653
Të ardhurat totale UK	6,524,231	6,710,758	6,785,849
Subvencione	586,998	439,999	430,000
Të ardhura të tjera financiare	151,846	87,556	110,910
Totali i të ardhurave nga të gjitha burimet	7,263,076	7,238,312	7,326,759

Edhe për këtë vit ruhet e njëjta strukturë kostoje ku pjesën më të madhe në totalin e kostos e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, për disa shoqëri edhe kostot e kredisë.
Kostot totale përllogariten duke i shtuar kostove O&M kostot e amortizimit, të interesave të kredisë si dhe provigjonet. Për vitin 2015 të tre këto zëra (amortizimi , interesat e kredisë si dhe provigjonet) janë pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës, çka do të thotë se në rritjen e nivelit të kostove totale ka ndikuar rritja kostove të operimit e mirëmbajtjes. Si edhe kemi theksuar në analizën e treguesit "Mbulimi i kostove të Operimit dhe Mirëmbajtjes", në rritjen e këtyre kostove ka ndikuar rritja në zërat: kosto e energjisë, paga e shpenzime dhe shpenzime të tjera. Në se çmimi i energjisë elektrike nuk do të kishte ndryshuar për vitin 2015 mbulimi i kostove totale do të ishte rreth 83%.

Gjatë tre viteve të fundit, kostot kapitale zënë mesatarisht rreth 25%-30% të totalit të kostove. Megjithatë ka shoqëri, si Sh.a. UK Korçë ku kostot kapitale (amortizim+kosto e kredisë) zënë mbi 50% të totalit të kostove. Kjo shoqëri arrin të mbulojë kostot O&M në nivelin 194%. Kostot e larta kapitale e zbresin mbulimin e kostove totale në nivelin 87%. Në të njëjtën situatë ndodhen edhe ato shoqëri që kanë filluar shlyerjen e kredive për investime.
Për shoqëritë UK burimi kryesor i të ardhurave janë të ardhurat nga aktiviteti kryesor, por krahas tyre ato realizojnë edhe të ardhura të tjera që vijnë nga burime të tjera siç janë subvencionet e shfrytëzimit të akorduara nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat financiare. Në totalin e të ardhurave, të ardhurat nga aktiviteti UK zënë 92.6%, të ardhurat financiare 1.5% dhe të ardhurat nga subvencionet 5.9%. Duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga aktiviteti mbulimi i kostove totale për vitin 2015 llogaritet ne 83%.

Figura 9.Mbulimi i Kostos Totale sipas të ardhurave



Pra, pjesa më e madhe e të ardhurave që shoqëria të përballojë kostot vijnë nga aktiviteti i saj ujësjellës kanalizime. Prandaj, faturimi i shërbimeve për të gjithë klientët në zonën e shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave është një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive. Nga ana tjetër, përmirësimi i treguesve që ndikojnë drejtpërdrejtë në kostot e shërbimit si Uji Pa të Ardhura apo Efiçenca e Stafit, sjellin ulje të kostove në dy zërat kryesorë të kostos. Për vitin 2015 kosto mesatare për $1m^3$ ujë të prodhuar është 25 lek dhe kosto për 1 m^3 ujë të faturuar është 79 lek. Krahasimi i këtyre shifrave flet qartë se vetëm 1/3 e ujit faturohet. Prandaj një menaxhim sa më i mirë i sistemit, studimi sa me i mirë i nevojave për ujë,

ndërhyrja me investime në rrjetin UK duhet të bëjë që ky hendek të vijë duke u zvogëluar. Përmirësimi i tij do të bëjë që dhe kostot të ulen e për pasojë shoqëritë UK të jenë financiarisht më të forta. Një analizë më e detajuar e këtyre humbjeve do të pasqyrohet në analizën e treguesit "Ujë Pa të Ardhura".

ERRU do të vazhdojë të nxisë dhe mbështesë të gjitha shoqëritë UK për rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve. Prioritet duhet të jetë përmirësimi i menaxhimit të shoqërisë e jo rritja e të ardhurave vetëm nga ndryshimi i tarifave. Gjatë këtij viti konstatojmë se për shoqëritë të cilat kanë aplikuar tarifat e reja gjatë vitit 2015 dhe konkretisht Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. U Elbasan Fshat, Sh.a. U Korçë Fshat si dhe Sh.a. UK Ersekë kanë rritur të ardhurat vetëm nga influenca e tarifave të reja pasi niveli i faturimit ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele si në vitin 2014.

Është e qartë se shoqëritë më të dobëta financiarisht do të vazhdojnë të kenë nevojë për financime nga buxheti i shtetit apo donatorët për kryerjen e investimeve të cilat do të sjellin përmirësime në ofrimin e shërbimeve. ERRU mbështet objektivin strategjik të qeverisë për hartimin e planeve të biznesit si mjet i rëndësishëm për planifikimin e nevojave për investime, menaxhimin dhe monitorimin e tyre si dhe planifikimin e kthimit të tyre. Hartimi i planeve të biznesit me objektiva realistë e me burimet përkatëse të financimit duhet të jetë një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive.

3.1.3 Norma e arkëtimit

Norma e arkëtimit përfaqëson raportin e të ardhurave të arkëtuara ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës kanalizime. Ky tregues na lejon të kuptojmë se sa efektive është një shoqëri për të garantuar likuiditetin e saj. Në thelb, performanca e mirë në lidhje me normën e arkëtimit është funksion menaxherial.

Për vitin 2015, norma mesatare e arkëtimit në sektorin ujësjellës-kanalizime është 92% me një përmirësim të vogël me +1% kundrejt vitit 2014. Ky tregues edhe pse për disa vite rresht ka trend pozitiv përsëri nuk ka arritur nivelin e objektivit të përcaktuar në Strategjinë Sektoriale të Shërbimit UK e cila për vitin 2015 është 96%.

Grupi i parë i shoqërive

Në grupin e parë, shoqëritë me performancën më të mirë të këtij treguesi për vitin 2015 janë Sh.a. U Elbasan Fshat me nivel arkëtimi 107.85% dhe Sh.a. UK Tiranë me nivel arkëtimi 107.34%. Rezultatet tregojnë se këto shoqëri kanë punuar për të mbledhur edhe detyrimet e prapambetura. Niveli i arritur në mbledhjen e të ardhurave nga Sh.a. UK Korçë me 95.02%, Sh.a. UK Berat Kuçovë 89.46, Sh.a. UK Sarandë 83.1% dhe Sh.a. UK Elbasan me 82.49%, i rendit këto shoqëri në brezin e performancës së mirë. Niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave është arritur dhe tejkaluar prej tyre. Shoqëria me nivelin më të ulët të arkëtimit është Sh.a. UK Kavajë me 71.35 %, por gjithsesi edhe kjo shoqëri është brenda nivelit të pranueshëm të këtij treguesi.

Figura 10. Norma e arkëtimit për grupin 1, në vitin 2015



Përmirësim të ndjeshëm krahasuar me një vit më parë në mbledhjen e të ardhurave kanë shënuar Sh.a. UK Shkodër, Sh.a. UK Sarandë si dhe Sh.a. UK Durrës të cilat kanë rritur nivelin e arkëtimit në vitin 2015 respektivisht me 11.99%, 9.48% dhe 8.86%.
Mbledhja e të ardhurave ka shënuar rënie për Sh.a. UK Elbasan Qytet me (-10.88) si dhe Sh.a. UK Kavajë me (-9.12%), gjë e cila tregon se këto shoqëri nuk kanë punuar sa duhet dhe nuk kanë treguar të njëjtën vëmendje si një vit më parë në drejtim të arkëtimit të të ardhurave. Në vitin 2014 këto dy shoqëri patën një progres të ndjeshëm të këtij treguesi.
Vlen të përmendet që në këtë grup nuk ka asnjë shoqëri në nivelin e performancës së dobët.

Grupi i dytë i shoqërive

Në grupin e dytë nga 21 shoqëri, 13 kanë arritur nivelin e normës së arkëtimit mbi 82% që është niveli i performancës së mirë së ERRU. Për katër nga këto shoqëri niveli i arkëtimit është mbi 100%.
Performanca më e mirë i përket Sh.a. UK Pogradec ku norma e arkëtimit është 113.03%. Kjo shoqëri dallohet gjithashtu për ecurinë më të mirë. Krahasuar me vitin paraardhës norma e arkëtimit është rritur me 29.67%. Gjithashtu, shoqëri me nivel arkëtimi mbi 100% janë edhe Sh.a.UK Bilisht me 103.95%, Sh.a. UK Librazhd me 101.6% dhe Sh.a. U Përmet me 100.89%.
Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë 7 shoqëri dhe vetëm një shoqëri ka performuar dobët.

Figura 11. Norma e arkëtimit për grupin 2 në vitin 2015



Krahasuar me vitin 2014, norma e arkëtimit për vitin 2015 për 13 nga 21 shoqëri të këtij grupi ka pasur tendencë pozitive. Krahas Sh.a. UK Pogradec, ecuri shumë të mirë kanë dhe Sh.a. U Kurbin, Sh.a. U Burrel si dhe Sh.a. UK Lezhë, respektivisht me rritje të normës së arkëtimit +13.28%, +13.13% dhe +9.79%.
Norma e arkëtimit në nivele të konsiderueshme është ulur për 6 shoqëri. Shoqëria që ka regjistruar rënien më të madhe të këtij treguesi me (-16.29%) është Sh.a. UK Rrogozhinë me (-10.82%) si dhe Sh.a. U Mallakastër me (-10.82 %) dhe Sh.a U Korçe Fshat me (-10.21%).

Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë ku bëjnë pjesë 24 shoqëri, për dhjetë shoqëri norma e arkëtimit për vitin 2015 është më e madhe se 82%, pra në nivelin e performancës së mirë, 13 shoqëri janë në nivelin e performancës së pranueshme (60-82%) dhe vetëm një shoqëri në nivelin e performancës së dobët nën 60%.
Shoqëria me performancën më të mirë është Sh.a. UK Mirditë me 112.06%, e ndjekur nga Bashkia Pukë me 110% si dhe Sh.a. U Ersekë me 101.9%. Këto rezultate kanë ardhur si rrjedhojë e punës së mirë që është bërë për arkëtimin edhe të debive nga periudhat e mëparshme.
Në nivelin e performancës së mirë mbi 82% janë dhe Sh.a. UK Gjirokastër Fshat, Sh.a. U Rubik, Sh.a. UK Ura Vajgurore,Sh.a. U Krastë ,Sh.a. UK Këlcyrë, Sh.a. UK Divjakë dhe Sh.a. UK Peqin.
Në nivelin e performancës së pranueshme janë pjesa më e madhe e shoqërive. Shoqëritë që paraqiten më mirë në këtë brez performance janë Sh.a. U Poliçan, Sh.a. U Selenicë, Sh.a. U Fushë Krujë.

Figura 12. Norma e arkëtimit për grupin 3 në vitin 2015



Duhet theksuar se në grupin e tretë për shoqëritë si Sh.a. U Vau Dejës, Sh.a. U Has, Sh.a. UK Novoselë si dhe Sh.a. U Tropojë, Sh.a. UK Poliçan niveli i këtij treguesi është në nivele të ulëta, por ato duhen vlerësuar për përpjekjet e vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të tij. Gjatë tre viteve të fundit niveli i arkëtimit për këto shoqëri ka pasur tendencë pozitive. Tendencën pozitive më të mirë në ketë grup për rritjen e treguesit të normës së arkëtimit krahasuare me vitin 2014 e kanë shënuar Sh.a. U Fushë Krujë me (+12.76%), dhe Sh.a. U Orikum (+10.94%) si dhe Sh.a. U Bulqizë (+10.33). Jo të gjitha shoqëritë kanë bërë përpjekjet e duhura në mbledhjen e të ardhurave, pasi krahasuar me vitin 2014 norma e arkëtimit për disa prej tyre është ulur ndjeshëm. Këtu mund të përmendim Sh.a. UK Bashkia Pukë me (-16.52%), Sh.a. U Selenicë me (-14.1%), Sh.a. U Ura Vajgurore (-12.89%) Sh.a. UK Delvinë me (-10.65%), Sh.a. U Pukë Fshat me (-8.73)

Përfundime

Norma mesatare e arkëtimit për sektorin në fund të vitit 2015 shënoi një progres të vogël, nga 91% në vitin 2014 në 92% në vitin 2015. Përgjithësisht shoqëritë kanë punuar mirë në drejtim të mbledhjes së të ardhurave. Për disa prej tyre hartimi i strategjive dhe planeve të veprimit për vjeljen e detyrimeve të prapambetura ka bërë që norma e arkëtimit të jetë mbi 100%. Në vitin 2015 për 56 shoqëritë e marra në analizë, 29 rezultojnë me normë arkëtimi mbi nivelin për performancë të mirë, të përcaktuar nga ERRU, 9 nga të cilat e kanë normën e arkëtimit mbi 100%. Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë 25 shoqëri dhe në nivelin e performancës së dobët , nën 60%, janë dy shoqëri.

Pra ky tregues përgjithësisht ka një ecuri të mirë që tregon se menaxheret e shoqërive me stafet përkatëse kanë bërë përpjekjet e duhura për arkëtimin e faturave për shërbimin UK. Një efiçencë e mirë në arkëtimin e të ardhurave ka të bëjë me fuqizimin financiar të shoqërisë që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë paguese të shoqërisë. Rritja e aftësisë paguese të shoqërisë bën të mundur likuidimin e detyrimeve ndaj punonjësve, furnitorëve, shlyerjes së interesave të kredive të marra, që do të thotë shlyerje në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve.

Për ERRU, shembulli i performuesve më të mirë duhet të ndiqet edhe nga shoqëritë për të cilat ky tregues nuk ka nivelin e kërkuar si dhe ato që nuk kanë pasur ecuri pozitive në mbledhjen e të ardhurave.

3.1.4 Efiçenca e Stafit

Treguesi i përdorur për të vlerësuar Efiçencën e Stafit është numri i punonjësve të shoqërisë që i shërben 1000 lidhjeve për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.
Efiçenca e Stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë, dhe në këtë mënyrë të rritjes së efiçencës së përgjithshme të shoqërisë. Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi sa më efektiv është përmirësimi i efiçencës operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. Duke qenë se kostot e personelit për momentin zënë një përqindje të madhe të kostove O&M të shoqërive UK, ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e treguesve kryesorë të performancës. Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive.

Në vitin 2015 kostot e personelit zënë rreth 43% të kostove O&M të shërbimeve ujësjellës kanalizime. Niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje UK për sektorin është 5.53 nga 5.49 që ishte në fund të vitit 2014.

Grupi i parë i shoqërive

Për grupin e parë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës së dobët mbi 6 punonjës për 1000 lidhje performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe atë të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje.

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë për tre vite rresht renditen katër shoqëri Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Elbasan dhe Sh.a. UK Tiranë. Në vitin 2015 i është bashkangjitur dhe Sh.a. UK Vlorë me 3.77 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e performancës së pranueshme renditen tre shoqëri Sh.a. UK Shkodër (4.34), Sh.a. UK Berat Kuçove (5.34) dhe Sh.a. UK Durrës (5.50). Këto shoqëri edhe në vitin paraardhës kanë bërë pjesë në këtë zonë.
Shoqëria me performancën më të mirë, që ka udhëhequr në këtë grup është Sh.a. UK Korçë me 2.15 punonjës për 1000 lidhje.

Në nivelin e performancës së dobët (mbi 6 punonjës për 1000 lidhje) janë 3 shoqëri, Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Kavajë dhe Sh.a. U Elbasan Fshat e cila vazhdon të mbetet shoqëria me performancën më të dobët me 12.35 punonjës për 1000 lidhje. Gjithashtu kjo shoqëri ka shënuar tendencën më negative të këtij treguesi në grupin e parë. Krahasuar me vitin 2014 kjo shoqëri ka rritur këtë tregues me (2 punonjës për 1000 lidhje).

Figura 13. Efiçenca e stafit për grupin e parë në vitin 2015



Tendencën pozitive më të mirë e ka pasur Sh.a. UK Vlorë, ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me (-1.4) punonjës për 1000 lidhje. Për rrjedhojë shoqëria kaloi nga zona e performancës së pranueshme në zonën e performancës së mirë. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit të pijshëm (+1600 lidhje) si dhe nga përfshirja e 13250 lidhjeve në qytet në sistemin e kanalizimeve, shërbim ky i kryer më parë nga Bashkia Vlorë.

Grupi i dytë i shoqërive

Për grupin e dytë, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mire është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Në vitin 2015, katër shoqëri vazhdojnë të mbeten në nivelin e performancës së mirë të përcaktuar nga ERRU. Edhe pse e ka përkeqësuar këtë tregues me (+0.69) Sh.a. UK Pogradec përsëri mbetet shoqëria me performancën më të mirë me 4 punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë janë edhe Sh.a. UK Lezhë me (4.79), Sh.a. UK Rrogozhinë me (5.23) si dhe Sh.a. UK Lushnje me (5.9) punonjës për 1000 lidhje.

Për vitin 2015 në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë nëntë shoqëri. Brënda shoqërive të përfshira në ketë zonë ka pasur luhatje të vogla qoftë pozitive qoftë negative. Tendencën

më të mirë pozitive e ka pasur Sh.a. U Peshkopi me (-2.98) punonjës për 1000 lidhje. Sh.a. U Burrel nga shoqëri me performancë të mire ka kaluar ne atë të pranueshme pasi për vitin 2015 ka pasur përkeqësim të këtij treguesi, numri i punonjësve është rritur me (+0.87) punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët (mbi 10 punonjës për 1000 lidhje) vazhdojnë të mbeten të njëjtat shoqëri që ishin dhe vitin e kaluar. Sh.a. U Patos është shoqëria me numrin më të madh të punonjësve për 1000 lidhje në grupin e dytë si dhe shoqëria me tendencën më të madhe negative të këtij treguesi. Aktualisht shoqëria operon me 28 punonjës për 1000 lidhje, tregues i cili ka ardhur duke u përkeqësuar pasi krahasuar me vitin 2014 numri i punonjësve për 1000 lidhje është rritur me +3.86 punonjës. Kjo rritje është e pajustifikuar pasi shoqëria edhe në vitet e mëparshme është cilësuar për performancë të dobët në drejtim të menaxhimit të stafit. Në vitin 2015 shoqëria ka operuar me 21 persona më shumë se një vit më parë në një kohë kur numri i lidhjeve është rritur vetëm me 100 të tilla.

Figura 14. Efiçenca e stafit për grupin e dytë në vitin 2015



Tendenca e këtij treguesi për shoqëritë e këtij grupi nuk ka qenë pozitive dhe nuk ka sjellë ndryshime të dukshme të performancës së shoqërive UK. Duhet theksuar se si ndryshimet pozitive dhe ato negative janë në nivele të ulëta me përjashtim të rasteve që i cituam gjatë analizës së më sipërme.

Grupi i tretë i shoqërive

Për grupin e tretë niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.
Në grupin e tretë, 7 nga 24 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është Sh.a. U Delvinë me (6.66) punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë renditen edhe Sh.a. U Ersekë, Sh.a. UK Fushë Krujë, Sh.a. U Selenicë, Sh.a. UK Fushë Arrëz, Sh.a. U Orikum, si dhe U Bashkia Pukë.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 10 shoqëri. Sh.a. U Gjirokastër Fshat edhe pse këtë vit ka përmirësimin të ndjeshëm të këtij treguesi,(numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me -15.04 punonjës), vazhdon të mbetet në fund të renditjes me 40.14 punonjës për 1000 lidhje. Në vitin 2015 numri i lidhjeve është rritur nga 196 në vitin 2014 në 384 në fund të vitit 2015, por nga ana tjetër edhe numri i punonjësve është rritur, nga 10 në vitin 2014 ne 15 në fund të vitit 2015.
Gjithashtu dhe Sh.a. UK Pukë Fshat, Sh.a. U Poliçan, Sh.a. U Has, dhe Sh.a. UK Peqin përkatësisht me 31.6, 30.5, 25.46 dhe 23.32 punonjës për 1000 lidhje renditen në grupin e shoqërive me performancë të dobët. Numri i punonjësve në këto shoqëri është disa herë më i lartë se sa ai i shoqërisë më të mirë në këtë grup.

Figura 15. Efiçenca e stafit për grupin 3 në vitin 2015



Në këtë grup, 50% e shoqërive e kanë përmirësuar këtë tregues edhe pse në nivele të vogla, por gjithsesi këto përmirësime gjykohen të rëndësishme duke pasur parasysh peshën e kostos së personelit në totalin e kostove. Pas Sh.a. U Gjirokastër Fshat ndryshimin më të dukshëm pozitiv e ka Sh.a. U Çorovode me (-5.5) punonjës ndërsa tendencën negative më të madhe e ka Sh.a. U Poliçan me (+6.05) punonjës për 1000 lidhje.

Përkeqësimi i këtij treguesi për Sh.a. U Vau i Dejës, Sh.a. UK Libohovë si dhe Sh.a. UK Rubik ka bërë që këto shoqëri për vitin 2015 të zbresin në brezin e performancës së pranueshme duke bërë që në këtë brez të jenë gjashtë shoqëri nga tre që ishin vitin paraardhës.

Përfundime

Në vitin 2015, treguesi staf për 1000 lidhje është në të njëjtin nivel me vitin paraardhës. Raporti nuk ka ndryshuar pasi kemi rritje si të numrit të lidhjeve UK ashtu dhe numrit të punonjësve. Krahasuar me një vit më parë numri i lidhjeve UK është rritur me rreth 66 000 lidhje dhe në pamje të parë duket sikur ky tregues do të përmirësohet. Por situata nuk ka ndryshuar për arsye se nga ana tjetër edhe numri i punonjësve për shërbimet ujësjellës kanalizime është rritur me 400.
Ndërsa shumë shoqëri kanë nevojë të rrisin në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e tyre për përmirësimin e efiçencës së stafit, pothuajse 1/3 e shoqërive (16 nga 55) kanë arritur dhe madje e kanë kaluar objektivin e performancës së mirë të vendosur për grupet e tyre përkatëse. Në kuadër të objektivit të përgjithshëm strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, mbipunësimi që vërehet dhe/ose nivelet e ulëta të produktivitetit të punonjësve mbeten një shqetësim serioz për ERRU-në. Përmirësimi i efiçencës së stafit është jo vetëm një element thelbësor i përmirësimit të efiçencës operacionale, por ndikon edhe në reduktimin e kostove të punës.

Rritja e numrit të punonjësve është e lidhur me kostot e punës, të cilat janë rritur me rreth 11% krahasuar me vitin 2014 ose në vlerë absolute me (+ 282 milion) leke. Kjo rritje e kostove ka ndikuar në pamundësinë e shoqërive për të mbuluar kostot e operim mirëmbajtjes e jo më të kostove totale.

Për të nxitur shoqëritë që të rrisin efiçencën e stafit të tyre, ERRU do të vendosë objektiva individualë për secilën nga shoqëritë ujësjellës kanalizime, pasi ky tregues është përzgjedhur si një nga TKP për vlerësimin e performancës së shoqërive UK në procesin e ndryshimit të tarifave. Çelësi i suksesit për arritjen e objektivave të performancës lidhur me këtë tregues qëndron në optimizmin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësive si dhe zgjerimin e bazës së klientëve.
Shoqëritë e mëdha dhe ato urbane arrijnë më lehtë nivele të larta të efiçencës së stafit se sa shoqëritë më të vogla dhe rurale. Gjithsesi analiza e mësipërme tregon se edhe shoqëri të vogla mund të performojnë si duhet kur kanë një menaxhim të mirë.

3.1.5 Uji Pa të Ardhura

Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë Pa të Ardhura". Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Treguesi i ujit pa të ardhura ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative.

Gjatë vitit 2015, sasia e ujit të prodhuar nga 57 shoqëri është 277,094 mijë m^3, ndërsa sasia e ujit që nuk gjeneron të ardhura është 184, 816 mijë m^3, e shprehur në përqindje mesatarja e ujit pa të ardhura në sektor për këtë vit është 67 %. Në krahasim me tre vitet e fundit, niveli i këtij treguesi ka pësuar rënie me vlerë 0,4 %.

Vlera e lartë e këtij treguesi ka qenë shqetësim i vazhdueshëm për ERRU-në, pasi objektivi i vendosur në vlerën 48% për vitin 2015 (Strategjia Kombëtare 2011-2017) është shumë larg vlerës reale të humbjeve në sektorin UK.

Duhet pasur parasysh që pjesa më e madhe e analizës në këtë kapitull bazohet mbi të dhëna të përllogaritura dhe vlerësuara nga shoqëritë dhe jo mbi të dhëna të matura.

Grupi i parë i shoqërive

Edhe për këtë vit, në grupin e parë ku bëjnë pjesë 11 shoqëri, 8 prej tyre vazhdojnë të performojnë keq duke pasur nivelin e ujit pa të ardhura mbi vlerën 50% (kufi i vendosur për performancë të dobët). Kjo situatë tregon një nivel të dobët menaxhimi të këtyre shoqërive dhe ka nevojë për një përmirësim të menjëhershëm.

Shoqëria Sh.a. UK Korçë është shoqëria me performancën më të mirë për disa vite radhazi ku vlera e ujit pa të ardhura(25,94%) qëndron gjithmonë brënda kufirit të performancës së mirë. Nga krahasimi me vlerat e vitit 2014, përkeqësim të këtij treguesi kanë pasur shoqëritë Sh.a. UK Fier (+3,67%), Sh.a. UK Shkodër (+ 4,25%), Sh.a. UK Sarandë (+ 5,14%) dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë (+1,75%). Përpjekje për përmirësim të këtij treguesi kanë bërë shoqëritë Sh.a. UK Elbasan Fshat(- 2,5%), Sh.a. UK Kavajë (- 3,9%), Sh.a. UK Tiranë (-1,57%), Sh.a. UK Durrës (-1,23%) si dhe Sh.a. UK Elbasan (-4,72%).

Gjatë tre viteve të fundit, shoqëritë që kanë bërë përpjekje për reduktim të ujit pa të ardhura janë Sh.a. Uk Tiranë (-2,64%) si dhe Sh.a. UK Elbasan (- 4,46%). Ecuria më negative gjatë kësaj periudhe është vënë re në shoqëritë Sh.a. UK Kavajë (+8,66%), Sh.a. UK Shkodër

(+4,28%), Sh.a. UK Elbasan Fshat (+2,47%), Sh.a. UK Berat-Kuçovë (+4,49%), Sh.a. UK Sarandë (+3,75%) dhe Sh.a. UK Vlorë (+3,48%).

Figura 16. Uji pa të Ardhura për grupin 1 në vitin 2015



Grupi i dytë i shoqërive

Shumica e shoqërive të grupit të dytë nuk performojnë mirë, niveli i ujit pa të ardhura në 16 prej tyre është mbi kufirin 30% të **benchmarking**. Shoqëritë Sh.a. UK Librazhd, Sh.a. U Bilisht dhe Sh.a. U Lushnje Fshat kanë arritur të mbeten në zonën e performancës së mirë për tre vitet e fundit. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për shoqërinë Sh.a. UK Kukës e cila në grafikun e grupit të dytë paraqitet me vlerën 13,15% të ujit pa të ardhura, ndërsa në analizën e "Bilancit të Ujit"për vitin 2015 ky tregues është 48%. Kjo mospërputhje vlerash ndodh si pasojë e diferencës së vlerave në raportim pranë ERRU-it dhe Njësisë së Monitorimit në DPUK (vëllimi i ujit të prodhuar sipas B.U-2015 është 2,762,599 m^3 ndërsa raportimi në DPUK është 986,000 m^3). Të njëjtën gjë kanë bërë Sh.a. U Gramsh, Sh.a. UK Tepelenë, Sh.a. UK Rrogozhinë etj, por në vlera më të vogla. Përkeqësim të situatës, me vlera në rritje të ujit Pa të Ardhura, kanë pasur shoqëritë Sh.a. U Gramsh(+15,96%), Sh.a. U Përmet(+7,84%), Sh.a. UK Tepelenë (+3,16%), Sh.a. U Korçë Fshat(+3,07%) etj.

Në këtë grup, 7 nga 21 shoqëri kanë nivelin e këtij treguesi mbi 50%, më keq paraqitet Sh.a. UK Lushnje me 79,21%, pasuar nga Sh.a. U Kurbin me 73,01%, Sh.a. UK Gjirokastër me 71,27%, Sh.a. UK Peshkopi me 62,97%, Sh.a. UK Tepelenë 61,49%, Sh.a. UK Krujë me 57,08% dhe Sh.a. UK Mallakastër me 56,52%.

Tendenca pozitive për reduktimin e këtij treguesi në krahasim me vitin 2014 është vënë re në shoqëritë Sh.a. UK Burrel (-11,9%), Sh.a. U Lushnje Fshat(-7,44%), Sh.a. UK Pogradec (-7,18%), Sh.a. UK Mallakastër(-7,16%), Sh.a. UK Krujë (-6,09%) dhe Sh.a. U Shkodër Fshat(-4,66%).

Me investimet e kryera gjatë viteve 2013-2015, kanë përmirësuar ndjeshëm këtë tregues shoqëritë Sh.a. U Bilisht (-36,65%), Sh.a. U Shkodër Fshat (-26,38%) dhe Sh.a. UK Burrel (-21,9%). Sh.a. UK Himarë nuk është marrë në analizë për mungesë të dhënash për vitin 2015.

Figura 17. Uji pa të Ardhura për grupin 2 në vitin 2015



Grupi i tretë i shoqërive

Në grupin e tretë të përbërë nga 24 shoqëri, sasia e ujit pa të ardhura zë një pjesë të konsiderueshme të volumit të ujit të prodhuar. Nga analiza e të dhënave të raportuara për tre vitet e fundit, shohim se shoqëritë e këtij grupi paraqesin luhatje të mëdha të Ujit Pa të Ardhura. Shoqëritë me nivelin e ujit pa të ardhura nën kufirin 30% të benchmarking e që performojnë mirë janë Sh.a. U Gjirokastër Fshat (13,98%), Sh.a. U Rubik (19,29%), Sh.a.

UK Delvinë (24,11%), Sh.a. UK Krastë (26,84%) si dhe Sh.a. UK Libohovë (27,56%). Me performancë të dobët, ku treguesi i ujit pa të ardhura është mbi nivelin 50% paraqiten 13 shoqëri. Në bazë të të dhënave të raportuara, performuesi më i dobët në grup që nga viti 2011 është Sh.a. U Këlcyrë (83,66%) i pasuar nga Sh.a. U Selenicë (78,3%), Sh.a. U Vau i Dejës (76,77%), Sh.a. U Fushë Arrëz (75,08%) etj.

Gjatë vitit 2015, përpjekje për përmirësimin e gjëndjes, duke treguar një trend pozitiv për eliminimin e humbjeve, kanë bërë Sh.a. U Gjirokastër Fshat (-9,13%), Sh.a. UK Delvinë (-7,48%), Sh.a. UK Ersekë (-12,48%), Sh.a. UK Mirditë (-8,68%), Sh.a. U Tropojë (-10,55%).

Figura 18 . Uji pa të Ardhura për grupin 3 në vitin 2015



Kur sasia e ujit të prodhuar nuk shoqërohet me rritje të faturimit, kemi rritje të nivelit të ujit pa të ardhura, kështu ka ndodhur me Sh.a. U Bulqizë (+32,48%), Sh.a. UK Divjakë (+27,62%), Sh.a. UK Peqin (+26,30%) të cilat paraqesin tendencë negative, duke përkeqësuar këtë tregues në vlera të mëdha.

Të dhënat e Njësisë së Monitorimit dhe Benchmarking tregojnë përmirësime të ndjeshme për Sh.a. UK Ersekë (-18,62%), Sh.a. UK Krastë (-10,21%), Sh.a. UK Delvinë (-10,64%) dhe Sh.a. U Ura Vajgurore (-10,14%) ku reduktimi i ujit të prodhuar, rritja e faturimit dhe niveli i matjes kanë përmirësuar situatën e këtij treguesi.

Përfundime

Për vitin 2015, niveli i Ujit Pa të Ardhura është 67%. Krahasuar me vitin e kaluar kemi përmirësim të këtij treguesi në vlerën 0,2%. Nga shoqëritë UK që performojnë në sektor, vetëm 10 shoqëri UK kanë performancë të mirë, 16 shoqëri kanë performancë të dobët dhe 31 shoqëri performojnë keq.

Analiza e performancës tregoi që niveli i treguesit Uji Pa të Ardhura në shumicën e shoqërive është jashtëzakonisht i lartë, kjo gjëndje paraqet rrezik edhe për qëndrueshmërinë e tyre financiare. Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve nuk mund të arrihen menjëherë, ka vend për reduktimin e tyre, pasi një pjesë e konsiderueshme i përket humbjeve administrative.

Analiza e humbjeve bazuar në Bilancin e Ujit tregon se humbjet menaxheriale janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, pra përveçse një sistemi të amortizuar, niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë.

Analiza e "Bilancit të Ujit" edhe për këtë vit ka treguar se humbjet komerciale që vijnë si rezultat i lidhjeve të paligjshme në sistem si dhe nga mos matja në prodhim dhe pasaktësia e matjes në shpërndarje, janë në vlera më të mëdha se humbjet teknike (reale).

ERRU i ka bërë me dije shoqërive se për këtë situatë duhet të merren masa urgjente duke filluar me vendosjen e matësve në prodhim dhe më pas duke kaluar në matësit e bilancit dhe ato në shpërndarje, por duke mos lënë pas dore evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimit. Gjithashtu, ERRU i sugjeron të gjitha shoqërive UK që nëpërmjet "Bilancit të Ujit" të vlerësojnë situatën aktuale dhe të hartojnë planet e veprimit për të realizuar reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, i cili duke e krahasuar me objektivin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale është akoma shumë larg tij.

3.1.6 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes është raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje. Ky tregues nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë, pasi analizon vetëm lidhjet me matës të kategorive të konsumatorëve.

Në vitin 2015, mesatarja e sektorit për këtë tregues është në nivelin e 63.5%, që do të thotë që jemi larg objektivit të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, që për këtë vit ishte 72%. Tendenca e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive me një rritje 2.3 % krahasuar me një vit më parë. Nëse marrim parasysh rritjen progresive të viteve të mëparshme, e cila është rritur nga 59% në vitin 2013, në 61.2% në vitin 2014 dhe në 63.52% në vitin 2015, që do të thotë me rreth 2% nga viti në vit, tregon punën e dobët nga ana e shoqërive duke bërë që rritja të jetë shumë e pa përfillshme dhe duke çuar në mos realizim të këtij treguesi. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë siç është treguesi i ujit pa të ardhura, i cili me rritjen e nivelit të matjes rritet dhe saktësia tek treguesi uji pa të ardhura.

Niveli i matjes duhet të rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe në vlera më të larta, për të arritur objektivat e përcaktuar në Strategji në vlerën 85% deri në vitin 2017. Ky objektiv korrespondon edhe me objektivin e ERRU për performancën e mirë të shoqërive, por sipas ecurisë në vite, mbetet ende shumë punë për tu bërë nga shoqëritë në këtë drejtim.

Grupi i parë i shoqërive

Në këtë grup janë të përfshira 11 (njëmbëdhjetë) shoqëritë e mëdha, të cilët edhe pas përfundimit të procedurave të reformës territoriale do të vazhdojnë të jenë të mëdhenj. Nga të gjitha shoqëritë e këtij grupi e vetmja shoqëri që vazhdon ta mbajë për vite me radhë nivelin e matjes të shërbimit e furnizimit me ujë në vlerën 100% është Sh.a. UK Korçë.

Të gjitha shoqëritë e tjera të këtij grupi e kanë nivelin e matjes nën kufirin e performancës së mirë prej 85 %. Gjatë këtij viti, e vetmja shoqëri që ka pasur rritjen më të madhe të nivelit të matjes është Sh.a. UK Durrës me 4.47% krahasuar me vitin 2014, por duke e krahasuar me vitin 2013 vlera e këtij treguesi është rritur me 14.39% duke e çuar këtë tregues në 84.5%, pra pothuajse në kufirin e performancës së mirë.

Edhe Sh.a. UK Shkodër ka pasur rritje të nivelit të matjes për këtë vit me 2.08 %, por përsëri mbetet shoqëria me nivelin më të ulët të këtij treguesi për këtë grup me vlerë 39.22%. Ecuria e kësaj shoqërie ka qenë e mirë sepse që nga viti 2013 ka pasur një rritje të dukshme të nivelit të këtij treguesi me 23.03 %.

Gjithashtu, një tjetër shoqëri që krahasuar me vitin 2014 ka pasur një rritje të dukshme është Sh.a. UK Vlorë, e cila e ka përmirësuar nivelin e matjes me 13.82%, por përsëri mbetet shoqëri me performancë të dobët.

Figura 19 . Niveli i Matjes për grupin 1 në vitin 2015



Ecurinë më të dobët e ka Sh.a. UK Kavajë, e cila krahasuar me vitin 2013 ka një rënie të nivelit të matjes me 37.85%, duke u renditur nga një shoqëri me një nivel performancë të mirë, në një shoqëri me performancë të dobët.

Për vitin 2015, në këtë grup 8 shoqëri kanë pasur rritje të këtij treguesi edhe pse në vlera shumë të vogla dhe 2 shoqëri kanë rënie të lehtë me 0.2 % Sh.a. UK Sarandë dhe 2.68 % Sh.a. U Elbasan Fshat.

Grupi i dytë i shoqërive

Nga 21 shoqëri të këtij grupi edhe për këtë vit, vetëm Sh.a. U Lushnje Fshat vazhdon të ketë vlerën e këtij treguesi 100%. Për vitin 2015, vetëm 5 shoqëri të këtij grupi e kanë vlerën e këtij treguesi mbi kufirin e performancës së mirë si: Sh.a. UK Pogradec (97.99%), Sh.a. U Bilisht (77.6%), Sh.a. UK Librazhd (93.97%) dhe Sh.a. UK Krujë (85.56 %) përfshirë këtu dhe Sh.a. U Lushnje Fshat.

Shoqëritë që kanë pasur përmirësime të dukshme të këtij treguesi në këtë grup janë: Sh.a. U Shkodër Fshat me 5.88 % duke e çuar këtë vlerë në 28.98 % si dhe Sh.a. UK Kurbin me 7.1 % që është përmirësimi më i mirë për këtë tregues në të gjithë grupin duke e çuar këtë vlerë në 11.01%, por përsëri këto dy shoqëri mbeten në nivelin e performancës së keqe. Megjithatë këto shoqëri duhen inkurajuar për përpjekjet që kanë bërë duke shënuar rritje të nivelit të matjes.

Figura 20. Niveli i Matjes për grupin 2 në vitin 2015



Ndërsa shoqëritë me rënie të dukshme të këtij treguesi kanë qenë Sh.a. UK Mallakastër me rënien më të lartë të këtij treguesi për grupin e dytë me 11.92 % dhe Sh.a. UK Kukës me 7.87 %.
Persa i përket shoqërisë Sh.a. UK Burrel vërtet ka pasur një rënie të këtij treguesi për këtë vit me 0.99% krahasuar me vitin 2014, por duke e krahasuar me vitin 2013 ka pasur një rënie shumë të dukshme me 17.87%.

Në këtë grup me performancë shumë të dobët, me vlera pothuajse të papërfillshme janë Sh.a. UK Gjirokastër me 1% dhe Sh.a. U Patos 0.04%, të cilët vazhdojnë të mos bëjnë përpjekje për përmirësimin e situatës.

Shoqëritë e tjera të këtij grupi krahasuar me vitin 2014, kanë mbetur pothuajse në të njëjtat nivele edhe me uljet dhe ngritjet të nivelit të këtij treguesi.

Grupi i tretë i shoqërive

Siç shihen të dhënat nga viti në vit, ky grup vazhdon të jetë grupi me shërbimin e matur në nivelet më të ulëta. Nga 24 shoqëri të këtij grupi, 5 shoqëri vazhdojnë të mos raportojnë të dhëna për të tretin vit radhazi si Sh.a. U Orikum, Sh.a. U Skrapar, Sh.a. U Tropojë, Sh.a. UK Libohovë dhe Sh.a. UK Krastë.

Shoqëria me performancë më të mirë për këtë grup dhe që vazhdon të mbajë vlerën e nivelit të matjes për të tretin vit radhazi 100% është Sh.a. U Divjakë. Kjo shoqëri pasohet nga Sh.a. U Peqin, e cila për këtë vit ka pasur një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2014 me

9.08% duke arritur vlerën 83.51%, por përsëri mbetet nën nivelin 85% të performancës së mirë.

Shoqëria e cila ka bërë përmirësim të dukshëm të nivelit të matjes është Sh.a. UK Fushë - Krujë e cila ka pasur një rritje me 14.6% krahasuar me vitin 2014, por pavarësisht këtij përmirësimi kjo shoqëri mbetet përsëri në nivelin e performancës së dobët me vlerën 34.42%. Kjo shoqëri ndiqet nga Sh.a. UK Mirditë me një rritje prej 8.41% krahasuar me vitin e kaluar duke e çuar nivelin e matjes për këtë shoqëri në 42.81%.

Në këtë grup ka edhe shoqëri të cilat për 3 vite radhazi nuk e kanë ndryshuar nivelin e matjes si:Sh.a. U Novoselë me 4.74 %, Sh.a. U Këlcyrë me 3.99 % dhe Sh.a. U Pukë Fshat me 1.58 %.

Figura 21. Niveli i Matjes për grupin 3 në vitin 2015



Gjatë këtij viti, ka pasur dhe shoqëri që kanë pasur rënie të këtij treguesi, ndër këto mund të përmendim 5 të cilat kanë pasur humbje mbi 0.5% si: Sh.a. U Ura Vajgurore me vlerë 0.97%, Sh.a. UK Bulqizë me vlerë 1.21%, Sh.a. U Poliçan me 1.24%, Ndërmarrja Ujësjellësit Bashkia Pukë me 1.41% dhe Delvinë me 2 % të cilat e përkeqësojnë edhe me shumë nivelin e matjes për këtë grup.

Në total për grupin e tretë janë 6 shoqëri me nivel matje mbi 50 %, 5 shoqëri kanë nivelin e matjes nga 30 në 50 %, 4 shoqëri kanë nivel matje deri në 10 % dhe 4 shoqëri nuk arrijnë as në 2 % nivelin e matjes.

Përfundime

Shoqëritë UK kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit edhe pse shoqëritë të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët vazhdojnë të jenë të paktë në numër. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur, madje ka dhe një numër të kufizuar shoqërish për të cilat shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm.

Instalimi i matësve për të gjithë klientët jo familjarë është një proces i cili duhet të ishte përfunduar në fund të vitit 2010 (bazuar në dy vendime të Këshillit të Ministrave). Niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive, por kjo rritje ka qenë pothuajse konstante për tre vite radhazi dhe në vlera shumë të vogla. Niveli mesatar i shërbimit të matur në vitin 2015 është 63.52 % nga 61.2 % në vitin 2014. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi shoqërive të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë.

Për të tre grupet janë 8 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë përsa i përket shërbimit të matur (2 janë në grupin e parë, 5 në grupin e dytë dhe vetëm 1 shoqëri në grupin e tretë). Në grupin e dytë dhe të tretë ka shoqëri që pothuajse nuk e masin fare këtë shërbim, kryesisht janë shoqëritë e vogla, por përjashtim bën vetëm Sh.a. UK Gjirokastër e cila dhe pse nuk është në nivelet e shoqërisë së vogël pothuajse nuk e mat këtë shërbim duke e patur 1 % nivelin e matjes.

Grupi I, ka një nivel mesatar të matjes prej 61.49 % duke pësuar rritje nga viti 2014 ku mesatarja e këtij grupi ka qenë 59.23 %. Grupi II, ka pothuajse të njëjtin nivel mesatar të matjes prej 51.38 %, pavarësisht se nga krahasimi kjo vlerë për vitin 2015 është 49.77 % dhe në dukje tregon rënie, por në fakt kjo ka ardhur nga mos raportimi i Sh.a. UK Himarë dhe niveli në vlera të papërfillshme i Sh.a. UK Gjirokastër dhe Sh.a. U Patos. Grupi III, ka një nivel mesatar të matjes prej 27.34 % duke pësuar rritje nga viti 2014 ku mesatarja e këtij grupi ka qenë 26.06 %, pothuajse sa gjysma e nivelit mesatar të dy grupeve të para.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve për shoqëritë UK dhe i ka nxitur dhe detyruar shoqëritë për vendosjen e matësve, por përsëri mesatarja e sektorit për këtë tregues është nën nivelin e performancës së mirë dhe shumë larg objektivit të përcaktuar në Strategji.

ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësave plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK. ERRU, mbështet dhe nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve. Eliminimi i praktikës "aforfe" dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësve në prodhim dhe individual duhet të jetë në fokus të punës së shoqërive.

3.1.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë është mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët dhe është një nga treguesit kryesorë të cilësisë së shërbimit të një shoqërie. Së bashku me cilësinë e ujit, ofrimi i vazhdueshëm i shërbimit për konsumatorët, kërkojnë vëmendjen më të madhe të shoqërive dhe duhet të mbeten prioritet, pasi përmirësimet në secilën prej tyre reduktojnë nevojën për gjetjen e burimeve të tjera më të kushtueshme për konsumatorët.

Ky tregues për vitin 2015 është 12 orë/ditë, ndërsa për vitin 2014 ka qenë 12.1 orë/ditë, që do të thotë që nuk ka pësuar asnjë ndryshim apo përmirësim mesatarja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë. Nga të dhënat duket qartë që nuk është arritur as objektivi i përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017 për vitin 2015 prej 16 orë/ditë, normalisht as objektivin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë/ditë. Për këtë, shoqëritë duhet të punojnë shumë.

Grupi i parë i shoqërive

Nga analiza e bërë për këtë tregues për grupin e parë të shoqërive gjatë vitit 2015 shihet që ka pasur luhatje shumë të vogla të këtij treguesi. Mesatarja e këtij grupi për vitin 2015 është 13.75 orë/ditë. Nga të gjithë shoqëritë e këtij grupi shoqëria që ka ecurinë më të mirë vazhdon të jetë Sh.a. UK Korçë me 24 orë/ditë për 3 vite radhazi, duke u ndjekur nga Sh.a. UK Shkodër me 21.62 orë/ditë dhe Sh.a. UK Fier me 20.26 orë/ditë. Të 3(tre) këta shoqëri e kanë kaluar kufirin e performancës së mirë.

E vetmja shoqëri që ka bërë përmirësim të këtij treguesi për vitin 2015 është Sh.a. UK Sarandë që ka realizuar rritje të orëve të furnizimit me ujë me 1.14 orë/ditë krahasuar me vitin 2014 duke çuar orët e furnizimit me ujë në 5.69 orë/ditë, por përsëri mbetet me performancën më të dobët për këtë grup.

Figura 22. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për grupin 1 në vitin 2015



Shoqëritë e tjera të këtij grupi kanë ndryshime pothuajse të papërfillshme, krahasuar me vitin 2014. Në të gjithë grupin ulje më të madhe të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë ka raportuar Sh.a. UK Vlorë me 0.42 orë/ditë. Nën kufirin e performancës së dobët, me më pak se 8 orë/ditë furnizim me ujë mbeten përsëri Sh.a. UK Durrës që furnizon me ujë 7.37 orë në ditë dhe Sh.a. UK Sarandë që furnizon me ujë 5.69 orë/ditë.

Grupi i dytë i shoqërive

Për grupin e dytë, mesatarja e furnizimit me ujë është 12.26 orë/ditë për vitin 2015 me një rritje shumë të vogël prej 0.36 orë/ditë nga viti 2014. Për këtë grup 5 janë shoqëritë që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë si: Sh.a. UK Librazhd, Sh.a. U Bilisht, të cilat vazhdojnë dhe për këtë vit të jenë shoqëritë më të mira të këtij grupi me 24 orë/ditë furnizim me ujë për konsumatorët duke u ndjekur nga Sh.a. UK Pogradec me 21.43 orë/ditë, Sh.a. U Gramsh me 19.86 orë/ditë dhe Sh.a. UK Lezhë 19.75 orë/ditë, që ofrojnë shërbim mbi nivelin e performancës së mirë.

Për vitin 2015 shoqëritë që kanë pasur përmirësim të këtij treguesi krahasuar me vitin 2014 janë: Sh.a. UK Përmet me 4.9 orë/ditë, Sh.a. U Korçë Fshat me 3.39 orë/ditë, Sh.a. UK Tepelenë me 1.13 orë/ditë dhe Sh.a. U Mallakastër me 0.85 orë/ditë, të cilat vlen të përgëzohen për përpjekjen që kanë bërë gjatë këtij viti.

Figura 23. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për grupin 2 në vitin 2015



Shoqëria që ka pasur rënie më të madhe të orëve të furnizimit me ujë krahasuar me një vit me parë është Sh.a. UK Peshkopi me 1.5 orë/ditë (nga 9.25 në 7.75 orë/ditë) duke kaluar në grupin e shoqërive që operojnë nën nivelin e performancës së dobët prej 8 orë/ditë furnizim me ujë. Rënie të këtij treguesi ka Sh.a. U Shkodër Fshat me një rënie prej 0.97 orë/ditë krahasuar me 2014, ndërsa po të bëjmë krahasimin me vitin 2013 ka një rënie të furnizimit me ujë prej 4.43 orë/ditë që do të thotë që kjo shoqëri ka pasur një ecuri jo të mirë në këto 3 vjet. E njëjta ecuri jo e mirë ka qenë dhe për Sh.a. UK Burrel i cili ka pasur një rënie të këtij treguesi me 0.92 orë/ditë për vitin 2014, ndërsa po të bëjmë krahasimin me vitin 2013 ka një rënie të furnizimit me ujë me 5.23 orë/ditë. Gjithashtu, në këtë grup rënie të orëve të furnizimit me ujë ka pësuar dhe Sh.a. UK Krujë me 0,51 orë/ditë.

Në grupin e dytë për këtë vit janë 7 shoqëri që kanë nivelin e këtij treguesi nën kufirin e performancës së dobët 8 orë/ditë, ndërsa në vitin 2014 ishin 6 shoqëri, pasi këtë vit u shtua dhe Sh.a. UK Peshkopi përveç Sh.a.U Lushnje Fshat, Sh.a. UK Krujë, Sh.a. UK Lushnje, Sh.a. U Kurbin, Sh.a. U Patos, dhe Sh.a. UK Gjirokastër. Ndërsa Sh.a. U Himarë vazhdon të mos bëjë raportim të të dhënave tek Njësia e monitorimit pranë DPUK.

Grupi i tretë i shoqërive

Grupi i tretë, ndryshe nga dy grupet e para përveç se është grupi me ofrim shërbimi më të ulët ka dhe përkeqësim të situatës brenda grupit duke e ulur mesataren e furnizimit me ujë nga 10.76 orë/ditë për vitin 2014 në 9.8 orë/ditë për vitin 2015.

Shoqëritë që ofrojnë ujë mbi nivelin e performancës së mirë prej 18 orë/ditë janë: Sh.a. UK Rubik me 20.67 orë/ditë dhe Sh.a. UK Bashkia Pukë me 20 orë/ditë furnizim me ujë. Këto dy shoqëri pavarësisht se renditen në shoqëritë me performancë të mirë për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 kanë ulje të orëve të furnizimit Sh.a. UK Rubik me 3.33 orë/ditë dhe Sh.a. UK Bashkia Pukë me 1 orë/ditë.

Ndërsa Sh.a. UK Ersekë në vitin 2014 ka qenë ndër shoqëritë me performancë mbi nivelin e mirë me 21.97 orë/ditë, por gjatë 2015 ka pasur rënie me 4.51 orë/ditë duke zbritur nën nivelin e performancës së mirë në 17.46 orë/ditë.

Figura 24. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për grupin 3 në vitin 2015



Në shoqëritë e këtij grupi krahasuar me vitin 2014, përmirësim të këtij treguesi kanë pasur Sh.a. U Gjirokastër Fshat me 3.55 orë/ditë, Sh.a. U Delvinë me 1.58 orë/ditë, të cilat vazhdojnë të mbeten në nivelin e performancës së pranueshme dhe Sh.a. UK Krastë me 1.98 orë/ditë, Sh.a. U Divjakë me 1.07 orë/ditë, të cilat vazhdojnë të mbeten në shoqëritë me performancë të dobët. Shoqëritë e tjera kanë pasur diferenca të vogla në orët e furnizimit me ujë.

Në kufijtë e performancës së pranueshme me orare furnizimi me ujë midis performancës së dobët dhe performancës së mirë për vitin 2015 janë 11 shoqëri nga 13 shoqëri që kanë qenë në vitin 2014. Kjo gjendje në grupin e performancës se pranueshme ka ardhur pasi kanë pësuar rënie së këtij treguesi tre shoqëri: Sh.a. U Novoselë me një rënie prej 10.34 orë/ditë duke e çuar këtë tregues nga 16.75 orë/ditë furnizim me ujë në 6.41 orë/ditë, Sh.a. UK Fushë - Krujë me një rënie prej 9.5 orë/ditë, duke e çuar këtë tregues nga 15.00 orë/ditë furnizim me

ujë në 5.5 orë/ditë dhe Sh.a. U Bulqizë me një rënie prej 1.82 orë/ditë, duke e çuar këtë tregues në 6.28 orë/ditë duke e zbritur këtë shoqëri në nivelin tek shoqëritë me performancë të dobët pasi u përfshi në këtë grup edhe Sh.a. UK Ersekë.

Për këtë vit, nën kufirin e performancës së dobët, me më pak se 8 orë furnizim me ujë në ditë, janë 9 shoqëri nga 8 që ishin për vitin 2014 pasi është shtuar Sh.a. U Bulqizë për vitin 2015.

Përfundime

Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit edhe për këtë vit nuk është në nivelet e duhura. Kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë nuk ka pësuar ndryshime apo përmirësime krahasuar me vitin 2014. Konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 12.1 orë/ditë, vlerë e cila është nën nivelin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë/ditë si dhe nën nivelin e objektivit strategjik për vitin 2015.

Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si (furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluara nga konsumatorët etj.) ndikon edhe në cilësinë e ujit të pijshëm.

Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 3-24 orë/ditë. Shoqëritë që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur janë vetëm Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh. a. UK Pogradec dhe Sh. a. UK Librazhd. Ndërsa Sh. a UK Rubik ka pësuar rënie të këtij treguesi për këtë vit nga 24 orë/ditë në 20.67 orë/ditë furnizim me ujë.

Për vitin 2015, 35 shoqëri arrijnë vlerat e treguesit mbi nivelin e performancës së dobët krahasuar me vitin 2014 që kanë qenë 39 shoqëri, që do të thotë që ky tregues për këtë vit ka pësuar rënie.

Nga eksperiencat e shoqërive me performancë të mirë shihet se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm. Nga ana e shoqërive duhet shumë punë për arritjen e këtyre niveleve.

3.1.8 Mbulimi me kanalizime

Raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK përfaqëson të ashtuquajturin Treguesin e Mbulimit me Kanalizime. Në sektorin e Ujësjellës -Kanalizime, jo të gjitha shoqëritë kryejnë të dyja shërbimet. Për këtë arsye, analiza mbi këtë tregues është fokusuar vetëm në 32 shoqëri të licencuara për këtë kategori shërbimi.

Në krahasim me shërbimin e furnizimit me ujë, ky shërbim është shumë mbrapa, vlera mesatare e sektorit vazhdon të jetë larg kufirit të performancës së mirë (75%) që ERRU ka përcaktuar për këtë tregues. Për vitin 2015, mesatarja e këtij treguesi në nivel kombëtar është 50%, vlerë kjo larg objektivave strategjike të vendosur. Shërbimi me kanalizime përbën problem të madh në zonat rurale, vetëm 3,1% të popullsisë mbulohet me shërbim, popullsia e mbetur jashtë shërbimit operon me gropa septike, të cilat nuk janë sipas standardeve të vendosura shtetërore.

Ky shërbim bëhet me cilësor nëpërmjet impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur. Për vitin 2015 kanë qenë në punë 5 impiante.Vënia në punë e impianteve të tjera të ndërtuara, krijimi i mundësisë për ndërtimin e impianteve të reja si dhe ideja për ndërtimin e impianteve të vogla në zonat e thella rurale do të sjellë ndryshime cilësore të shërbimit në nivel kombëtar dhe mbrojtje më të madhe të mjedisit.

Grupi i parë i shoqërive

Gjatë vitit 2015, situata për shërbimin me kanalizime pothuaj është e njëjtë për të gjitha shoqëritë e grupit të parë. Për performancën më të mire për disa vite radhazi, me shkallën e mbulimit 100%, spikat Sh.a. UK Elbasan. Shoqëria Sh.a. UK Korçë me (95,39%) ka zgjeruar zonën e shërbimit gjatë tre viteve të fundit me (+6,93%). Sh.a. UK Sarandë me vlerën (74,94%) të këtij treguesi, vazhdon të jetë në kufi të performancës se mirë.

Figura 25. Mbulimi me Kanalizime për grupin 1 në vitin 2015



Më keq kanë performuar Sh.a. UK Kavajë (24,78%), Sh.a. UK Durrës (47,06%) dhe Sh.a. UK Vlorë (27,5 %), e cila duke qenë se raporton për herë të parë nuk ka të dhëna bazë për krahasim. Nga krahasimi i vlerave për tre vitet e fundit mund të themi se Sh.a. UK Shkodër ka rritur shërbimin me (+8,17%) ndërsa tendencë negative kanë shfaqur Sh.a.UK Tiranë (-3,38%) si dhe Sh.a. UK Berat-Kuçovë (-3,41%). Në këtë grup, vetëm Sh.a. U Elbasan Fshat nuk ofron shërbimin me kanalizime. Nga 11 shoqëritë e grupit të parë, vetëm 5 prej tyre, nëpërmjet trajtimit të ujërave, kryejnë më me cilësi këtë shërbim duke u kujdesur njëkohësisht dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Grupi i dytë i shoqërive

Referuar niveleve të **benchmarking**, nga 12 shoqëri të grupit të dytë, vetëm 4 prej tyre kanë tejkaluar kufirin e vijës së verdhë të performancës së mirë. Mbulimi me kanalizime arrin vlerën më të lartë në zonën e shërbimit të Sh.a. UK Lezhë (97,03%) me një rritje prej (+1,96%) për Vitin 2015,pasuar nga Sh.a. UK Krujë (93,79%) dhe Librazhd (84,29%). Përmirësim të treguesit për vitin 2015 ka paraqitur dhe Sh.a. UK Pogradec (+2,56). Për tendence në rritje të treguesit, gjatë tre viteve që merren në analizë, dallohet Sh.a. UK Burrel, e cila e ka rritur mbulimin me (17,98%).

Figura 26. Mbulimi me Kanalizime për grupin 2 në vitin 2015



Vazhdojnë të performojnë dobët, duke qëndruar nën kufirin 50%, shoqëritë Sh.a. UK Peshkopi (41,92%), Sh.a. UK Gjirokastër(39,24%), Sh.a. UK Mallakastër (27,59%) dhe Sh.a. UK Rrogozhinë (15,76%) e cila ka dhe vlerën me të ulët të këtij treguesi. Trajtimin e ujërave

të ndotur e kryen vetëm Sh.a. UK Pogradec. Sh.a. UK Lezhë pritet t'i bashkohet së shpejti shoqërive që kryejnë këtë proces.

Grupi i tretë i shoqërive

Shoqëritë e grupit të tretë, megjithëse të shumta në numër, vetëm 9 prej tyre kryejnë shërbimin me kanalizime. Niveli i treguesit të këtij grupi është më i ulët se sa në dy grupet e tjera. Gjendja e këtij grupi është pothuaj e njëjtë me atë të viteve të kaluara, 7 nga 9 shoqëri performojnë dobët, nuk shihen tendenca për përmirësime të dukshme. Tendenca në rritje, në shoqëritë UK Krastë (+7,94%) dhe Ndërmarrjen e Bashkisë Pukë (+10,08%), nuk i dedikohet investimeve të kryera, por është pasojë e migrimit të popullsisë në zonat përkatëse të juridiksionit e të shërbimit.

Në grafikun e ndërtuar, Sh.a. UK Ersekë, megjithëse qëndron mbi kufirin e vijës se verdhë, ka rënie të treguesit në vlera të konsiderueshme (-16,83%). Shoqëria nuk ka zvogëluar zonën e shërbimit, ndryshimi ka ardhur pasi në raportimet e bëra më parë nuk është përfshirë popullsia që jeton në zonat rurale. Sh.a. UK Pukë Fshat ofron shërbimin vetëm për 2,1 % të popullsisë që ka në juridiksion duke qenë kështu dhe shoqëria me performancë më të ulët edhe për këtë vit. Asnjë nga shoqëritë e grupit të tretë nuk kryen trajtimin e ujërave të ndotura.

Figura 27. Mbulimi me Kanalizime për grupin 3 në vitin 2015



Përfundime

Nga sa analizuam, shërbimin me kanalizime në Shqipëri e ofrojnë 32 shoqëri, vetëm 8 prej tyre arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 75% të popullsisë, 11 performojnë dobët dhe pjesa e mbetur ofron shërbim për një numër të vogël të popullsisë. Mbulueshmëria me këtë shërbim nuk ka pësuar rritje.Edhe për këtë vit treguesi i mbulimit me kanalizime si sektor është 50%. Lënia pas dore e këtij shërbimi dhe mungesa e investimeve është më e dukshme në zonat rurale, popullsia në fshatra operon me gropa septike, të cilat nuk janë në standardet e duhura. Mbulimi me shërbim për zonat urbane ofrohet për 72,57% të popullsisë ndërsa në zonat rurale 3,1%, vlera këto mjaft të ulëta dhe larg objektivave të vendosur për vitin 2015.

Shifrat tregojnë që nevoja për të ndryshuar gjëndjen në sektor është emergjente, shoqëritë duhet të bëjnë përpjekje që gradualisht, nëpërmjet hartimit të planeve të biznesit për të identifikuar situatën e nevojat për investime dhe për përcaktimin e objektivave realistë si, dhe donacioneve të ndryshme etj. të zgjerojnë shërbimin për të gjithë popullsinë në juridiksion si në zonat urbane dhe ato rurale.

Trajtimi i ujërave të ndotura ka përmirësuar shërbimin me kanalizime vetëm tek shoqëritë të cilat janë të licencuar nga ERRU për të kryer shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura si Sh.a. UK Durrës, Sh.a. UK Kavajë , Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Shkodër.

Angazhimi dhe prioriteti i qeverisë për të reformuar sektorin UK si dhe reforma e re territoriale do të sjellë ndryshime të dukshme në sektor. ERRU, si rregullator i sektorit UK, do të mbështesë shoqëritë në punën e tyre për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të arritur pajtueshmërinë me direktivat kryesore të BE-së lidhur me mjedisin si dhe për të plotësuar objektivat e caktuara strategjike në kohën e duhur.

3.1.9 Perceptimi Rregullator

ERRU në zbatim të Ligjit 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, i ndryshuar, ka për qëllim të garantojë dhe të mbrojë interesat publike si dhe të krijojë një mjedis transparent ligjor dhe rregullator. Treguesi "Perceptimi rregullator" vlerëson shkallën me të cilën shoqëritë UK përmbushin dhe mbështesin kërkesat e ERRU në arritjen e objektivave të misionit rregullator. Për të bërë vlerësimin e këtij treguesi janë marrë në konsideratë katër aspekte kryesore që tregojnë se si shoqëritë ujësjellës kanalizime kanë përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe sa pjesëmarrës aktivë kanë qenë në këtë proces. Vlerësimi i përgjithshëm maksimal është 100 pikë. Secili prej aspekteve të mëposhtme vlerësohet maksimumi me 25 pikë:

Liçencimi: kur shoqëria operon me licencë të vlefshme nga ERRU; (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve në varësi të zhvillimit të procesit të liçencimit).

Tarifë e miratuar nga ERRU: kur shoqëria operon me tarifë të miratuar nga ERRU; (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve në varësi të zhvillimit të procesit të miratimit të tarifave.)

Pagesat rregullatore: kur shoqëria ka kryer pagesat rregullatore kundrejt ERRU në kohë dhe në masë të plotë (maksimumi 25 pikë, me një pjesë të pikëve nëse pagesat nuk janë kryer plotësisht).

Komunikimi me ERRU: nëse shoqëria u është përgjigjur informacioneve, kërkesave apo njoftimeve të ndryshme bërë nga ERRU (maksimumi 25 pikë kur të gjitha përgjigjet janë dhënë në kohë dhe të plota).

Në tabelën e mëposhtme, (Tabela 7), pasqyrohet vlerësimi i shoqërive për secilin nga këto aspekte, duke i renditur ato në grupet përkatëse sipas pikëve të përgjithshme të marra për këtë tregues.

Tabela 7. Perceptimi Rregullator: Pikët e performancës të arritura sipas grupeve

Shoqëritë			Licenca	Tarifa	P.rreg	Komunik.	Totali
Grupi 1	UK	Elbasan Qytet	25	25	25	15	90
	UK	Korçë	25	25	25	15	90
	UK	Shkodër	25	25	25	10	85
	UK	Berat - Kuçovë	25	25	15	15	80
	UK	Durrës	25	25	15	15	80
	UK	Sarandë	25	25	25	5	80
	U	Elbasan Fshat	25	25	25	5	80
	UK	Tiranë	25	25	5	15	70
	UK	Vlorë	0	25	25	10	60
	UK	Fier	25	25	0	5	55
	UK	Kavajë	15	25	0	15	55
Grupi 2	UK	Lezhë	25	25	25	20	95
	U	Korçë Fshat	25	25	25	15	90
	UK	Gjirokastër	25	25	25	5	80
	U	Bilisht	25	25	25	5	80
	UK	Librazhd	25	25	15	15	80
	UK	Burrel	25	25	10	20	80
	UK	Lushnje	25	25	15	10	75
	U	Peshkopi	25	25	10	15	75
	UK	Tepelenë	25	25	10	15	75
	UK	Pogradec	25	25	10	15	75
	UK	Krujë	25	25	5	15	70
	U	Lushnje Fshat	25	25	15	5	70
	UK	Gramsh	25	25	5	10	65
	U	Kurbin	25	25	5	10	65
	U	Përmet	25	25	0	10	60
	UK	Kukës	25	15	0	20	60
	UK	Rrogozhinë	25	25	0	5	55
	U	Shkodër Fshat	25	25	0	5	55
	UK	Patos	25	–	–	20	45
	UK	Himarë	25	0	–	0	25
	U	Mallakastër	5	–	–	10	15

Grupi 3	U	Bulqizë	25	25	25	10	85
	UK	Rubik	25	25	25	10	85
	U	Ura Vajgurore	25	25	10	20	80
	UK	Mirditë	25	25	25	5	80
	U	Orikum	25	25	20	5	75
	UK	Ersekë	25	25	10	15	75
	U	Selenicë	25	25	0	20	70
	UK	Bashkia Pukë	25	25	0	15	65
	UK	Krastë	0	25	25	15	65
	UK	Delvinë	25	15	0	15	55
	U	Poliçan	25	25	0	5	55
	U	Tropojë	25	25	0	5	55
	UK	Fushë Krujë	25	15	–	10	50
	U	Gjirokastër Fshat	0	25	0	20	45
	UK	Libohovë	25	–	–	20	45
	U	Divjakë	25	–	–	15	40
	U	Çorovodë	5	25	0	5	35
	U	Vau i Dejës	25	–	–	10	35
	U	Novoselë	0	25	0	5	30
	UK	Peqin	0	25	0	5	30
	U	Has	0	15	–	5	20
	UK	Pukë Fshat	0	–	–	15	15
	UK	Fushë Arrëz	10	–	–	5	15
	U	Këlcyrë	0	–	–	10	10
	U	Bradashesh					

Liçencimi

Në zbatim të ligjit 8102, çdo shoqëri që kryen shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të pajiset nga ERRU me liçencën përkatëse. Liçenca është instrumenti kryesor që garanton konsumatorët se shoqëria ka aftësinë për të ofruar shërbim sipas standardeve të miratuara. Shoqëria është e detyruar të respektojë kushtet e liçencës, të cilat janë objekt i monitorimit të ERRU. Për këtë arsye, ERRU ka bërë përpjekje të vazhdueshme për nxitjen e njësive të qeverisjes vendore që ato të ofrojnë shërbime përmes shoqërive të liçencuara. Rezultatet tregojnë se sektori është duke performuar mirë në këtë drejtim.

Shoqëritë që kanë një liçencë të vlefshme për kryerjen e shërbimeve si dhe ato që e kanë rinovuar atë në kohë janë vlerësuar me maksimumin e pikëve. Shoqëritë janë vlerësuar me një pjesë të pikëve në varësi të përpjekjeve që kanë bërë për të pasur një liçencë të vlefshme për kryerjen e shërbimeve që ato ofrojnë.

Në vitin 2015, Sh.a. U Këlcyrë dhe Sh.a. UK Pukë Fshat janë shoqëri që akoma vazhdojnë të operojnë pa licencë, prandaj nuk kanë marrë asnjë pikë. Gjithashtu, Sh.a. UK Vlorë dhe Sh.a. UK Peqin dhe Ndërmarrja Gjirokastër Fshat janë shoqëri të cilat kanë probleme në respektimin e kushteve të kërkuara për rinovimin e licencës. Me një minimum pikësh (5 pikë) janë vlerësuar Sh.a. U Çorovodë dhe Sh.a. UK Mallakastër, të cilat gjatë këtij viti kanë bërë përpjekje për fillimin e procedurave për pajisjen me licencë. Me një pjesë të pikëve, 10 pikë, është vlerësuar Sh.a. UK Fushë Arrëz, e cila është në proces për pajisjen me licencë, por procesi nuk ka përfunduar pasi dokumentacioni nuk është i plotë. Po kështu edhe Sh.a. UK Kavajë është vlerësuar me një pjesë të pikëve, 15 pikë, shoqëria është pajisur me licencë për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, ndërsa procesi i rinovimit të licencës për kryerjen e shërbimit të trajtimit të ujërave të ndotura nuk ka përfunduar për mos plotësim të dokumentacionit.

Në të ardhmen ERRU do të intensifikojë punën për monitorimin e zbatimit të kushteve të licencës nga të licencuarit. Kur rregullatori do të konkludojë se i licencuari nuk ka zbatuar Kushtet e Licencës do të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

Tarifat e miratuara nga ERRU

Në vitin 2015, listës së shoqërive që operojnë me tarifa të miratuara nga ERRU ju shtua edhe Sh.a. U Korçë Fshat, e cila aplikoi për herë të parë pranë ERRU për miratimin e tarifave. Të gjitha shoqëritë që aplikojnë tarifa të miratuara nga Enti Rregullator janë vlerësuar me 25 pikë.

Me një pjesë të pikëve, 15 pikë, janë vlerësuar ato shoqëri të cilat zbatojnë tarifa të miratuara nga ERRU por afati i përdorimit të tyre ka përfunduar si Sh.a. UK Kukës, Sh.a. UK Fushë Krujë dhe Sh.a. U Has. Shoqëritë, Sh.a. U Patos, Sh.a. UK Mallakastër, Sh.a. U Vau i Dejës, Sh.a. U Malësia e Madhe, Sh.a. UK Libohovë, Sh.a. U Divjakë, Sh.a UK Fushë Arrëz, Sh.a. U Këlcyrë, Sh.a. UK Pukë Fshat dhe Sh.a. UK Himarë operojnë me tarifa të pamiratuara nga ERRU, prandaj edhe nuk janë vlerësuar me pikë. Sh.a. UK Delvinë nuk zbaton tarifa të miratuara nga ERRU për largimin e ujërave të ndotura edhe pse është licencuar nga ERRU në vitin 2013 për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Me përjashtim të Sh.a. U Këlcyrë dhe Sh.a. UK Pukë Fshat, që nuk janë pajisur me licencë dhe nuk mund të aplikojnë për miratimin e tarifave, të gjitha shoqëritë e tjera duhet të kishin paraqitur kërkesën për miratimin e tarifave.

Në kushtet e riorganizimit të sektorit UK edhe kjo situatë do të tejkalohet, pasi edhe këto shoqëri në zbatim të VKM nr 63 datë 27.01.2016 'Për riorganizimin e shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", do të paraqiten pranë ERRU për pajisjen me licencë dhe rishikimin e tarifave brënda tre muajve nga riorganizimi.

Pagesat rregullatore

Pagesat e rregullimit janë detyrime të shoqërive që operojnë në sektorin UK ndaj ERRU, të përcaktuara në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 dhe të nënshkruara prej palëve në kontratën për aplikimin e tarifave të shërbimit. Ato janë burimi i financimit të shpenzimeve vjetore të ERRU, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave. Situata e likuidimit të pagesave rregullatore në vitin 2015, nuk paraqitet e mirë. Nëse e krahasojmë me vitin 2014 rezulton se likuidimet janë ulur me 20%.

Në vitin 2015, shoqëritë që kanë likuiduar pagesën rregullatore në përputhje të plotë me kontratën janë: Sh.a. UK Korçë, Sh.a. UK Gjirokastër, Sh.a. UK Shkodër, Sh.a. UK Sarandë, Sh.a. UK Vlorë, Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. U Bilisht, Sh.a. U Bulqizë ,Sh.a. UK Elbasan Qytet, Sh.a. UK Rubik, Sh.a. UK Mirditë dhe Sh.a. U Elbasan Fshat, të cilat janë vlerësuar me pikët maksimale. Disa shoqëri janë vlerësuar me një pjesë të pikëve, në varësi të likuidimit të detyrimeve kontraktuale për pagesën rregullatore. Gjatë vitit 2015, Sh.a. UK Durrës, Sh.a. UK Berat Kuçovë, Sh.a. UK Librazhd, Sh.a. UK Burrel, Sh.a. UK Lushnje Qytet, Sh.a. U Ura Vajgurore, Sh.a. U Orikum dhe Sh.a. UK Ersekë, kanë kryer pagesa për likuidimin e detyrimeve, por ato vazhdojnë të mbeten debitorë pasi në vite nuk kanë likuiduar detyrimet në përputhje me kontratat. Konstatohet se kemi shoqëri, të cilat nuk kanë kryer asnjë likuidim të pagesave rregullatore si Sh.a. UK Delvinë, Sh.a. UK Fier, Sh.a. UK Kavajë, Sh.a. UK Peqin, Sh.a. U Novoselë, Sh.a. UK Rrogozhinë, Sh.a. U Shkodër Fshat.

ERRU ka kërkuar vazhdimisht likuidimin në kohë të pagesave rregullatore, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale. Pagesa rregullatore vjetore përfaqëson vetëm 0.6 përqind të të ardhurave vjetore të shoqërisë. Si e tillë ajo është më se e përballueshme nga çdo shoqëri. Mos likuidimi në kohë i pagesave rregullatore vjetore dhe mbartja e tyre vit pas viti e shndërron atë në një "barrë" për shoqërinë.

Komunikimi me ERRU

ERRU nëpërmjet politikës së tij të bashkëpunimit dhe konsultimit në zhvillimin e mëtejshëm të instrumenteve rregullatorë, ka bërë të mundur që të vlerësojë rolin e tij në rregullimin e sektorit. Pjesa më e madhe e shoqërive kanë qenë pjesëmarrës aktivë në këtë proces.
ERRU edhe gjatë vitit 2015 ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha shoqëritë si nëpërmjet kërkesave për informacion, takimeve e konsultimeve për diskutimin e çështjeve të ndryshme. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për t'u përgjigjur kërkesave të ERRU është baza mbi të cilën është bërë edhe vlerësimi përsa i përket komunikimit me ERRU. Në këtë drejtim jo të gjitha shoqëritë kanë pasur komunikim shumë të mirë. Me pikë maksimale nuk është vlerësuar asnjë shoqëri. Sh.a. UK Lezhë, Sh.a. UK Kukës, Sh.a. UK Burrel, Sh.a. U Ura Vajgurore dhe Sh.a. U Patos janë shoqëritë me vlerësimin më të mirë me 20 nga 25 pikë të mundshme.
Referuar tabelës së mësipërme vërehet se shumë shoqëri në vitin 2015 janë vlerësuar vetëm me 5 pikë, pasi këto shoqëri nuk kanë treguar interesin e duhur ndaj kërkesave të Rregullatorit.

Përfundime

Rezultatet e analizës së më sipërme tregojnë se ndonëse ka vend për disa rregullime në lidhje me liçensimin dhe aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU, sektori ujësjellës kanalizime është duke funksionuar gjithmonë e më shumë brënda kuadrit rregullator. Për dy aspektet e tjera ka vend për përmirësim, pasi këto aspekte nuk kanë pasur të njëjtin vlerësim nga të gjitha shoqëritë. ERRU vlerëson korrektësinë dhe përpjekjet e të gjitha shoqërive për të pasur një bashkëpunim sa më të mirë. Për ato shoqëri, që për arsye objektive nuk plotësojnë kërkesat formale të liçencimit dhe miratimit të mundshëm të tarifave dhe nuk kanë vlerësim të mirë të treguesit të perceptimit rregullator, përmirësimi i performancës së këtij treguesi mund të vijë duke rritur komunikimin dhe bashkëpunimin me ERRU.

Shoqëritë UK duhet të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me përgjegjësitë që ato kanë për të respektuar detyrimet dhe për tju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të ERRU.

Performuesi më i mirë në vitin 2015 përsa i përket treguesit "Perceptimi rregullator" është Sh.a. UK Lezhë me 95 pikë e ndjekur nga Sh.a. UK Korçë dhe Sh.a. UK Elbasan Qytet me 90 pikë.

3.2. Renditja e shoqërive ujësjellës kanalizime sipas performancës për vitin 2015

Shoqëritë ujësjellës kanalizime janë renditur sipas performancës së tyre e cila përfaqëson totalin e pikëve të vlerësimit të çdo treguesi kryesor të performancës për çdo shoqëri (të cilët janë shqyrtuar secili më vete në kapitujt e mëparshëm). Kjo mënyrë e lejon ERRU të përcaktojë shoqëritë me performancën më të mirë dhe më të dobët, dhe ato me ecurinë më të mirë. Publikimi i rezultateve shërben si një nxitës më shumë që shoqëritë të përmirësojnë performancën e tyre. Gjithashtu, kjo mënyrë vlerësimi jep mundësi për të komunikuar me një publik më të gjerë ku performanca e shoqërive ujësjellës kanalizime mund të kuptohet pa qenë e nevojshme të njohësh në detaje sektorin UK.

Analiza e performancës është bazuar në të dhënat e raportuara nga shoqëritë ku cilësia e të dhënave të raportuara luan një rol të rëndësishëm në rezultatet e vlerësimit. ERRU është duke punuar dhe do të vazhdojë të punojë për rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave duke qartësuar dhe korrigjuar pasaktësitë apo mospërputhjet në të dhënat e raportuara.

Renditja e shoqërive sipas performancës së përgjithshme

Shoqëritë janë renditur sipas pikëve totale të performancës të llogaritura mbi bazën e vlerësimit të 8 nga 10 TKP. Secili prej treguesve kryesorë të performancës ka një peshë specifike të caktuar që tregon rëndësinë relative të tij.

Sistemi i pikëzimit paraqitet në tabelën 8. Maksimumi i pikëve që mund të arrihen është 100 pikë. Çdo TKP vlerësohet me një rezultat maksimal nga 5 deri në 20 pikë, në varësi të peshës specifike që i është caktuar dhe ka kufijtë e tij maksimalë dhe minimalë të performancës.

Performancë e mirë konsiderohen arritjet e shoqërisë në nivelin e objektivave të vendosur nga ERRU. Përgjithësisht, nëse performanca është nën këtë objektiv, vlerësimi bëhet vetëm për një përqindje të pikëve në dispozicion.me qëllim inkurajimin dhe vlerësimin hap pas hapi të përmirësimit të performancës. Për disa tregues si efiçenca e stafit, uji pa të ardhura dhe norma e arkëtimit performanca baras apo nën nivelin minimal të pranueshëm të objektivave të vendosur nga ERRU vlerësohet me zero pikë.

Tabela 8. Sistemi i renditjes së shoqërive; Treguesit Kryesorë të Performancës, Objektivat, Pesha specifike dhe pikët për çdo TKP

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat e performancës		Pesha specifike	Pikët maksimale
		Pikë të plota	0 pikë	Totali 100%	
1 - Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	0%	15%	15
2 - Mbulimi i Kostos Totale		Nuk është përshirë në vendosjen e pikëve			
3 - Norma e Arkëtimit		≥ 82%	≤ 60%	20%	20
4- Efiçensa e Stafit (Staf për 1000 lidhje)	Grupi 1	≤ 4	≥ 6	5%	5
	Grupi 2	≤ 6	≥ 10		
	Grupi 3	≤ 10	≥ 15		
5 - Uji pa të Ardhura		≤ 30%	≥ 50%	20%	20
6 - Niveli i Matjes		≥ 85%	0%	15%	15
7 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 ore/ditë	0%	15%	15
8. Cilësia e ujit		Nuk është përshirë në vendosjen e pikëve			
9- Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	0%	5%	5
10- Perceptimi Rregullator		100 pikë	0 pikë	5%	5

Rezultatet e renditjes për vitin 2015.

Rezultatet e përgjithshme të performancës janë llogaritur për 55 shoqëritë e marra në analizë. Në tabelën e mëposhtme (tabela 9) shoqëritë e marra në analizë janë renditur sipas pikëve totale të vlerësimit të performancës.

Tabela 9. E RENDITJES SË SHOQËRIVE 2015

Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes	Renditja	Lloji i aktivitetit	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	UK	Korçë	99.5	30	UK	Durrës	54.76
2	UK	Librazhd	98.5	31	U	Peqin	53.84
3	U	Bilisht	94.0	32	UK	Rrogozhinë	52.65
4	UK	Rubik	84.1	33	U	Ura-Vajgurore	52.19
5	UK	Pogradec	81.9	34	U	Divjakë	51.04
6	UK	Lezhë	79.6	35	UK	Peshkopi	50.39
7	UK	Ersekë	77.8	36	UK	Kavajë	48.00
8	UK	Burrel	76.7	37	UK	Gjirokastër Qytet	47.79
9	U	Lushnje Fshat	74.7	38	UK	Fushë-Krujë	46.94
10	UK	Tiranë	73.6	39	U	Libohovë	46.13
11	U	Korçë Fshat	71.8	40	U	Poliçan	44.64
12	U	Elbasan Fshat	71.4	41	U	Shkodër Fshat	42.47
13	UK	Elbasan Qytet	70.7	42	UK	Mallakastër	42.15
14	UK	Delvinë	68.2	43	U	Bulqizë	42.15
15	UK	Shkodër	67.8	44	U	Selenicë	39.34
16	UK	Sarandë	65.2	45	UK	FushëArrëz	38.20
17	UK	Kukës	64.2	46	U	Këlcyrë	36.77
18	UK	Lushnje Qytet	64.0	47	U	Kurbin	35.28
19	UK	Krastë	63.4	48	U	Has	33.83
20	U	Përmet	63.2	49	U	Vau Dejës	31.56
21	UK	Krujë	62.6	50	U	Orikum	30.42
22	UK	Bashkia Pukë	61.6	51	U	Patos	29.45
23	UK	Fier	61.6	52	U	Tropojë	23.86
24	UK	Berat-Kuçovë	61.3	53	UK	Pukë Fshat	22.36
25	U	Gramsh	61.2	54	U	Çorovodë	20.70
26	UK	Vlorë	57.2	55	U	Novoselë	16.99
27	UK	Tepelenë	57.0	56	UK	Himarë	
28	U	Gjirokastër	56.7	57	U	Bradashesh	

Performuesit më të mirë

Për vitin 2015, performuesit më të mirë në grup do të vlerësohen me çmim. Pavarësisht nga rezultati çmimi mund të merret vetëm nga shoqëritë të cilat operojnë në përputhje me kuadrin rregullator, pra kanë një licencë të vlefshme dhe tarifa të miratuara nga ERRU.

Tabela 10. Performuesit më të mirë në Renditjen e Shoqërive për vitin 2015

PERFORMUESIT MË TË MIRË PËR VITIN 2015

Renditja	Grupi 1		Grupi 2		Grupi 3	
	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes	Shoqëria	Pikët e renditjes
1	Korçë	99.50	Librazhd	98.50	Rubik	83.90

Për vitin 2015, në grupin e parë, Sh.a. UK Korçë është shoqëria me performancën më të mirë. Kjo shoqëri kryeson gjithashtu edhe listën e performancës së përgjithshme të shoqërive. Shoqëri me performancën me të mirë janë edhe Sh.a. UK Librazhd në grupin e dytë dhe Sh.a. UK Rubik në grupin e tretë.

Shoqëritë me ecurinë më të mirë në kohë

Renditja e shoqërive për vitin 2015 sipas performancës së tyre të përgjithshme pasqyron arritjet aktuale të shoqërive krahasuar me njëra tjetrën. Gjatë këtij viti shumë shoqëri megjithëse nuk renditen në vendet e para kanë bërë përpjekje për të përmirësuar shërbimin dhe menaxhimin e tyre. Ecuria e mirë e punës së tyre ka sjellë më shumë pikë të grumbulluara krahasuar me një vit më parë.

ERRU, duke marrë parasysh faktin që një pjesë e shoqërive e kanë më të vështirë se sa të tjerët për t'u renditur në vendet e para për shkak të faktorëve të jashtëm si dhe të organizimit dhe gjëndjes së sistemit të tyre ujësjellës kanalizime, nëpërmjet treguesit "shoqëritë me ecurinë më të mirë" ka vlerësuar shoqëritë që bëjnë progres në performancën e tyre.

Tabela 11. SHOQËRITË ME ECURINË MË TË MIRË PËR VITIN 2015

Shoqëria		Renditja ne grup	Pikët e renditjes 2014	Pikët e renditjes 2015	Ndryshimi në pikët e renditjes
Grupi 1	Shkodër	4	56.1	67.8	+ 11.72
Grupi 2	Lezhë	4	69.13	79.61	+ 10.49
Grupi 3	Mirditë	7	41.57	55.32	+ 13.74

Shoqëria me ecurinë më të mirë në grupin e parë është Sh.a. UK Shkodër me 11.72 pikë më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit 2015 kjo shoqëri ka përmirësuar normën e arkëtimit si dhe mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

Në grupin e dytë shoqëria që ka bërë më shumë progres është Sh.a. UK Lezhë me 10.49 pikë më shumë krahasuar me rezultatin e saj të mëparshëm. Përmirësimet kanë konsistuar kryesisht në drejtim të mbledhjes së të ardhurave, menaxhimit të stafit dhe nivelit të humbjeve.

Në grupin e tretë, Sh.a. UK Mirditë megjithëse renditet në vendin e shtatë në këtë grup, ka arritur të rrisë performancën e saj në vitin 2015 me 13.74 pikë krahasuar me vitin 2014. Shoqëria ka patur progres në treguesit norma e arkëtimit, uji pa të ardhura, dhe niveli i matjes.

4.Tema e Veçantë për Vitin 2015: Hartimi i Bilancit të Ujit

Të Përgjithshme

Bilanci i Ujit sipas modelit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA) në sistemet e furnizimit me ujë përfaqëson një metodikë për të vlerësuar sasinë e ujit që hyn dhe si konsumohet brënda sistemit, përkatësisht në pjesën që i faturohet konsumatorëve dhe në humbjet administrative dhe reale të tyre. Tabela 12 jep elementët e Bilancit të Ujit sipas IWA dhe përbën elementin bazë të hartimit të Planit të Biznesit 5 Vjecar të Shoqërive Ujësjellës Kanalizime.

Bilanci i Ujit përshkruan dhe analizon gjëndjen aktuale të Ujit Pa të Ardhura në të gjithë elementët e tij të cilat shërbejnë si bazë për projektimin e objektivave strategjikë dhe të planeve të veprimit për përmirësimin e performancës së shoqërisë. Kjo është dhe arsyeja kryesore që kërkesa e shoqërive pranë ERRU-së për tarifa të reja të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve duhet të shoqërohet detyrimisht me paraqitjen e një Plani Biznesi 5 Vjeçar.

Shembulli i paraqitur i hartimit të bilancit të ujit për shoqerinë Sh.a. UK Durrës i korrespondon një shoqërie që sistemet e furnizimit me ujë nga prodhimi tek konsumatori i ka të pajisura pjesërisht me matje, situatë e cila është pothuajse e përgjithshme në të gjithë sektorin e ujit në vendin tonë.

Shembulli i paraqitur për Sh.a. UK Durrës është nga më të komplikuarit prandaj dhe metodika e përdorur për hartimin e tij mund të shërbejë si rast përgjithësues për shoqëritë e tjera të ujësjellës kanalizimeve.

Tabela 12 e Bilancit të Ujit sipas Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjellësave (IWA)

<table>
<tr><td rowspan="11">Uji nga burimet vetjake</td><td rowspan="11">Volumi i ujit që hyn në sistem</td><td>Uji i eksportuar</td><td rowspan="3">Konsumi i autorizuar</td><td rowspan="3">Konsum i autorizuar, i faturuar</td><td>Uji i eksportuar (shitje me shumicë), i faturuar</td><td rowspan="3">Uji me të ardhura</td></tr>
<tr><td rowspan="10">Uji i furnizuar</td><td>Konsum i matur, i faturuar</td></tr>
<tr><td>Konsum i pamatur, i faturuar</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Konsum i autorizuar, i pafaturuar</td><td>Konsum i matur, i pafaturuar</td><td rowspan="8">Uji Pa të Ardhura</td></tr>
<tr><td>Konsum i pamatur, i pafaturuar</td></tr>
<tr><td rowspan="6">Humbjet e ujit</td><td rowspan="3">Humbjet administrative</td><td>Konsum i paautorizuar</td></tr>
<tr><td>Pasaktësia në ujëmatëse</td></tr>
<tr><td>Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Humbjet teknike</td><td>Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes</td></tr>
<tr><td>Rrjedhjet dhe derdhjet në depot</td></tr>
<tr><td>Rrjedhjet nga lidhjet e shërbimit deri në pikën e matjes për konsumatorët</td></tr>
<tr><td>Uji i importuar (blerje me shumicë)</td></tr>
</table>

Metodika e Hartimit të Bilancit të Ujit

Hartimi i Bilancit të Ujit për sistemet e furnizimit me ujë pa/pjesërisht me matje realizohet nëpërmjet metodës "lart-poshtë". Kjo metodë përdoret në sisteme në të cilat është e pamundur që të llogariten humbjet teknike më të gjithë nënkomponentët përbërës të tyre. Humbjet Teknike më këtë metodë llogariten si diferencë e sasisë së ujit që hyn në sistem me shumën e Konsumit të Autorizuar të Faturuar e të Pafaturuar, si dhe të Humbjeve Administrative.

Metoda e llogaritjes së Humbjeve Teknike sipas metodës "poshtë-lart" kërkon sisteme furnizimi me ujë që kanë matje individuale dhe zonale, si dhe kryerjen e matjeve të rregullta në terren.

Në sistemet e furnizimit me ujë pa/pjesërisht me matje për hartimin e Bilancit të Ujit Konsumi i Autorizuar i Faturuar dhe i Pafaturuar mund të llogaritet. Në pamundësi për të llogaritur komponentët e Humbjeve Teknike, e vetmja fushë për të hartuar Bilancin e Ujit në këto sisteme mbetet që të vlerësohen ose llogariten Humbjet Administrative mundësisht me të gjithë elementët përbërëse të saj. Humbjet Administrative përbëhen nga:

I. Konsumi i Paautorizuar

- Lidhjet e paligjshme
- Nënfaturimet e konsumatorëve me ujëmatës
- Manipuluesit e ujëmatësave dhe "by pass"
- Nënfaturimet e konsumatorëve pa ujëmatës

II. Pasaktësia në Ujëmatësa

Realisht shoqëritë nuk disponojnë të dhëna te plota dhe të mjaftueshme për përcaktimin e të gjithë nënkomponentëve të Humbjeve Administrative të përmendura më sipër. Prandaj të dhënat e nevojshme për përcaktimin e të gjithë nënkomponentëve të tyre do të mblidhen duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë, që nga rekordet (regjistrimet), anketime të ndryshme, të dhëna nga ndonjë studim i fizibilitetit të kryer më parë, apo të dhëna nga sisteme furnizimi më ujë e kushte të ngjashme që mund të transplatohen në rastin konkret.

Bilanci i Ujit për Sh.a. UK Durrës

Performanca e Shoqërisë Sh.a. UK Durrës. (viti 2013)

Treguesi i Performancës/Të Dhëna	Vlera
Popullsia në Zonën e Shërbimit	330,000
Mbulimi me Shërbimet e Furnizimit me Ujë	81%
Numri Total i Klientëve (Lidhje) të Regjistruara	70,936
Pajisja me Ujëmatësa (% e totalit)	80%
Uji Pa të Ardhura (%)	71.4%
Përqindja e Arketimit (% e totalit të faturave të emetuara)	68%
Vazhdimësia e Shërbimit (orë/ditë)	7.5
Mbulimi i Kostos Direkte Op.& Mirembajtje nga Arkëtimet	44.8%
Uji i faturuar për të tre kategoritë e klientëve (m3/ditë)	21,438
Volumi i Ujit të prodhuar (m3/ditë)	73,988
Volumi i Ujit të prodhuar për banor (litra/f/ditë)	217
Volumi i Ujit të importuar (blerë) me shumicë (m3/ditë)	951
Uji i faturuar për konsumatorët familjarë me matje (litra/ditë)	51.4
Sasia e faturuar për familjarët me dhe pa matje (litra/ditë)	80

Volumi i Ujit qe hyn në Sistem

- Uji i Prodhuar nga burimet e veta: 27,005,519 m3/vit
- Uji i importuar (i blerë) me shumicë nga jashtë zonës së shërbimit: 347,115 m3/vit
- Totali i Ujit që hyn në sistem: 27,352,634 m3/vit

Konsumi i Autorizuar:

1) I Faturuar:
   a) I matur (klientë më matës): 4,463,000 m3/vit
   b) I pamatur (kliente pa mates): 3,362,000 m3/vit

2) I Pafaturuar (ujitja e lulishteve të qytetit, zjarrfikësat, nevojat e brëndëshme të shoqërisë, emergjencat etj.):
   a) I matur 0m3/vit
   b) I pamatur 0 m3/vit
   Totali: 7,825,000 m3/vit

Humbjet Totale të Ujit (Humbjet Administrative + Humbjet Teknike)

1. Humbjet Administrative:

a) Konsumi i Paautorizuar

- Lidhjet e Paligjshme përfshirë dhe by-pass e ujëmatësit Burimi i informacionit për këto të dhëna përfshijnë:
  - Tek bilanci për qytetin e Shijakut (773 l/d/b). Gjëndja e furnizimit me uje për qytetin e Shijakut është përkeqësuar, prandaj kjo e dhënë jo reale tregon se në linjën e transmisionit nga stacioni i pompimit në Fushë Krujë deri në depo ka mjaft lidhje të paligjshme.
  - Nga verifikimet në vend vecanërisht në zonën e Plazhit
  - Tek studimi COWI në 2011, ku gjatë natës 6% e sasisë së ujit thjesht "zhduket"
  - Nga Database i OSHEE.

  Vleresohet se ekzistojne rreth 16,000 lidhje te paligjshme për një vëllim prej 6,445 m3, apo8.6% të totalit të ujit të prodhuar.

- Nënfaturimi i Konsumatorëve Familjarë me Ujëmatës
  Konsumatorët familjarë me matës të UKD përfaqësojnë rreth 80% të totalit të lidhjeve në të gjithë zonën e shërbimit të Sh.a. UK Durrës dhe për qytetin e Durrësit 88% të tyre. Shitjet referuar eksperiencës në Shqipëri duhet të jenë me normën mesatarisht 80 l/f/b. Pjesa e lidhjeve me ujëmatës faturohet mesatarisht me 51.2 l/f/d.

Vlerësohet se vellimi i nënfaturuar për konsumatorët familjarë me ujëmatës është 16,112m^3/ditë ose rreth 21.5% të totalit të ujit të prodhuar.

Tabela **13** jep në mënyrë të detajuar për secilën komunë dhe bashki në zonën e shërbimit volumin e ujit të nënfaturuar për konsumatorët familjarë me ujëmatës. Të dhënat e kësaj tabele do ti shërbejnë shoqërisë për të orientuar me prioritet planet e veprimit për një faturim real të konsumatorëve me matës atje ku këto përqindje përbëjnë peshën kryesore të tyre (shih të shënuar më të verdhë) .Vlera mjaft e lartë e vëllimit të ujit të nënfaturuar për konsumatorët më ujëmatës tregon se sistemi i matësave dhe leximi i tyre ka probleme të mëdha që duhen analizuar me vemendje të veçante.

Eshtë shumë vështirë të vlerësohet nënfaturimi tek konsumatorët familjarë pa ujëmatës. Kjo kategori konsumatorësh faturohet duke patur parasysh një normë mesatare konsumi përgjatë gjithë vitit 150 litra/frymë/ditë, që në fakt është gati dyfishi i kërkesës për ujë (normës) që realisht harxhojnë konsumatorët familjarë, rreth 80 litra/frymë/ditë. Realisht për këtë kategori konsumatorësh mund të ndodhë si faturimi dhe nënfaturimi, përkatësisht mbifaturimi për apartamentet dhe nënfaturimi për shtëpitë private dhe ato të zonës rurale që kanë mbipërdorim uji kryesisht për ujitje. Prandaj duke menduar një kompensim të të dy rasteve këtë faktor nënfaturimi për konsumatorët pa matje mund ta konsiderojmë zero.

Tabela 13.Humbjet Administrative nga Konsumatorët e Nënfaturuar me Ujëmatës

Njësitë e Qeverisjes Vendore	**Diferenca mes Normës së Supozuar dhe Sasisë së Faturuar (l/f/d)**	**Volumi i Humbjeve (m^3/ditë)**	**Perqindja e Humbjeve Ndaj Prodhimit Mesatar Ditor**	**Pesha në Perqindje Ndaj 21.5%**
Komuna Fushë Kuqe nga SP në F. Kuqe në Sukth Vendas.	800	2,638	3.5%	16%
Bashkia Durrës	57	10,038	9.7%	45%
Komuna Ishëm	47	426	0.6%	3%
Bashkia Manëz	64	751	1.0%	5%
Bashkia Sukth	56	1,546	2.1%	10%
Komuna Katund i Ri	40	661	0.9%	4%
Komuna Xhafzotaj 1	64	961	1.3%	6%
Komuna Rrashbull	41	813	1.1%	5%
Të gjitha NJQV-të e tjera në sistemin e Fushë Krujës	31	959	1.3%	6%
		Totali	**21.5%**	**100%**

b) **Pasaktësia në regjistrimin e sasisë së ujit që kalon në ujëmatës.**

Në lidhje me pasaktesinë e matjes së ujëmatësit në përgjithësi eksperienca tregon se ajo është në vlerat rreth 2-3% e sasisë totale. Në rastin konkret ujëmatësit e instaluar në UK Durrës janë të një vjetërsie mjaft të madhe dhe të një game të madhe të tipave të tyre.

Një studim i bërë nga një ekspert i huaj i vlerëson humbjet nga pasaktësia e leximit të ujëmatësave të jenë 5.75% në humbjet totale. Në fakt kjo përqindje e vleresuar është pjesë përbërëse e vlerës totale prej 21.5% që jepet në Tabelen 13 më sipër. Pjesa tjetër e 21,5% përqindjes së volumit të ujit të nënfaturuar tregon se shumë konsumatorë kanë lidhje dyfishe, ose leximi i matësave nuk bëhet në mënyrë korrekte nga lexuesit e tyre.

Shoqeria duhet të bëje investigime dhe të hartojë plane veprimi në këto dy drejtime për uljen e volumit të ujit të faturuar të konsumatorëve me ujëmatës. Gjithsesi pasaktësia e regjistrimit të ujëmatësit prej 5.75% përfshihet (nuk mblidhet) tek volumi i ujit të nënfaturuar për konsumatorët familjarë me ujëmatës.

c) Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave

Përsa i përket gabimeve sistematike në trajtimin e të dhënave ato do të merren sikur janë në vleren zero meqë nuk ka mundësi vlerësimi praktik të tyre.

Si përfundim Humbjet Administrative në total vlerësohen si volum në perqindje 30.1% të sasisë totale të ujit që hyn në sisteme, ose 8,233,143 m3/vit.

2. Humbjet Teknike:

a) Rrjedhjet në linjat e transmetimit dhe shpërndarjes
b) Rrjedhjet dhe shkarkimet nga rezervuarët e depozitimit të kompanisë dhe ato individuale të familjarëve.
c) Rrjedhjet në lidhjet e shërbimit deri në pikën e matjes te konsumatorët

Siç u theksua më sipër hartimi i Bilancit të Ujit me mënyrën "lart-poshtë" përdoret në rastin kur Humbjet Teknike dhe nënkomponentët e saj është e pamundur të përcaktohen direkt. Sh.a. UK Durrës manaxhon sisteme furnizimi me ujë mjaft të vjetëruar dhe që në mjaft raste janë të ndërtuara duke mosrespektuar kushtet teknike që përcaktojnë standartet teknike për

këtë qëllim. Kjo është sidomos e theksuar në rrjetet shpërndarëse të zonave që dekadat e fundit kanë qenë subjekt i imigracionit të pakontrolluar, si zonat e Ish kënetës, Plazhit, Zona Kodrinore dhe ajo e Spitallës, si dhe në mjaft raste në rrjetet shpërndarëse të zonave rurale. Në ketë kuptim Humbjet Teknike i marrim të mirëqena si total në pamundesi për t'i vlerësuar ose llogaritur ato sipas nënkomponentëve të përmenduara më sipër.

Si përfundim Humbjet Teknike duke bërë diferencen nga humbjet totale me ato administrative, vlerësohen në total si volum në përqindje 41.3% të sasisë totale të ujit që hyn në sisteme, ose 11,296,638 m3/vit.

Në mënyre të detajuar për çdo bashki dhe komunë, Humbjet Totale (Humbje Administrative + Humbje Teknike) jepen në përqindje në Tabelën 14. Kjo tabelë përpilohet në bashkëpunim të ngushtë të Departamentit Teknik për të vlerësuar sasinë e ujit që furnizohet çdo bashki dhe komunë në zonën e shërbimit, me Departamentin e Shitjes për të llogaritur sasinë e ujit që iu faturohet këtyre bashkive dhe komunave në të njëjtën zonë shërbimi.

Theksohet fakti që në degëzimet që furnizojnë një ose një pjesë të një komune në zonën e shërbimit, sasia e ujit që furnizohet llogaritet lehtësisht në raste kur degëzimi ka ujëmatës në dalje nga transmisioni kryesor. Në rastin kur nuk ka ujëmatës, sasia e ujit që furnizohet vlerësohet si analogji për degëzime me diameter të njëjtë me ato që kanë matje dhe duke iu referuar kohës në orë reale që ky degëzim merr ujë nga transmisioni kryesor.

Tabela 14 .Shpërndarja e Perqindjes së Ujit Pa të Ardhura në Bashkitë dhe Komunat në Zonën e Shërbimit të Sh.a. UK Durrës

Njësia e Qeverisjes Vendore	Popullsia e Shërbyer	Sasia e Furnizuar (l/f/d)	Sasia e Faturuar (l/fd)	Sasia e Furnizuar (m3/d)	Sasia e Faturuar (m3/d)	% e UPA Sipas Sasisë së Furnizuar	% e UPA ndaj Sasisë së Prodhuar
SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE NGA FUSHE KUQE							
Bashkia Durrës	192,708	165	65	35,144	14,475	59%	28%
Komuna Fushë Kuqe	2,032	946	47	3,120	155	95%	4%
Komuna Ishëm	6,108	216	53	1,956	376	81%	2.1%
Bashkia Manez	8,900	154	36	1,808	425	76%	2%
Bashkia Sukth	15,500	213	44	5,880	1,002	83%	6.5%
Komuna Katund i Ri	7,408	205	60	3,387	890	74%	3.4%
Komuna Xhafzotaj 1	7,688	305	36	4,581	535	88%	5.4%
Komuna Rrashbull	7,536	206	59	4,087	1,108	73%	4%
Nëntot**al**	**247,880**			**59,963**	**18,966**		**55.4%**
SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE NGA FUSHE KRUJA							
Bashkia Shijak	9,928	773	69	10,594	809	92%	13.2%
Komuna Preza & Bubq	1,716	139	76	329	1,315	61%	2.8%
Komuna Maminas	1,828	138		1,017			
Komuna Xhafzotaj 2	3,580	387		1,284			
Komuna Gjepalaj	920	185		777			
Nëntotal	**17,972**			**14,000**	**2,124**		**16%**
Totali për të **Dy Sistemet**	**265,852**			**73,693**	**21,090**		**71.4%**

Tabela 15 jep Bilancin e Ujit përmbledhës për Sh.a. UK Durrës sipas formatit të Shoqatës Ndërkombëtare tëUjësjellësave (IWA)

Tabela 15 . Sh.a. UK Durrës - Bilanci i Ujit -2013 (sipas IWA)

<table>
<tr><td rowspan="4">Uji i Prodhuar nga Burimet e Veta
27,005,519 m3/vit</td><td rowspan="6">Volumi i Ujit që Hyn në Sistem (100%)
27,352,634 m3/vit</td><td rowspan="3">Konsumi i Autorizuar (28.6%)
7,825,000 m3/vit</td><td rowspan="2">Konsumi i Autorizuar i Faturuar (28.6%)
7,825,000 m3/vit</td><td>Konsumi i Matur i Faturuar (16.3%)
4,463,000 m3/vit</td><td rowspan="2">Uji me të Ardhura (28.6%)
7,825,000 m3/vit</td></tr>
<tr><td>Konsumi i Pamatur i Faturuar (12.3%)
3,362,000 m3/vit</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Konsumi i Autorizuar i Pafaturuar (%)
0 m3/vit</td><td>Konsumi i Matur i Pafaturuar (0%)
0 m3/vit</td><td rowspan="5">Uji Pa të Ardhura (71.4%)
19,527,634 m3/vit</td></tr>
<tr><td>Konsumi i Pamatur i Pafaturuar (0%)
0 m3/vit</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Humbjet e Ujit (71.4%)
19,527,634 m3/vit</td><td rowspan="2">Humbjet e Dukshme (administrative) (30.1%)
8,233,143 m3/vit</td><td>Konsumi i Paautorizuar (30.1%)
• Nga konsumatoret e matur të nenfaturuar (21.5%)
• Nga lidhjet e paligjshme (8.6%)
8,233,143 m3/vit</td></tr>
<tr><td>Pasaktësia në Ujëmatësa
• Nga Perdorimi i Gjatë (5.75%)
1,572,776 m3/vit</td></tr>
<tr><td>Humbjet Reale (fizike) (41.3%)
11,296,638 m3/vit</td><td>Humbjet Reale (35.55%)
• Rrjedhjet në rrjetin kryesor dhe të shpërndarjes.
• Rrjedhjet nga kapërderdhjet në rezervuare të mëdhenj dhe individualë.
• Rrjedhjet ne linjat e lidhjeve individuale deri tek ujëmatësi i konsumatorit
11,296,638 m3/vit</td></tr>
<tr><td>Ujë i Importuar (Blerë) 347,115 m3/vit</td><td colspan="4"></td></tr>
</table>

Figurat 28 dhe 29 paraqesin skematikisht kompleksitetin e sistemeve të furnizimit me ujë nga Fushë Kuqe dhe Fushë Kruja nën administrimin e Sh.a. UK Durrës

Figura 28
Sistemi i FU nga Fushë Kuqe



Figura 29
Sistemi i FU nga Fushë Kruja



5.Konkluzione dhe Perspektiva për të Ardhmen

Konkluzione

Në vitin 2015, sektori është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ndonëse nivelet dhe ecuria e treguesve nuk është e duhura krahasuar me objektivat strategjisë për sektorin dhe ato të performancës së mirë të ERRU.

Burimi kryesor i të ardhurave për shoqëritë janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët. Megjithatë edhe gjatë këtij viti qeveria ka akorduar subvencione, pasi shumë shoqëri nuk janë në gjëndje të financojnë qoftë edhe veprimtarinë e tyre kryesore operacionale. Shoqëritë nuk disponojnë një plan të mirëfilltë biznesi 5-vjecar

ose kanë vetëm plane biznesi afatshkurtër. Mungesa e një plani biznesi ndikon drejtpërsëdrejti në mundësin e përmirësimit të performancës së shoqërive e cila edhe gjatë vitit 2015 është larg objektivit të strategjisë për sektorin.

Niveli mesatar i mbulimit të kostove të O&M me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor në vitin 2015 është **102%.** Krahasuar kjo me një vit më parë ky tregues ka pasur tendencë negative dhe është ulur me rreth **20%.** Vetëm nëntëmbëdhjetë shoqëri mbulojnë mbi **100%** kostot e operimit dhe mirëmbajtjes. Këto rezultate tregojnë për një ecuri jo të mirë të sektorit në drejtim të mbulimit të kostove O&M. E njëjta situatë paraqitet edhe për sa i përket mbulimit të kostos totale. Mesatarja e mbulimit të kostos totale për sektorin është **79%.** Krahasuar me vitin 2014 niveli i treguesit të mbulimit të kostos totale është ulur rreth **8%** në vitin 2015. Vetëm tre shoqëri kanë arritur të mbulojnë me të ardhurat e tyre të gjitha shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara. Kjo tregon që shoqëritë akoma varen nga subvencioni i qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve tregon se niveli i mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti nuk ka patur progres. Të ardhurat nga faturimi janë rritur rreth **4%** ndërsa kostot rreth **14%** krahasuar me vitin 2014**.** Niveli i shpenzimeve është rritur pothuajse në të gjitha zërat e kostove. Kostot e punës janë rritur **11%**, kostot energjisë elektrike **30%**, kostot e riparim e mirëmbajtje **50%**, kostot e shërbimeve të kontraktuara **38%**. Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike në Shkurt të vitit 2015 ka ndikuar në rritjen e kostove të energjisë elektrike ku vihet re që për konsumin në tension të ulët çmimi është rritur rreth **16%,** ndërsa për konsumin në tension të mesëm, i cili zë **3/4** e konsumit të energjisë për sektorin UK, çmimi është rritur rreth **53%**.Në total shpenzimet për energjinë elektrike në sektor janë rritur rreth **558 milion lekë** krahasuar me vitin 2014. Shoqëritë UK duhet të bëjnë më shumë përpjekje sa i përket politikave të

përmirësimit të eficensës së energjisë sepse në përgjithësi sistemet e furnizimit me ujë i kanë me ngritje mekanike dhe po ashtu shumë prej tyre i kanë edhe sistemet e kanalizimeve me ngritje mekanike, përfshirë dhe shoqëritë që kanë nën administrim impiantet e pastrimit të ujërave urbane.

Përgjithësisht shoqëritë kanë treguar vëmendje në drejtim të arkëtimit si elementi kryesor i realizimit të qëndrueshmërisë financiare të tyre. Norma mesatare e arkëtimit në sektor për vitin 2015 është **92%**. Rritja e qëndrueshmërisë financiare kërkon që shoqëritë UK të realizojnë procesin e arkëtimit në kohë dhe të fuqizojnë përpjekjet për arkëtimin e borxheve të këqija. Niveli i matjes në përgjithësi ka patur ecuri pozitive sa i përket shërbimit të matur për konsumatorët por jo sa i përket matësave të bilancit për e ujin e prodhuar i cili për shumë shoqëri vazhdon të jetë i vlerësuar. Niveli mesatar i shërbimit të matur në vitin 2015 është **64%** me një rritje prej rreth **3%** në krahasim me dy vitet e fundit. Pavarësisht se shoqëritë kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Për një numër të kufizuar shoqërish shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm që nuk i kalon **2%**. Rritja e nivelit të matjes normalisht duhej të shoqërohej me ulje të nivelit të Ujit Pa të Ardhura i cili të paktën në tre vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira **67%** dhe përbën shqetësimin kryesor në sektor sepse pjesa më e madhe e ujit të prodhuar i përket ujit pa të ardhura.Elementët bazë të Ujit Pa të Ardhura janë humbjet totale që përbëhen nga humbjet administrative dhe humbjet teknike.

Numri i lartë i punonjësve zë një përqindje të madhe të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes të shoqërive dhe përbën një element kyç për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të tyre. Vetëm një numër i vogël shoqërish i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve nuk është më shumë se **4-5** punonjës/1000 lidhje. Sa i përket cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit dhe cilësisë së ujit të pijshëm, performanca e sektorit nuk është ajo e duhura. Për vitin 2015 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë ka qenë e njëjtë me atë të vitit 2014 me **12.1** orë/ ditë. Cilësia e ujit mbetet një shqetësim kryesorë sepse shoqëritë nuk garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët për shumë arsye si furnizimi i ujit me ndërprerje, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluara nga konsumatorët etj. Megjithëse numri i konsumatorëve familjare që ju ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë në vitin 2015 është rritur me rreth **27600** konsumatorë dhe atyre që ju ofrohet shërbimi i kanalizimeve me rreth **31000 k**lientë krahasuar me vitin 2014 përsëri mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime nuk ka arritur objektivin e strategjisë për sektorin. Shoqëritë ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë për **81%** të popullsisë në zonat e tyre të mbulimit ndërsa shërbimi i kanalizimeve i ofrohet vetëm **(50%)** të popullsisë.

Perspektiva për të Ardhmen

Viti 2015 është viti i Reformës Administrative Territoriale. Kjo Reformë sjell sfida të reja për sektorin e ujit në drejtim të një riorganizimi të ri të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve në të gjithë territorin e ri të bashkive. Ndryshimi i pritshëm i strukturës organizative vertikale dhe menaxheriale të shoqërive ujësjellës kanalizimeve, si dhe i zonës së shërbimit të tyre, detyrimisht përfshin ERRU-në në aplikimet e shoqërive për Licenca dhe Tarifa të reja.

ERRU do të rrisë përpjekjet për bashkepunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend për të luajtur një rol aktiv e kontribues në mbeshtetje të reformës për realizimin e objektivave të pritshme të saj.

ERRU do të vazhdojë të monitorojë performancën e sektorit në tërësi si dhe aspekte të veçanta të këtij shërbimi, rezultatet e të cilave do të bëhen publike dhe do të jenë objekt diskutimi me palët e interesit më qëllim përmirësimin e qëndrueshëm të shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve. Theksi do të vihet në punën me shoqeritë me performancë të dobët, për të cilat ERRU do të kërkojë që të realizohet një analizë me e detajuar për të evidentuar shkaqet dhe rrugët për përmiresimin e tyre.

Në veçanti do të vazhdohet të punohet për të rritur saktësinë e të dhënave. Inspektimet, kontrolli dhe verifikimi i të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimit do të vazhdoje të jetë një nga prioritet e punës së rregullatorit.

ERRU vëren se një pjesë e mire e shoqërive të ujesjellës kanalizimeve nuk disponojne një Plan Biznesi 5 Vjeçar në përputhje me modelin e aprovuar ndërministror. Pajisja shoqërive me plan biznesi paraqitet si domosdoshmeri,si një dokument bazë i cili jep të analizuar në mënyre të detajuar dhe profesionale të gjithë treguesit e performancës së shoqërisë.Plani biznesit fikson objektivat strategjike të shoqërisë të ndarë në vite dhe tregon rrugët për arritjen e tyre shoqeruar me tarifat përkatëse që shoqëria duhet të aplikojë ndaj konsumatorëve.

ERRU do të përdorë të gjithë kompetencat që i jep ligji për përmbushjen e kësaj prerogative nga ana e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve si kusht që ato duhet të përmbushin kur aplikojnë për tarifa të reja ndaj konsumatorëve.

Për përmirësimin e treguesve financiare të performancës të cilat kanë patur tendencë përkeqsimi gjatë vitit 2015, ERRU do të vërë theksin që shoqëritë të ulin kryesisht zërin e shpenzimeve duke rritur efiçensen e energjisë dhe reduktimin e stafit të pajustifikuar (mbipopullimi).

Për efiçensen e energjisë theksi do të vihet kryesisht në njëzet e dy (22) shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve që janë të pajisur me një studim të tillë nga programi i asistencës së GIZ, studime të cilat përcaktojnë rrugët dhe mundësitë për uljen e zërit

të shpenzimeve për energjinë. Nga ana e tij ERRU do të inkurajojë pajisjen me këtë studim edhe shoqeritë e tjera.

Për reduktimin e zërit të shpenzimeve për fuqinë punëtore nga mbipopullimi me staf, ERRU do të rrisë kërkesën ndaj shoqërive që aplikojnë për tarifa të reja që të paraqesin organigrama dhe me përshkrimet përkatëse të punës që justifikojnë pozicionet dhe numrin total të stafit, si edhe për çdo drejtori apo sektor.

Përmirësimi i treguesit të Ujit Pa të Ardhura mbetet një përparësi e kerkesës së ERRU-së ndaj shoqërive të ujësjellës kanalizimeve. Theksi do të vazhdojë të jetë zvogëlimi i humbjeve në terësi dhe atyre administrative në veçanti. Në lidhje me humbjet administrative theksi do të vihet në eliminimin e lidhjeve të paligjshme, si dhe nënfaturimet e konsumatorëve me dhe pa ujëmatës. Për këtë ERRU minimalisht, krahas kërkësës për një Plan Biznesi 5 Vjeçar, do të përforcojë kërkesën e saj që shoqëritë të hartojnë dhe të paraqesin në ERRU Bilancin e Ujit çdo gjashtë (6) mujor dhe në përputhje me formatin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjellësave (IWA). ERRU është e gatshme që të ofrojë ndihmesën e saj për ato shoqëri që kanë nevojë për asistencë për hartimin e saj.

Në të gjithë procesin e monitorimit të performancës së shoqërivë ERRU do të rrisë kërkesën e saj ndaj shoqërive që të përmirësojnë cilësinë e sherbimit në drejtim të rritjes së orëve të furnizimit me ujë dhe me presionin e duhur.

Së fundmi, por jo më e parëndësishmja, ERRU do të luajë një rol mjaft aktiv në përmbushje të detyrimit të saj në përgjigje e në përmbushje të ankesave të justifikuara të konsumatorëve. Për të forcuar aspektin e ndërgjegjësimit dhe komunikimit me konsumatorët dhe të gjithë aktorëve që lidhen me sektorin e ujit, ERRU do të përmirësojë në të ardhmen faqen e saj të web-it në formë dhe përmbajtje në mënyre që ajo të transmetojë maksimalisht informacionin e duhur për këtë qëllim.

ERRU do të punojë për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin dhe bashkëpunimin ndër institucional për të krijuar ekuilibrin e duhur ndërmjet ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorëve.

6. Anekse:Të dhënat kryesore të përzgjedhura



Nr	Aktiviteti	Emertimi	Për Ujin e pijshëm lek/m3			Tarife shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat
Grupi 1	UK	Tirane	45	120	135	100	100	100	11	30	35
	UK	Durres	58	110	120	100	100	100	35	50	50
	UK	Vlore	30	60	80	80	80	80	11	13	13
	UK	Elbasan (Qytet)	38	115	130				8	25	30
	UK	Fier	52	105	125	200	200	200	13	18	20
	UK	Shkoder	40	110	110	100	100	100	15	20	20
	UK	Berat - Kucove	44	125	125	100	200	200	12	20	20
	UK	Kavaje	38	80	100	100	100	100	15	20	20
	UK	Korce	65	110	140	120	120	120	34	56	56
	U	Elbasan fshat	38	120	120	120	120	120			
	UK	Sarande	52	138	138	150	150	150	20	31	31
Grupi 2	UK	Pogradec	22/62	37/111	37/111	200+100	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
	UK	Lushnje	54	125	135	100	200	200	15	20	22
	UK	Gjirokaster	39	112	124	80	80	80	9	14	14
	UK	Lezhe	58	135	145	200	200	200	18	22	27
	U	Korce fshat	38	90	95	50	50	50			
	U	Lushnje fshat	60	70	100						
	U	Kurbin	30	80	120	50	50	50			
	UK	Librazhd	38	100	100				13	22	23
	UK	Kukes	25	60	80				7	15	20
	U	Shkoder fshat	50	120	120						
	UK	Patos									
	UK	Burrel	23	60	80				2	4	6
	UK	Rrogozhine	48	90	100	50	100	100	10	12	12
	U	Mallakaster									
	UK	Gramsh	32	90	90						
	UK	Kruje	33	80	80				8	12	12
	UK	Tepelene	33	100	120	90	400	250	12	20	20
	U	Peshkopi	27	65	85				10	15	18
	U	Permet	40	110	120	100	100	200			
	UK	Himare									
	U	Bilisht	38	100	110	50	50	50			
Grupi 3	U	Divjake									
	UK	Delvine	48	100	100						
	U	Ura Vajgurore	40	90	100						
	UK	Peqin	30	90	100	50	50	50			
	U	Bulqize	17	55	75	100	100	100			
	U	Novosele	33	50	70						
	UK	Fushe Kruje	28	60	80				6	10	12
	U	Orikum	25	70	75	100	100	100			
	UK	Erseke	38	100	110	100	100	100	10	13	18
	U	Polican	37	80	95						
	U	Tropoje	19	60	80						
	U	Selenice	30	80	100						
	U	Corovode	27	80	95						
	U	Has	25	60	80						
	UK	Mirdite	30	100	115				10	15	15
	UK	Bashkia Puke	35	130	140	100	100	100	8	16	16
	U	Kelcyre									
	U	Vau i Dejes									
	UK	Libohove									
	UK	Rubik	30	70	100				7	10	15
	UK	Fushe Arrez									
	UK	Puke fshat									
	UK	Kraste	30	80	100				7	10	15
	U	Gjirokaster fshat	25	60	60						
	U	Bradashesh									

Nr.	Emri i shoqerise / nj. admn.	Total i lidhjeve te ujit	Total i lidhjeve kanalizime	Total i te punesuarve qe merren me aktivitetet e shoqerise	Vellimi total i ujit te prodhuar nga dyllojet e sistemeve	Vellimi total i ujit te faturuar tek klientet	Shuma totale e faturuar e Ujit	Shuma totale e faturuar e Kanalizimeve
		nr	nr	nr	000/m3	000/m3	000/leke	000/leke
Grupi 1	Tirane	197,722	169,190	1,376	102,874	34,147	2,066,753	389,327
	Durres	75,508	43,506	655	27,101	7,685	596,520	150,908
	Vlore	44,436	13,250	218	29,863	5,300	300,880	24,871
	Elber sh.p k	31,249	31,249	224	13,254	3,190	255,890	51,237
	Fier	30,034	24,534	348	12,345	4,774	363,040	43,636
	Shkoder	27,708	25,345	230	12,908	3,491	203,289	50,750
	Berat - Kucove	25,025	20,729	245	11,736	2,782	171,623	30,386
	Kavaje	24,220	6,078	241	2,720	1,525	85,420	5,344
	Korce	22,446	22,006	96	3,249	2,406	215,741	89,156
	Elbasan fshat	17,586	-	217	3,204	2,126	105,228	-
	Sarande	15,069	11,699	99	5,155	1,134	95,114	16,082
Grupi 2	Pogradec	14,346	10,565	100	2,424	1,293	79,678	25,402
	Lushnje Qytet	11,193	7,448	110	5,717	1,189	82,885	12,478
	Gjirokaster (Q)	9,462	3,449	99	5,093	1,463	70,411	8,558
	Lezhe	8,787	8,785	84	2,230	1,193	106,957	22,209
	Kamez	8,563	5,026	90	2,097	1,781	126,235	2,321
	Korce	6,991	-	56	1,040	690	19,686	-
	Lushnje (F)	6,488	-	62	699	502	37,201	-
	Kurbin	6,054	-	139	4,438	1,198	53,432	-
	Shkoder (F)	5,841	259	127	1,699	1,137	48,519	-
	Librazhd	5,192	4,801	64	720	554	26,941	7,624
	Kukes	5,027	3,486	75	986	856	26,702	5,769
	Patos	4,747	-	133	2,530	1,331	36,808	-
	Mallakaster	4,339	1,722	98	99	513	39,226	2,453
	Burrel	4,327	3,567	48	1,272	760	40,208	1,382
	Gramsh	4,047	-	43	1,425	715	28,846	-
	Rrogozhine	4,015	1,533	29	561	283	9,460	537
	Kruje	3,668	3,124	44	1,047	449	19,374	3,308
	Tepelene	3,550	3,360	61	1,017	392	21,824	5,111
	Peshkopi	3,497	2,841	42	1,951	722	25,004	6,030
	Permet	3,426	-	39	582	312	20,289	-
	Bilish	3,244	-	28	501	376	18,648	-
Grupi 3	Delvine	2,832	1,669	30	311	236	18,322	1,799
	Divjake	2,798	-	36	417	209	11,443	-
	Bulqize	2,746	-	37	1,592	605	22,714	-
	Fush-Kruje	2,536	1,905	34	468	250	11,285	1,601
	Peqin	2,473	-	58	953	478	32,892	-
	Ura-Vajgurore	2,405	-	32	864	374	20,050	-
	Novosele	2,300	-	36	895	443	16,623	-
	Orikum	1,948	-	18	403	209	8,590	-
	Corovode	1,884	-	34	542	248	9,356	-
	Erseke	1,654	1,654	23	383	201	10,692	2,089
	Polican	1,579	-	48	685	212	10,913	-
	Selenice	1,509	-	12	620	135	5,378	-
	Tropoje	1,496	-	28	1,488	421	14,280	-
	Mirdite	1,360	1,200	43	718	243	11,878	2,431
	Has	1,352	-	34	629	276	9,085	-
	Bashkia Puke UK	1,105	1,105	21	347	138	8,713	1,320
	Kelcyre	1,002	-	14	636	104	5,464	-
	Vau Dejes	942	-	10	695	161	4,420	-
	Libohove	783	-	8	234	170	4,406	-
	Fush Arrez	604	569	10	461	115	3,151	643
	Rubik	578	546	12	128	104	3,514	735
	Puke fshat	523	78	19	420	127	2,269	231
	Kraste	420	352	15	178	130	3,875	588
	Gjirokaster	384	-	15	490	422	2,735	-

Nr.	Emri i shoqerise / nj. admn.	Shuma totale e faturuar U&K	Te ardhura te tjera operative Ujesjelles	Shuma totale e arketuar nga aktiviteti kryesor i U&K	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Ujesjelles	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Kanalizime	Kosto Direkte e Operimit (KDO) U-K	Kosto Totale e Operimit- Ujesjelles	Kosto Totale e Operimit- Kanalizime	Kosto Totale Ujesjelles - Kanalizime
		000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke
Grupi 1	Tirane	2,456,080	53,892	2,636,281	1,640,971	42,878	1,683,849	2,110,739	62,078	2,172,817
	Durres	747,428	40,443	574,684	1,039,234	145,937	1,185,171	1,298,867	210,788	1,509,655
	Vlore	325,751	-	253,792	340,112	28,621	368,733	485,945	28,621	514,566
	Elber sh.p k	307,127	8,562	253,352	261,594	4,992	266,586	429,864	15,264	445,128
	Fier	406,676	-	311,327	321,113	13,297	334,410	408,305	30,097	438,402
	Shkoder	254,039	-	202,941	178,992	56,108	235,101	229,583	100,970	330,553
	Berat - Kucove	202,009	2,670	180,718	136,137	14,991	151,128	196,163	20,415	216,578
	Kavaje	90,764	6,205	64,764	121,864	10,581	132,445	185,096	15,141	200,237
	Korce	304,898	4,540	289,712	99,570	60,745	160,314	168,652	182,941	351,593
	Elbasan fshat	105,228	9,328	113,485	201,269	-	201,269	216,782	-	216,782
	Sarande	111,197	-	92,403	78,056	5,844	83,900	114,324	16,961	131,285
Grupi 2	Pogradec	105,080	7,846	118,769	59,151	24,549	83,700	90,508	44,618	135,126
	Lushnje Qytet	95,363	2,096	86,189	97,037	7,799	104,836	139,209	11,141	150,350
	Gjirokaster (Q)	78,969	4,058	75,111	67,381	5,348	72,729	71,797	5,972	77,769
	Lezhe	129,166	5,332	106,615	102,032	14,860	116,892	144,380	39,508	183,888
	Kamez	128,556	2,330	90,943	102,068	12,047	114,115	102,068	12,047	114,115
	Korce	19,686	442	16,288	38,608	-	38,608	46,657	-	46,657
	Lushnje (F)	37,201	200	33,951	53,905	-	53,905	77,905	-	77,905
	Kurbin	53,432	149	46,480	129,809	-	129,809	136,843	-	136,843
	Shkoder (F)	48,519	5	29,520	92,833	2,727	95,560	130,976	2,727	133,703
	Librazhd	34,565	1,593	35,119	29,930	5,498	35,428	34,403	6,575	40,978
	Kukes	32,471	454	23,187	36,216	3,789	40,005	55,378	4,766	60,144
	Patos	36,808	301	29,907	203,763	3,489	207,252	212,017	3,489	215,506
	Mallakaster	41,679	1,158	31,172	63,697	1,591	65,288	66,317	2,239	68,556
	Burrel	41,590	-	39,845	16,285	996	17,281	19,045	1,116	20,161
	Gramsh	28,846	-	24,237	24,672	-	24,672	30,400	-	30,400
	Rrogozhine	9,997	-	7,792	19,287	2,764	22,051	23,808	3,488	27,296
	Kruje	22,682	567	17,731	20,521	882	21,403	44,383	6,594	50,977
	Tepelene	26,935	-	24,192	48,263	2,550	50,813	60,479	2,550	63,029
	Peshkopi	31,034	131	23,145	23,864	3,294	27,158	30,578	3,294	33,872
	Permet	20,289	553	20,470	27,602	-	27,602	29,874	-	29,874
	Bilish	18,648	844	19,385	18,739	-	18,739	31,951	-	31,951
Grupi 3	Delvine	20,120	-	13,691	20,783	3,281	24,064	23,510	3,281	26,791
	Divjake	11,443	390	9,873	23,204	-	23,204	24,980	-	24,980
	Bulqize	22,714	291	17,165	22,395	-	22,395	28,076	-	28,076
	Fush-Kruje	12,886	547	9,812	24,107	3,088	27,195	34,174	3,459	37,633
	Peqin	32,892	-	27,880	51,378	-	51,378	55,327	-	55,327
	Ura-Vajgurore	20,050	142	18,380	28,625	-	28,625	30,190	-	30,190
	Novosele	16,623	46	10,468	37,835	-	37,835	46,335	-	46,335
	Orikum	8,590	298	6,290	25,340	-	25,340	27,091	-	27,091
	Corovode	9,356	132	6,498	26,576	-	26,576	32,216	-	32,216
	Erseke	12,780	79	13,023	8,743	3,026	11,769	11,714	3,521	15,235
	Polican	10,913	45	8,565	33,463	-	33,463	36,790	-	36,790
	Selenice	5,378	74	4,160	14,051	-	14,051	20,051	-	20,051
	Tropoje	14,280	32	7,267	15,526	-	15,526	22,548	-	22,548
	Mirdite	14,309	888	16,034	22,808	3,972	26,780	23,360	3,972	27,332
	Has	9,085	-	6,419	21,883	-	21,883	26,407	-	26,407
	Bashkia Puke UK	10,034	-	7,525	9,699	1,331	11,030	10,879	2,299	13,178
	Kelcyre	5,464	10	4,792	9,432	-	9,432	10,077	-	10,077
	Vau Dejes	4,420	-	3,172	16,805	-	16,805	17,765	-	17,765
	Libohove	4,406	-	3,022	10,610	-	10,610	12,290	57	12,347
	Fush Arrez	3,794	-	2,814	5,249	2,810	8,059	7,047	3,020	10,067
	Rubik	4,249	-	3,986	3,966	894	4,860	5,920	1,709	7,629
	Puke fshat	2,500	-	1,625	7,239	1,658	8,897	9,759	2,378	12,137
	Kraste	4,463	1,500	4,030	6,684	528	7,212	9,846	888	10,734
	Gjirokaster	2,735	-	2,578	8,524	-	8,524	9,991	-	9,991

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

ENTI RREGULLATOR I UJIT
ERRU